TEKSTI SHKOLLOR PËR VITIN E PARË TË GJIMNAZIT

ARTI FIGURATIV I

Danco Ordev
Aleksandar Ordev

lamina

ARTI FIGURATIV I, tekst mësimor për Lëndën e Artit figurativ për vitin e parë të gjimnazit
Të drejtat autoriale © 2025, Ars Lamina – botime

Botuar nga
Ars Lamina, Shkup 2025

Kryeredaktore
Branka Bugariska

Redaktore
Marija Içokaeva

Autorë
Mr. Danço Ordev
Aleksandar Ordev

Redaksia profesionale
Ana Kondovska-Vishinska

Përkthim nga maqedonishtja
(„Ликовна уметност I, учебник по Ликовна умтност за прва година гинназиско образование", Арс Ламина 2025)
Naser Mustafi

Redaksia gjuhësore
Blerta Emini

Dizajn
Pointer Creative Agency

Redaktim grafik dhe teknik
Ars Lamina – botime

Shtypi
Branko Gapo – prodhim grafik, Shkup 2025

Tirazhi
2.000

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet apo të transmetohet në asnjë formë apo me asnjë mjet, elektronik apo mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin, ose të ruhet në ndonjë sistem për rishfrytëzim, pa pëlqimin me shkrim të botuesit.

Ky tekst mësimor është i miratuar për përdorim në arsimin e mesëm, me Vendimin për miratim dhe përdorim të tekstit mësimor për lëndën Arti Pamor për vitin e parë gjimnaz, nr. 26-921/1 të datës 25.8.2025, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски", Скопје

373.5:73/74(075.3)=163.3

ORDEV, Danço

Arti figurativ I : tekst mësimor për Lëndën e Artit figurativ për vitin e parë të gjimnazit / Danço Ordev, Aleksandar Ordev ; përkthim nga maqedonishtja Naser Mustafi. - Shkup : Ars Lamina – botime, 2025. - 190 стр. : илустр. ; 205x270 мм

Користена литература: 190 стр. - Содржи и: Речник на поими

ISBN 978-608-280-174-2

1. Ordev, Aleksandar [автор]

COBISS.MK-ID 66810117

PARATHËNIE

Artet e bukura janë pjesë e zhvillimit të përgjithshëm të qytetërimit njerëzor. Ato shërbejnë jo vetëm për përvojën estetike, por edhe për të kuptuar historinë, kulturën, besimet dhe vlerat e epokave dhe popujve të ndryshëm. Sidomos në arsim, arti luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kreativitetit, shkrim-leximit vizual dhe të menduarit kritik tek të rinjtë.

Ky libër shkollor i arteve të bukura është i destinuar për nxënësit e vitit të parë të arsimit të mesëm dhe është zhvilluar plotësisht në përputhje me Kurrikulën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë përgatitjes së tij, u këmbëngul në respektimin e rreptë të qëllimeve, fushave tematike, rezultateve të pritura dhe vlerësimeve të parashikuara nga programi.

Përmes një qasje kronologjike dhe tematike, libri shkollor ofron një hyrje sistematike nëzhvillimin e arteve të bukura nga parahistoria deri në fund të Mesjetës. Fokusi është në tiparet themelore stilistike, teknikat dhe mjetet e shprehjes karakteristike të secilës periudhë. Përveç zhvillimit historik global, paraqitet edhe përmbajtje që lidhet me trashëgiminë artistike të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me kërkesat e programit.

Përveç historisë së artit, brenda të njëjtës lëndë, studentët studiojnë edhe elemente dhe parime artistike - siç janë vija, ngjyra, forma, kompozimi, ekuilibri, kontrasti dhe themele të tjera vizuale. Edhe pse këto përmbajtje janë përpunuar nga autorë të ndryshëm, ndërlidhja e tyre është thelbësore për interpretimin dhe krijimin e saktë të veprave të artit. Të kuptuarit e këtyre elementeve dhe parimeve u lejon studentëve të analizojnë më thellë veprat që studiojnë, por edhe t'i zbatojnë ato në proceset e tyre krijuese.

Libri shkollor është i destinuar për studentë dhe mësues dhe synon të kontribuojë në zhvillimin e shkrim-leximit vizual, të menduarit kritik, respektit për trashëgiminë kulturore dhe të inkurajojë kreativitetin artistik. Duke përfshirë yetje, aktivitete, shembuj vizualë dhe fakte interesante, mundësohet një pjesëmarrje më aktive dhe dinamike e studentëve në procesin mësimor.

Shpresojmë që ky libër shkollor të jetë një mbështetje e dobishme në zbatimin e kurrikulës dhe do të kontribuojë në thellimin e interesit për artet e bukura si një pjesë e rëndësishme e arsimit të përgjithshëm.

Nga autorët

PËRMBAJTJA



Tema 1 – Hyrje në artin pamor dhe në historinë e artit


1.1 Çfarë është arti dhe cila është roli i tij? 8
1.2 Arti prehistorik 11
1.3 Arti egjiptian 14
1.4 Arti mesopotamian 17
1.5 Arti egjean 20
1.6 Arti grek 23
1.7 Arti etrusk 27
1.8 Arti romak 30
1.9 Arti paleokristian 35
1.10 Arti bizantin 39
1.11 Arti romanesk 43
1.12 Arti gotik 47
1.13 Arti islamik 52
1.14 Arti prehistorik, antik dhe mesjetar në Republikën e Maqedonisë së Veriut .. 57
1.15 Rilindja e hershme (Rana renesancë) 62
1.16 Rilindja e lartë (Renesanca e lartë) 66
1.17 Manierizmi 70
1.18 Baroku 74
1.19 Rokoko 80
1.20 Neoklasicizmi 84
1.21 Romantizmi 89
1.22 Realizmi 94
1.23 Arti në periudhën post-bizantine në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut 99

Tema 2 – Elementet pamore

2.1 Vija 108
2.2 Ngjyra I – Bazat e spektrit 114
2.3 Ngjyra II – Kontrastet dhe koloriti 118
2.4 Toni 123
2.5 Tekstura 126
2.6 Drejtimi 130
2.7 Madhësia 134
2.8 Forma 138
2.9 Hapësira 142
2.10 Perspektiva I – Perspektiva lineare me një pikë mbledhëse 146
2.11 Perspektiva II – Perspektiva lineare me dy pika mbledhëse 149

Tema 3 – Parimet pamore

3.1 Harmonia 154
3.2 Kontrasti 158
3.3 Gradacioni 162
3.4 Balanca 166
3.5 Ritmi dhe lëvizja 169
3.6 Proporcioni 173
3.7 Njësia (Uniteti) 176
3.8 Kompozimi 178



TEMA 1


Hyrje në artin pamor dhe historinë e artit

Historia e artit përfaqëson një përmbledhje të krijimtarisë artistike të njerëzimit – që nga kohërat më të hershme deri në ditët e sotme. Ajo nuk është vetëm një koleksion pikturash, skulpturash dhe ndërtesash, por një dëshmi e zhvillimit të mendimit, ndjenjave, besimeve dhe vlerave në periudha dhe kultura të ndryshme.

Përmes veprave artistike mund të kuptojmë se si njerëzit e kanë perceptuar botën përreth, çfarë simbolesh kanë përdorur, çfarë ka qenë e rëndësishme për ta, dhe si e kanë shprehur këtë përmes formës, ngjyrës, materialit dhe hapësirës. Arti ka qenë gjithmonë i lidhur me fenë, politikën, jetën e përditshme dhe përparimin teknologjik.

Në këtë pjesë të tekstit do të njohësh periudha të rëndësishme artistike, si:parahistoria, bota, antike ,mesjeta, rilindja, baroku. Do të zbulosh stile të ndryshme, ide dhe gjuhë artistike që janë zhvilluar ndër shekuj, si dhe mënyrën se si ato kanë ndikuar në shoqëri dhe kulturë.

Njëkohësisht, do të mësosh të shikosh dhe të mendosh për artin me më shumë vëmendje. Do të zhvillosh aftësi për të njohur dhe analizuar veprat artistike, dhe do të kuptosh më thellë:si janë krijuar, për kë kanë qenë të destinuara,dhe pse ato janë të rëndësishme edhe sot.



Qëllimet e temës:

- Të kuptosh se çfarë përfaqëson arti dhe pse ai ka një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme.
- Të kuptosh se çfarë është historia e artit dhe pse është e rëndësishme për të kuptuar kulturën njerëzore.
- Të njohësh periudha të ndryshme artistike dhe karakteristikat e tyre.
- Të identifikosh lidhjet mes artit, shoqërisë, fesë dhe jetës së përditshme.
- Të përvetësosh aftësi themelore për vëzhgim dhe analizë të veprave artistike.
- Të zhvillosh ndjeshmëri dhe respekt për trashëgiminë kulturore dhe ruajtjen e saj.

ÇFARË ËSHTË ARTI DHE CILI ËSHTË ROLI I TIJ?

Arti është pjesë e jetës së çdo njeriu, edhe kur nuk jemi të vetëdijshëm për praninë e tij. Ai na rrethon – në pamjen e objekteve që përdorim, në ngjyrat e hapësirës ku jetojmë, në muzikën që dëgjojmë, në filmat dhe librat që përjetojmë, në modë, fotografi dhe në mënyrën si e shprehim vetveten. Por çfarë kuptimi ka saktësisht fjala "art"?

TERMA KYÇ:

Artet pamore,
Disiplinat e artit,
Roli shoqëror i artit

Arti është një krijim njerëzor që përmes formave të ndryshme – pikturë, skulpturë, muzikë, letërsi, vallëzim e të tjera – përcjell ndjenja, mendime, ide dhe simbole. Ai nuk është vetëm zbukurim apo argëtim. Arti komunikon, nxit mendimin, zgjon emocione, ngre pyetje dhe na ndihmon të kuptojmë më mirë veten dhe botën përreth.

Gjatë historisë, roli i artit ka ndryshuar bashkë me rrethanat shoqërore, kulturore dhe shpirtërore. Në parahistori, arti kishte funksion magjik ose ritual, shpesh i lidhur me gjuetinë apo pjellorinë. Në qytetërimet e lashta, arti ishte i lidhur ngushtë me fenë, pushtetin dhe ideologjinë. Arti mesjetar zakonisht përdorej për të lavdëruar fenë. Gjatë Rilindjes, fokusi u zhvendos te njeriu, shkenca dhe natyra. Më vonë, me zhvillimin e shoqërisë moderne, arti u bë një mjet për kritikë, rrëfim personal apo eksperimentim me forma, media dhe mesazhe të reja.

Arti pamor përfshin shprehje vizuale që përjetohen kryesisht përmes të pamurit: pikturë, skulpturë, arkitekturë, grafikë, fotografi, dizajn e të tjera. Këto fusha mund të klasifikohen sipas:medias (p.sh. arti mbi gur, mbi kanavacë, arti digjital),funksionit (zbukurues, funksional, konceptual),ose mënyrës së shprehjes (realiste, abstrakte, simbolike).



Shpella e Duarve (Cueva de las Manos), Perito Moreno, Argjentinë – datohen nga viti 7300 para erës sonë deri në vitin 700 të erës sonë



Hieroglife tipike nga periudha greko-romake – përdorur për të paraqitur idetë fetare dhe politike të kohës



"Guernica" – Pablo Picasso – 1937

Arti është një nga format më të hershme të komunikimit. Përmes tij, njerëzit kanë shprehur mendime, ndjenja, besime, qëndrime dhe vlera. Ai përfaqëson një bashkim unik mes racionales dhe emocionales, mes asaj që mund të shihet dhe asaj që ndihet. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për një pikturë shkëmbore, një piramidë egjiptiane, një ikonë bizantine, një afreskë të Rilindjes, një pikturë abstrakte, një instalacion modern apo një animacion digjital – të gjitha janë pjesë e tregimit të madh të quajtur art.

Në çdo epokë, arti është pasqyrë e shpirtit të njeriut. Ai pasqyron botëkuptimin e tij, vlerat, aspiratat dhe frikërat. Prandaj, nuk ka një përkufizim të vetëm që mund ta përshkruajë artin plotësisht – pikërisht sepse arti vazhdimisht ndryshon dhe zhvillohet, ashtu si vetë shoqëria. Jo çdo krijim njerëzor konsiderohet automatikisht si art. Ajo që e dallon veprën artistike nga produktet e tjera është vlera e saj simbolike, shprehëse dhe estetike.

Vepra artistike komunikon me shikuesin në një nivel më të thellë, shpesh jo material – zgjon ndjenja, ngre PYETJE dhe hap dritare drejt ideve të reja.

Vepra artistike ka një natyrë shumështresore. Ajo është njëkohësisht:një objekt material,një shprehje e vizionit të artistitdhe bartëse e një mesazhi. Arti na sfidon të shohim me një tjetër vështrim, të mendojmë në mënyrë kritike dhe të përpiqemi të kuptojmë diçka që jo gjithmonë mund të thuhet me fjalë.

AKTIVITET

Vizato ose imagjino një objekt të jetës së përditshme (p.sh. një palë këpucë, një filxhan, një karrige) dhe shndërroje në vepër arti.
Mendo si, përmes formës, ngjyrës apo simbolit, mund t'i japësh atij një kuptim të ri.
Nën skicë, shkruaj pse mendon se mund të konsiderohet art.

Arti dhe shoqëria

Arti nuk lind në izolim. Ai është gjithmonë i lidhur me kohën dhe vendin në të cilin është krijuar. Mund të jetë pasqyrë e epokës së vet, por edhe zë i rezistencës, simbol i identitetit apo thirrje për ndryshim. Në të ndihen ndikimet politike, kulturore dhe ekonomike. Ai pasqyron idealet, betejat dhe vlerat.

Njëkohësisht, arti është edhe mjet për ruajtjen e kujtesës kolektive. Përmes tij, mësojmë për jetën, besimet, shijet dhe aspiratat e njerëzve të së kaluarës. Ai është dëshmi, por edhe interpretim i historisë.

Në botën bashkëkohore, arti është gjithnjë e më afër jetës së përditshme. E ndeshim në rrugë si grafitë apo skulptura publike, në media, në reklama, në platforma digjitale. Ai bëhet më i arritshëm, më i larmishëm, më i papritur – dhe pikërisht për këtë mbetet një pjesë thelbësore e kulturës sonë.



Michelangelo, "Pietà", 1499

AKTIVITET

Shiko disa vepra arti nga periudha të ndryshme(p. sh. pikturë shkëmbore, ikonë, pikturë të Rilindjes, instalacion modern). Përpiqu të përgjigjesh:Çfarë e bën atë vepër "artistike"?Çfarë emocione, ide apo mesazhe përcjell?Në cilën kategori sipas fushës pamore do ta vendosje?

A E DINI SE

- Disa nga veprat më të famshme të artit në histori janë krijuar për qëllime rituale, ndërsa sot janë të ekspozuara në muze?
- Një nga objektet më të vjetra artistike është figura e vogël e Venusit të Willendorfit, e vjetër rreth 25 000 vjet?

PYETJE

1. Çfarë është arti dhe në ç'mënyra mund të përkufizohet?
2. Si ka ndryshuar roli i artit përgjatë historisë?
3. Cilat janë fushat kryesore të artit pamor?
4. Në ç'mënyrë arti komunikon me publikun?

ARTI PARAHISTORIK

Parahistoria përfaqëson periudhën më të lashtë dhe më të gjatë të historisë njerëzore, që fillon me shfaqjen e njerëzve të parë dhe përfundon me zhvillimin e shkrimit dhe të qytetërimeve të para. Në këtë periudhë, njerëzit nuk kishin gjuhë të shkruar, por kanë lënë gjurmë të rëndësishme vizuale përmes vizatimeve, skulpturave, qeramikës dhe strukturave arkitektonike. Parahistoria ndahet në disa faza kryesore: paleoliti, mezoliti dhe neoliti, prej të cilave paleoliti (epoka e gurit të vjetër) dhe neoliti (epoka e gurit të ri) janë më të rëndësishmet nga këndvështrimi i shprehjes artistike. Gjatë kësaj periudhe, arti kishte funksion magjik, ritual, kultik dhe praktik, dhe objektet që krijonte njeriu ishin ngushtësisht të lidhura me jetën e tij të përditshme dhe përpjekjet për të shpjeguar dhe kontrolluar botën përreth.

TERMA KYÇ:

Paleolit, Neolit, Pikturë në shpella, Venusi i Willendorfit, Nëna e Madhe, Qeramikë, Ornament, Stonehenge,Göbekli Tepe, Megalit, Modelim, Gdhendje, Simetri, Reliev, Paleoliti

Paleolitik

Një nga format më mbresëlënëse të artit të paleolitit është piktura në shpella. Në shpellat e Altamirës në Spanjë dhe në ato të Lasko dhe Shove në Francë janë zbuluar piktura murale që paraqesin kafshë si bizonë, kuaj, drerë dhe demë. Pikturat janë realizuar me pigmente natyrore si okër, qymyr dhe oksid hekuri, të aplikuara me gishta, pendë, qime kafshësh ose duke fryrë bojën nëpërmjet gypave. Në disa raste, muret janë gdhendur para se të vendoseshin ngjyrat, gjë që krijon teksturë dhe hije shtesë. Karakteristikat figurative të këtyre pikturave dallohen për konture të qarta, silueta të theksuara dhe hijëzim me kalime tonale për të dhënë volum. Disa kafshë janë paraqitur në lëvizje, me një dinamikë të theksuar, ndërsa kompozimi i pikturave shpesh nuk ka një fokus qendror, me mbivendosje dhe drejtime të ndryshme të figurave, gjë që tregon se elementët janë shtuar gradualisht në periudha të ndryshme.



Kuajt shpella Lasko paleolit




Bizoni shpella Altamira paleolit

A E DINI SE

Pikturat në shpella janë krijuar në errësirë të plotë, thellë në brendësi të shpellave, ku artistët përdorin llamba të mbushura me dhjamë kafshësh për të ndriçuar muret ndërsa pikturonin?

Skulptura paleolitike

Përveç pikturave, paleoliti është i njohur edhe për figurat e vogla femërore, të quajtura „Venusë". Më e famshmja ndër to është Venusi i Willendorfit, e krijuar rreth 25.000 vjet më parë, 11 cm e lartë, që paraqet një trup femëror me karakteristika të theksuara seksuale –gjoks të madh, bark dhe vithe të rrumbullakosura, ndërsa fytyra është mezi e dukshme ose fare e munguar. Këto skulptura, të vogla disa centimetra, janë punuar nga gurë, kocka ose argjilë dhe ishin të lëvizshme, gjë që tregon për funksionin e tyre personal ose ritual. Forma është e rrumbullakët dhe kompakte, me shpërndarje simetrike, dhe sipërfaqja shpesh është e lëmuar, e punuar me gur. Teknikat e përdorura përfshinin modelimin, gdhendjen dhe gërryerjen, në varësi të materialit. Simbolika e këtyre skulpturave lidhet me pjellorinë, mëmësinë dhe mbijetesën e komunitetit.



Venusi i Willendorfit, Austri, rreth 25.000 p.e.s.

Neoliti

Me kalimin në vendbanime të përhershme, njerëzit filluan të ndërtonin struktura të qëndrueshme nga tulla, gurë, thupra dhe argjilë. Shtëpitë zakonisht kishin bazë drejtkëndëshe, çati të rrafshët dhe hapësirë qendrore me vatër, që shërbente për gatim, ngrohje dhe mbledhje familjare. Në vendbanimin Çatal Hüyük (në Turqinë e sotme), shtëpitë ishin të vendosura ngjitur njëra me tjetrën, pa rrugë ndërmjet, dhe hyrja bëhej përmes një hapjeje në çati. Brendësia shpesh zbukurohej me piktura murale, objekte simbolike dhe figura argjile, çka tregon për një lidhje të fortë mes jetës së përditshme dhe asaj shpirtërore.



Stonehenge, Angli, rreth 2500 p.e.s.

Përveç banesave, njerëzit e neolitit ndërtuan edhe hapësira monumentale rituale. Një nga më të njohurat është Stonehenge në Angli- një kompozicion rrethor me blloqe të mëdhenj guri, të vendosur vertikalisht dhe horizontalisht. Gurët janë radhitur sipas orientimeve astronomike, çka sugjeron funksione kalendarike, rituale dhe astronomike. Një tjetër shembull i rëndësishëm është Göbekli Tepe, një tempull në Turqinë e sotme, i vjetër rreth 11.000 vjet. Ai përbëhet nga shtylla të mëdha prej guri, të zbukuruara me reliefe që nparaqesin kafshë, skena nga natyra dhe simbole abstrakte, dhe konsiderohet qendra më e vjetër fetare e njohur në botë.




Shtëpitë në Çatal Hüyük, Turqi, neolit

AKTIVITET

Krijo një skulpturë të vogël nga argjila që simbolizon një vlerë për ty (p.sh. mbrojtje, bashkim, guxim).

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në neolit është shfaqja e qeramikës. Fillimisht, ene balte përdoreshin të modeluara me dorë, ndërsa më vonë edhe me rrota të thjeshta qeramikash. Këto enë përdorej për ruajtjen e ushqimit, ujit dhe drithërave, por njëkohësisht zbukuroheshin me ornamente gjeometrike: vija paralele, trekëndësha, spirale, valë dhe pika. Ornamentet përdoreshin me gdhendje, stampim ose shenjim, duke përdorur guaska, tekstile ose dru. Format e enëve ishin zakonisht simetrike dhe të rrumbullakosura, me buzë dhe doreza të punuara me kujdes, gjë që tregon për një ndjeshmëri të zhvilluar ndaj dizajnit dhe funksionit. Sipërfaqja ishte e lëmuar, dhe shpesh i shtoheshin ngjyra natyrore para pjekjes, si e kuqe, e zezë apo e bardhë.



Enë me ornament spiral, Evropa Juglindore, neolit

A E DINI SE

Disa motive të qeramikës neolitike janë të ngjashme me ato që shfaqen edhe sot në artin popullor, sidomos në thurje dhe qëndisje?

AKTIVITET

Vizato ose modeloni një enë qeramike të zbukuruar me ornamente të frymëzuara nga diçka që ka kuptim për ty, si: familja, tradita, dielli, jeta.



Figurë balte me formë njerëzore, Tepe Sarab, Kermanshah

Karakteristikat vizuale të këtyre strukturave janë të thjeshta dhe të fuqishme:forma massive, shpërndarje e saktë,simetri dhe organizim hapësinor. Relievet janë të cekët, të krijuara me gdhendje dhe gërryerje, ndërsa kafshët janë të paraqitura në mënyrë të stilizuar, me theks në forcë dhe simbolizëm. Teknikat ndërtimore përfshinin përpunimin dhe transportin e megaliteve pa përdorimin e mjeteve metalike apo rrotës, gjë që përbën një arritje teknike mbresëlënëse.

PYETJE

1. Cilat janë karakteristikat kryesore pamore të pikturës në shpella dhe si realizoheshin ato?
2. Si duken figurat e Venusit nga paleoliti dhe çfarë simbolizojnë?
3. Çfarë teknika janë përdorur për prodhimin dhe zbukurimin e qeramikës në neolit?
4. Çfarë ndërtesash rituale u shfaqën në neolit dhe si njihen ato?
5. Cilat janë dallimet mes artit paleolitik dhe atij neolitik?

AKTIVITET

Ndërto një maket të një tempulli duke përdorur gurë të vegjël, argjilë ose letër.
Përpiqu të krijosh një strukture me radhitje rrethore ose shpik një ornament për hapësirën e brendshme.

ARTI EGJIPTIAN

Qytetërimi i lashtë egjiptian u zhvillua në kryqëzimin mes Afrikës, Azisë dhe Europës, përgjatë lumit Nil, më shumë se 5.000 vjet më parë, dhe ekzistoi për gati tre mijëvjeçarë. Arti egjiptian është ngushtësisht i lidhur me fenë, rendin shtetëror dhe konceptin e përjetësisë. Ai nuk krijohej vetëm për bukuri, por për të siguruar përjetësinë e shpirtit, për të nderuar perënditë dhe për të vërtetuar fuqinë e faraonit. Falë qëndrueshmërisë së shoqërisë dhe klimës së thatë, shumë nga këto vepra janë ruajtur deri në ditët tona.

TERMA KYÇ:

Arti egjiptian, piramidë, tempull, kanon, regjistra, gdhendje e tejpërshkueshme, papirus, hieroglife

Arkitektura – piramida, tempuj dhe rregull i përjetshëm

Monumentet më madhështore të artit egjiptian janë piramidat – varre mbretërore për faraonët. Më e madhja, Piramida e Keops, e ndërtuar rreth vitit 2600 p.e.s. në Giza, ishte ndërtesa më e lartë në botë për gati 4.000 vjet. Piramidat u ndërtuan me gjeometri të saktë dhe blloqe të mëdha guri, me qëllimin që të qëndrojnë përgjithmonë. Në qendër të piramidës ndodhej dhoma e varrit me sarkofagun – një arkë prej guri ku vendosej arkivoli prej druri me trupin e faraonit.



Giza – Egjipt

Zhvillimi i varreve egjiptiane pasqyron një besim të thellë në jetën pas vdekjes dhe një përpjekje për përjetësi. Varret më të hershme, të quajtura mastaba, ishin ndërtesa të ulëta me formë drejtkëndëshe, si piramida të shkurtra, të ndërtuara nga tulla, me një dhomë të nëndheshme për varr – sarkofagun. Më vonë, në Mbretërinë e Vjetër, këto u zhvilluan në piramida të plota. Në Mbretërinë e Re, ndërtimi i piramidave u braktis, dhe varret filluan të gdhendeshin thellë në shkëmbinj. Shumica e këtyre varreve ndodhen në vendin e quajtur Lugina e Mbretërve, në bregun perëndimor të Nilit, përballë Tebës (sot Luksor). Brendësia e tyre ishte e zbukuruar pasurisht me piktura dhe tekste, që kishin për qëllim të udhëzonin të ndjerin në botën e të vdekurve. Varret nuk ishin vetëm vende pushimi, por shtëpi të përjetshme për shpirtin.



Tempulli i Karnakut

Përpara piramidave qëndron Sfinga e Madhe – një skulpturë monumentale me trup luani dhe fytyrë faraoni, që ruan simbolikisht portat e përjetësisë.

Tempujt, si ata në Karnak, Luksor apo Edfu, ishin të kushtuar perëndive dhe faraonëve. Ndërtoheshin me shtylla dhe porta monumentale (pilonë), me skulptura të faraonit dhe obeliskë në hyrje, gjithmonë me strukturë simetrike, të orientuar sipas diellit dhe yjeve. Muret ishin të zbukuruara me reliefe dhe hieroglife, të cilat rrëfenin historinë e sundimit dhe ritualet fetare.

A E DINI SE

- Piramida e Keops përbëhej nga mbi 2.300.000 blloqe guri, secili me peshë prej disa tonësh?
- Egjiptianët besonin se statuja ishte "banesa e shpirtit"?

AKTIVITET

Pikturo si një Egjiptian – në letër kafe ose ngjyrë të verdhë të çelët, krijo një vepër në stilin e freskove egjiptiane.

Skulptura – fytyra të përjetshme në gur

Skulpturat në Egjipt ishin krijuar për jetën e përtejme – për t'i shërbyer të ndjerit në përjetësi. Më së shpeshti përfaqësonin: faraonë,perëndi,shkrues dhe zyrtarë. Të gjitha skulpturat ndiqnin rregulla të rrepta: Figurat ishin frontale, simetrike dhe statike, në qetësi të plotë. Duart ishin të lëshuara pranë trupit, këmbët në një qëndrim të hapur,shikimi përpara,dhe asnjë shprehje emocionale në fytyrë. Nuk kishte hapësira të zbrazëta midis pjesëve të trupit (pa perforacione), forma ishte kompakte dhe solide, duke simbolizuar qëndrueshmëri. Materialet e përdorura përfshinin: diorit, granit,gëlqeror,dru,dhe skulpturat shpeshherë ishin të lyer me ngjyra. Shembujt më të famshëm janë: Shkrimtari i ulur dhe Busta e Nefertitit.



Mbretëresha Nefertiti



Skulptura e shkruesit



Maska e artë e mbretit Tutankhamon

Piktura

Pikturat egjiptiane gjenden në muret e varrezave dhe tempujve, e ndonjëherë edhe në papirusë. Ato shërbenin si vizione të jetës së përtejme, për t'i ndihmuar të vdekurit të jetonte përjetë. Tiparet kryesore të pikturës janë: sipërfaqësore, dy-dimensionale, pa hije, mbi bazë të ndritshme, me ngjyra të gjalla, sipas një rregulli të rreptë të paraqitjes së trupit në një perspektivë të dallueshme: koka dhe këmbët në profil, syri në formë bajameje dhe torzoja e paraqitur përballë, mungesë e perspektivës reale – figurat janë të vendosura në rreshta horizontalë (registra). Përdoroheshin pigmente natyrore me kuptim simbolik, ndërsa temat ishin skena nga jeta e përditshme, gjykimi i shpirtit, mitet dhe ritet.

Simbolika kishte rol kyç në artin egjiptian, duke e shndërruar në një gjuhë vizuale të mbushur me domethënie. Çdo ngjyrë, formë apo pozicion kishte kuptim simbolik. Për shembull, **e kuqja** nënkuptonte jetën dhe energjinë, por edhe rrezikun; **e zeza** – tokën pjellore dhe rigjenerimin; **ari** – përjetësinë dhe hyjninë. Figura e faraonit shpesh paraqitej më e madhe se të tjerat për të theksuar rëndësinë e tij. Edhe kafshët kishin funksion simbolik. **Shpendi skifter** përfaqësonte zotin Horus, skarabeu – rilindjen, ndërsa **sfinksi** – mbrojtjen dhe fuqinë. Simbolika i jepte artit një dimension shpirtëror, duke e shndërruar në një mjet për lidhje me hyjnitë dhe sigurimin e rendit të përjetshëm.



Fragment nga pikturë murale egjiptiane

A E DINI SE

- Egjiptianët besonin se statuja ishte "banesa e shpirtit"?
- Edhe pse sot i shohim si të bardha, tempujt dhe skulpturat ishin të lyera me ngjyra të gjalla?
- Kanoni egjiptian i përmasave përdorte një rrjetë prej 18 katrorësh – nga këmbët deri te sytë?

PYETJE

1. Cilat ishin karakteristikat kryesore të arkitekturës egjiptiane?
2. Pse skulpturat realizoheshin me forma të mbyllura, pa hapësira të zbrazëta (pa perforacione)?
3. Si e paraqet piktura egjiptiane trupin e njeriut?
4. Cili është kuptimi i ngjyrave në artin egjiptian?
5. Si lidhej arti me besimin në jetën e përtejme?

AKTIVITET

1. Modelo një skulpturë egjiptiane nga argjila – mund të përfaqësojë një faraon, shkrues ose hyjni. Mundohu të pasqyrosh tiparet karakteristike të atyre figurave. Merr një "shkrim të fshehtë" në hieroglife.

2. Mundohu të zbulosh kuptimin e tij. Pastaj, krijo një sistem tëndin simbolik dhe shkruaj një mesazh sekret që vetëm bashkëmoshatarët e tu do ta lexojnë duke e deshifruar.

ARTI MESOPOTAM

Mesopotamia, që do të thotë "toka mes lumenjve", ndodhet midis Tigrit dhe Eufratit – një rajon pjellor ku u zhvilluan qytetërimet e para: Sumerët, Akkadianët, Babilonasit dhe Asirianët. Këta popuj krijuan një art që pasqyronte fenë, pushtetin dhe jetën e përditshme. Arti mesopotam shënon fillimin e artit në shoqëritë urbane, duke vënë theks në funsionalitet, simbolikë dhe monumentalitet.

Një ndër aspektet më mbresëlënëse të artit mesopotam është arkitektura. Në qendër të çdo qyteti ngrihej zigurati – një tempull me shumë nivele dhe bazë drejtkëndëshe, i ndërtuar me tulla. Forma e tij ngrihej mbi qytet, duke simbolizuar lidhjen midis njerëzve dhe perëndive. Ndryshe nga piramidat egjiptiane, ziguratët nuk shërbenin si varre, por si qendra për rituale fetare. Më i njohuri ndër ta është Zigurati i Urit, i ndërtuar rreth vitit 2100 p.e.s.

Të veçanta janë Portat e Ishtarit në Babilon, që ishin pjesë e një rruge të madhe ceremoniale.

TERMA KYÇ:

Zigurat, shkrim me kunj (klinor), vulë cilindrike, frontalitet, reliev



Zigurati i Ur-it

Ato ishin të zbukuruara me: tulla të smaltuara në ngjyrë blu,figura në reliev të luanëve, dema dhe dragojve. Ky art kombinon zbukurimin me simbolikën e pushtetit dhe mbrojtjes. Mendohet se:luanët përfaqësonin perëndeshën Ishtar,ndërsa dragojtë dhe demat simbolizonin zota mbrojtës dhe forca hyjnore.

AKTIVITET

Imagjino se je arkitekt në Mesopotaminë e lashtë.
– Vizato një zigurat nga jashtë, trego nivelet dhe shkallët e tij,
– Shkruaj një shpjegim të asaj që ndodh brenda tempullit.

A E DINI SE

- Mesopotamianët besonin se ziguratët ishin "shkallë drejt qiellit", që lidhin njerëzit me perënditë.
- Portat e Ishtarit ishin pjesë e njërit prej hyrjeve më mbresëlënëse të qyteteve antike, të zbukuruara me detaje në smalt blu, të cilat sot ruhen në një muze në Berlin.




Porta e Ishtarit

Skulptura mesopotamiane shpesh kishte karakter tregimtar dhe simbolik. Figurat paraqiteshin në qëndrim statik, me: sy të mëdhenj të shënuara me bitumen, duar të bashkuara në lutje, forma trupore simetrike,por me pak saktësi anatomike. Personazhet nuk shprehnin emocione, por qetësi dhe përulësi, duke pasqyruar funksionin e tyre fetar. Një element i zakonshëm ishte frontaliteti – figura shikon drejt përpara, sikur ndodhet përballë një hyjnie. Statujat sumere të tempujve, si ato nga Tell Asmar, paraqesin besimtarë që qëndrojnë qetësisht përpara zotit. Po ashtu, hasim figura sundimtarësh me mjekra të gjata, në pozicion force dhe dinjiteti. Relievet asirianë– skena mbretërore dhe ideale Asirianët krijuan relieve monumentale në pallatet e tyre, që paraqesin:skena gjuetie,beteja dhe jeta e mbretërve. Këto relieve paraqesin figura njerëzore të idealizuara, me raporte të qarta hierarkike – personazhet më të rëndësishëm paraqiten më të mëdhenj.



Fragment relievi



Statuja e Ittur-Shamaẓam – rreth 2500 p.e.s.

Shkrimi kishte një rol të rëndësishëm në artin mesopotamian. Përdorej shkrimi klinor, i cili gdhendej mbi pllaka balte duke përdorur një shkop të mprehtë prej druri. Përveç funksionit për të shkruar, këto shenja kishin edhe rol zbukurues, veçanërisht në pllakat dhe vulat. Vulat cilindrike ishin cilindra të vegjël me skena të gdhendura, që përdoreshin për të nënshkruar dokumente, duke lënë gjurmë në baltë si një lloj firme personale.

Simbolikë dhe mesazh Arti mesopotamian është dëshmi e një bote që besonte në fuqinë hyjnore, por edhe në një shoqëri të organizuar njerëzore. Ai përfaqëson përpjekjen e njeriut për të vendosur rend dhe stabilitet, në një mjedis të ndryshueshëm dhe shpesh të ashpër.



Shkrim klinor mbi pllakë balte

AKTIVITET

Në grup, krijoni një "reliev prej letre" që paraqet një skenë gjuetie ose rituali fetar, të ngjashme me ato të Asirianëve. Në një pllakatë balte (ose kartoni), përpiquni të shkruani një mesazh të shkurtër, duke përdorur simbole të frymëzuara nga shkrimi klinor.



Statuja e Gudea-s, 2900 p.e.s.

PYETJE

1. Çfarë do të thotë fjala "Mesopotami" dhe ku ndodhej ky rajon?
2. Çfarë është një zigurat dhe çfarë roli kishte në qytetet mesopotamiane?
3. Cilat janë karakteristikat e skulpturës mesopotamiane?
4. Çfarë funksioni kishin vulat cilindrike?
5. Në çfarë mënyre Portat e Ishtarit dallohen nga elementët e tjerë arkitekturorë?

A E DINI SE

Kodi i Hamurabit, ligji më i vjetër i njohur i shkruar, ishte i gdhendur në një pllakë të lartë bazalti, dhe i zbukuruar me një reliev që paraqet perëndinë dhe mbretin?

ARTI EGEJAN

Paralajmërues i Greqisë së lashtë

Arti egejan është zhvilluar rreth Detit Egje gjatë mijëvjeçarit III dhe II para erës sonë, si pjesë e kulturave që i paraprinë botës klasike greke. Qytetërimet kryesore të kësaj periudhe janë: **cikladikët, minoikët dhe mikenasit**. Secili prej tyre ka lënë gjurmë të rëndësishme në art dhe arkitekturë, që tregojnë shumë për jetën shpirtërore dhe të përditshme të popujve të asaj kohe.

TERMA KYÇ:

Arti cikladik, arti minoik, afresk, arti mikenas, Porta e Luanëve, tholos (varr i rrumbullakët)

Arti cikladik

Arti cikladik u zhvillua në Ishujt Cikladë dhe njihet kryesisht për figurat e vogla prej mermeri. Këto statuja, zakonisht femërore, kanë një formë të thjeshtë dhe gjeometrike, me duart e bashkuara mbi bark. Ato janë simbolike dhe misterioze, ndoshta të lidhura me kultin e pjellorisë ose me rite për të vdekurit. Megjithëse të thjeshta, ato shfaqin një elegancë të spikatur dhe ndjeshmëri ndaj formës, dhe shpesh konsiderohen si paralajmërim i skulpturës moderne.

A E DINI SE

Disa figura cikladike kanë qenë të lyera me ngjyra, të cilat sot janë zhdukur, por shkencëtarët i zbulojnë përmes teknikave speciale moderne?

AKTIVITET

Krijo një figurë të vogël femërore nga argjilë ose plastelinë, me duart e bashkuara mbi bark, e frymëzuar nga stili cikladik. Lyere me ngjyrë të bardhë që të ngjasojë me pamjen origjinale të mermerit cikladik. Mendo për simbolikën e saj – A është një perëndeshë, një grua e zakonshme, apo ndonjë figurë tjetër? Vendose figurën mbi një bazament dhe prezantoje si një ek-sponat muzeor.



Statujë femërore cikladike me duart të bashkuara mbi bark

Arti minoik

Arti minoik është zhvilluar në ishullin e Kretës, veçanërisht në qytetin Knosos. Qytetërimi minoik krijoi pallate të ndërlikuara me afreske shumëngjyrëshe, oborre me ngjyrë blu të çelët dhe strukturë labirintike. Më të njohurat janë **afresket** që paraqesin: skena nga natyra, të rinj në lëvizje, akrobatë që kapërcejnë dema,dhe jeta detare. Stili është dinamik, me ngjyra të ndritshme dhe me një dashuri të dukshme për jetën. Arti minoik është paqësor dhe dekorativ, pa skena lufte. Arkitektura është e pasur me: shtylla,tarraca dhe mure të zbukuruara me afreske dhe qeramikë.



Afresk nga Pallati i Knososit



Pallati i Knososit

A E DINI SE

- Pallati i Knososit kishte më shumë se 1.000 dhoma, korridore të ngatërruar dhe një sistem furnizimi me ujë? Për këtë arsye, shpesh lidhet me mitin e Labirintit dhe Minotaurit.
- Arkitektura e pallatit të Knososit, me strukturën e tij labirintike, inspiron legjendën e Minotaurit?



Qeramikë minoike me motive spirale dhe natyrore

AKTIVITET

Në letër të lyer me kafe ose çaj (për një efekt muri të vjetër), pikturoni një peizazh deti, kafshësh ose lëvizje akrobatike në stilin e afreskeve minoane. Botë detare,kafshë, ose lëvizje akrobatike,në stil minoik – me ngjyra të gjalla dhe lëvizje të rrjedhshme.

Arti mikenas

Arti mikenas u zhvillua në gadishullin e Peloponezit, veçanërisht në qytetin Mikena. Në dallim nga arti minoik, arti mikenas është i lidhur me fuqinë ushtarake. Qytetet ishin të fortifikuara me mure masive, dhe **Porta e Luanëve nga** Mikena është një nga shembujt më të hershëm të skulpturës monumentale në Europë. Gjenden gjithashtu: **maska ari**,armë të zbukuruara me gdhendje, dhe varre me formë kupole (tholosë). Mikenasit përdorën më shumë: reliev, dhe formë realiste në art,edhe pse shpesh me elemente simbolike.

AKTIVITET

Studio kompozimin e Portës së Luanëve dhe përpiqu ta vizatosh. Mendo pse janë përdorur luanët dhe çfarë simbolizojnë ata.



Porta e Luanëve në Mikena

A E DINI SE

Maska e artë e Agamemnonit, me shumë gjasë nuk i përkiste vetë Agamemnonit, por gjithsesi ka mbetur me atë emër?

PYETJE

1. Cilat janë karakteristikat e statujave cikladike?
2. Çfarë paraqesin afresket minoike dhe si është stili i tyre?
3. Cili është shembulli më i rëndësishëm i skulpturës monumentale në Mikena?



Maska e artë (e quajtur "Maska e Agamemnonit")

ARTI I GREQISË SË LASHTË

Përsosmëri në formë dhe përpjesëtim

Arti i Greqisë së lashtë është themeli i kulturës pamore evropiane, përmes së cilës Evropa dallohet dhe ndahet nga çdo civilizim tjetër. Ky art është zhvilluar në: territorin e sotëm të Greqisë, në Azinë e Vogël (Turqinë lindore), dhe në Italinë jugore, nga rreth vitit 1100 p.e.s. deri në vitin 31 p.e.s.. Ai përfshin periudha të ndryshme: gjeometrike,arkaike,klasike dhe helenistike, derisa u zëvendësua nga arti romak. Gjatë mijëvjeçarit të parë para erës sonë, arti grek përfshinte: arkitekturë,skulpturë, pikturë mbi vazodhe art dekorativ. Për grekët e lashtë, arti nuk ishte thjesht zbukurim, por një shprehje e mendimit, rendit shoqëror dhe marrëdhënies së njeriut me natyrën. Vlerat kryesore ishin:harmonia,ekuilibri, masa, dhe bukuritë ideale. Këto vlera shfaqen në: format e tempujve, përfaqësimin e njeriut, dhe simetrinë hapësinore.


TERMA KYÇ:

Partenoni, Erehteioni, rendi dorik, rendi jonik, rendi korintas, fronton, kolonadë, kuroi/kora, kontraposto, Fidias, helenizëm, teknika figurale me të zeza, teknika figurale me të kuqe, Eksehias, amfora panatenaike

Arkitektura

Arkitektura greke është e njohur për rreptësinë, simetrinë dhe përmasat e përsosura. U zhvilluan tre rendet arkitektonike kryesore: **dorik, jonik** dhe **korintas**. Përveç tempujve dhe teatrove, ndërtesa të rëndësishme ishin edhe: **gimnazi** (vendi për stërvitje dhe mësim), **bibliotekat**,të cilat ishin qendra të arsimit dhe jetës kulturore. **Rendi dorik** është më i vjetri dhe më i thjeshti: kolonat janë masive, me thekime (grooves), ngushtohen nga poshtë-lart, nuk kanë bazë,kapiteli është i thjeshtë.

Rendi jonik ka kolona: më të holla dhe më të gjata,me bazë të dekoruar,kapitel me voluta (spirale). **Rendi korintas** është më i zbukuruari: kapiteli është në formën e gjetheve të akantit, dhe u përdor më shumë në periudhat e mëvonshme.



Renditë dorik, jonik dhe korintas – Greqia e lashtë

Partenoni është një tempull i kushtuar perëndeshës Athena, ndërtuar mbi Akropolin e Athinës në shekullin V p.e.s.. Ai është ndërtuar në stil dorik, me elemente jonike. Përmasat e tij janë llogaritur sipas një raporti ideal, që krijon ekuilibër vizual. Tempulli është ndërtuar mbi një bazament të ngritur me shkallë, i rrethuar me kolonada me shtylla. Në brendësi ndodhej një skulpturë gjigante e Athenës, punuar nga Fidiasi. Tempulli nuk ishte vetëm vend nderimi për hyjnitë, por edhe simbol i fuqisë politike dhe identitetit kulturor të polis-it (qytet-shtet).

AKTIVITET

Vizato Partenonin dhe shëno elementet kryesore: frontonin,metopat,-frizin,kapitelin,kolonadat.



Partenoni, Athinë, shek. V p.e.s.



Erëhteioni, Athinë, shek. V p.e.s.

Përveç Partenonit, **Erëhteioni** është një tempull i rëndësishëm,i njohur për strukturën e tij asimetrike dhe verandën me kariatide – figura femërore që shërbejnë si shtylla arkitektonike. Ky tempull tregon se arkitektura greke arrinte ekuilibër edhe në forma të ndërlikuara dhe jo standarde.

Arkitektura nuk kufizohej vetëm në tempuj. Janë ndërtuar edhe:teatro (si ai në Epidaur),agora (shesh publike),buletarione (salla këshillimi),dhe stadiume. Teatrot ishin të hapur dhe kishin akustikë të jashtëzakonshme, me formë gjysmë-rrethore. Në to luheshin tragjedi dhe komedi si pjesë e festimeve fetare në nder të Dionisit. Struktura teatrore përfshinte:orkestrën (rrethi qendror),skenën (hapësira e aktorëve),dhe teatronin (ulëset e publikut).

Qytetet ndërtoheshin sipas një plani të qartë urbanistik, me rrugë që prereshin në kënde të drejta,gjë që tregon një organizim të përparuar qytetar. Shtëpitë kishin oborre të brendshme, ndërsa ndërtesat publike ishin estetikisht të lidhura me funksionin e tyre.



Teatri i Epidaurit, shek. IV p.e.s.

A E DINI SE

Arkitektët e Partenonit i kanë lakuar qëllimisht kolonat (efekti i quajtur entasis) për t'i bërë që të duken drejt nga perspektiva e njeriut.

Skulptura

Skulptura ishte shprehja më e fuqishme e mendimit grek për njeriun.

Më së shpeshti paraqiteshin perëndi dhe perëndesha si Apolloni, Afrodita dhe Athena, si edhe heronj mitologjikë. Në periudhat e vona u shfaqën edhe skulptura portretike të personaliteteve historike dhe filozofëve. Ajo kaloi nëpër tre faza stilistike: **periudha arkaike, klasike dhe helenistike**.

Periudha arkaike (shek. VII–VI p.e.s.)

Figura është simetrike, frontale, me qëndrim të ngurtë dhe të ashtuquajturin "buzëqeshje arkaike". Më të njohura janë **kurosët** (djem të rinj lakuriq) dhe **korët** (vajza të veshura), të cilat kryesisht lidhen me kultet fetare.

Periudha klasike (shek. V–IV p.e.s.)


Skulptura arrin një shkallë të lartë realizmi dhe harmonie. Figura merr një qëndrim më natyral falë teknikës së **kontrapostit** – pesha zhvendoset në njërën këmbë, duke krijuar lëvizje dhe qetësi. Veprat e **Fidias, Mironit** dhe **Polikletit** (si Diskoboli dhe Dorifori) janë shembuj të estetikës klasike. Në këtë periudhë mbizotërojnë trupat e idealizuara, shprehjet e përmbajtura dhe anatomia e përsosur.

Periudha helenistike (shek. III–I p.e.s.)

Shfaqen ekspresioni, drama dhe emocioni. Skulpturat paraqesin skena me vuajtje, pleqëri, lëvizje dhe kompozime të ndërlikuara. Shembuj të njohur janë **Laokooni dhe bijtë e tij, Fitorja me krahë e Samothrakës** dhe **Venusi i Milos-it.**



Laokoonti dhe djemtë e tij, Rodos, shek. II p.e.s.



Kora, autor i panjohur, periudha arkaike, shek. VII–VI p.e.s.



Diskoboli, Mironi, rreth vitit 450 p.e.s.

AKTIVITET

Gjej një imazh skulpture nga periudha klasike, dhe vizato pozën duke përdorur siluetën e trupit të njeriut.

A E DINI SE

Fidiasi gjithashtu e realizoi skulpturën e Zeusit në Olimpia – një nga shtatë mrekullitë e botës antike.

Pikturimi mbi vazo

Vazot nuk ishin vetëm objekte të dobishme, por edhe një medium për përcjelljen e tregimeve dhe estetikës. Ato përdoreshin për ruajtje, për pije, në rituale fetare dhe si shpërblime.

Më të rëndësishmet janë teknika figurash të zeza dhe teknika figurash të kuqe. Në **teknikën e figurave të zeza**, figura pikturohej me ngjyrë të zezë mbi sipërfaqen e argjilës së çelët, ndërsa detajet gdhendeshin. Në **teknikën e figurave të kuqe**, figurat mbeteshin në ngjyrën natyrale të argjilës, ndërsa sfondi ngjyrosej i zi, duke mundësuar më shumë liri për paraqitjen e anatomisë dhe lëvizjes.

Ato kishin forma të ndryshme: amfora (për ruajtje), kratër (për përzierjen e verës me ujë), kiliks (kupë), hidria (për mbajtjen e ujit).

Temat e zbukurimeve ishin skena mitologjike, beteja, jeta e përditshme, muzika dhe sporti. Artistë të njohur ishin Ekzekiasi dhe Evfroni, të cilët shpesh i nënshkruanin veprat e tyre – gjë e rrallë për atë kohë. Vazot zakonisht kishin një renditje simetrike, breza dekorativë dhe një strukturë të qartë rrëfimtare.

Procesi i pjekjes ishte shumë i ndërlikuar – kërkonte tre faza (oksidim, reduktim dhe oksidim i përsëritur) për të arritur ngjyrën karakteristike të zezë të figurave



Vazo me figura të zeza, Athinë, shek. VI p.e.s.



Vazo me figura të kuqe, Athinë, shek. V p.e.s.

PYETJE

1. Cilat janë karakteristikat e tre rrymave arkitektonike?
2. Në çfarë dallohen skulpturat arkaike, klasike dhe helenistike?
3. Çfarë paraqet kontraposti dhe pse është i rëndësishëm?
4. Çfarë roli kishin vazot në jetën e përditshme dhe fetare të grekëve?
5. Çfarë roli kishin vazot në jetën e përditshme dhe fetare të grekëve?
6. Cilat ishin objektet publike më të rëndësishme në qytetin grek dhe çfarë funksioni kishin ato?
7. Pse arti grek konsiderohet si baza e kulturës perëndimore?

AKTIVITET

Vizato një vazo me një skenë mitologjike ose sportive, duke përdorur njërën nga dy teknikat: figura të zeza ose figura të kuqe.

ARTI ETRUSK

Në mes të botëve antike

Arti etrusk përfaqëson një nga kulturat më impresive, por edhe më pak të njohura të botës antike. Ai është zhvilluar në Italinë qendrore, në rajonin e njohur si Etruria (sot Toskana), afërsisht nga shekulli IX deri në shekullin I p.e.s. Kjo civilizim ekzistonte përpara ngritjes së Romës dhe ka ndikuar thellësisht në artin, arkitekturën dhe fenë romake. Etruskët ishin një popull me shpirt tregtar të zhvilluar, të lidhur me kulturat lindore dhe greke, prej nga merrnin frymëzim, por gjithashtu krijuan një stil artistik unik.

TERMA KYÇ:

Freskë, terrakotë, tumulus (varr kodrinor), bronz

Karakteristika të përgjithshme

Arti etrusk është i lidhur ngushtë me besimin në jetën pasvdekjes. Varret dhe dekorimet e tyre janë burimi më i rëndësishëm i informacionit për kulturën etruske. Ata krijuan një botë të pasur vizuale, që paraqet aktivitete të përditshme, mitologji dhe besime. Në ndryshim nga arti klasik grek, tek etruskët mbizotërojnë:dinamika,ngrohtësia,ekspresioni emocional, dhe ndjesia e lëvizjes.

A E DINI SE

Arti etrusk shpesh paraqiste burra dhe gra së bashku në skena të qeta dhe intime, gjë që ishte e pazakontë për atë kohë. Këto skena shpesh shfaqen në sarkofagë dhe freska, ku burra dhe gra shtrihen krah për krah mbi sofate banketi, duke shprehur butësi dhe barazi, çka pasqyron kulturën etruske

Piktura

Shumica e pikturave etruske janë ruajtur në varreza, veçanërisht nga shekulli VII deri në shekullin IV p.e.s. Pikturat realizoheshin drejtpërdrejt mbi muret prej guri ose suva dhe kryesisht përdoreshin pigmente natyrore. Stili i pikturimit karakterizohet nga ngjyra të gjalla, vija kontrastuese dhe një qasje narrative.

Temat janë të larmishme: skena nga gostitë, vallëzimi, garat sportive, ngjarje mitologjike, të shoqëruara me figura në lëvizje. Trupat paraqiten me kontur dhe pa realizëm të saktë, por me shumë shprehje dhe energji. Shpesh vërehet ndikim nga piktura mbi vazo greke, por e interpretuar në stilin lokal etrusk.



Freskë nga Varri i Leopardëve, Tarquinia

AKTIVITET

Gjej një imazh nga freska e Varrit të Leopardëve. Përshkruaj kompozicionin, ngjyrat dhe lëvizjen e figurës. Çfarë ndjenje përcjell skena?

Skulptura

Etruskët ishin skulptorë të shkëlqyer, veçanërisht në terrakotë. Në vend të mermerit ose bronzit, si tek grekët, ata shpesh përdornin argjilë të pjekur. Skulpturat vendoseshin:mbi sarkofagë, në tempuj,ose si pjesë e monumenteve mortore. Sidomos të njohura janë sarkofagët me çifte të shtrirë, ku burri dhe gruaja paraqiten duke qëndruar shtrirë në një banket.

Shembujt më të njohur:Sarkofagu nga Cerveteri,dhe skulptura prej bronzi e Apolonit nga Veji. Tek këto vepra, trupi nuk është anatomicisht i saktë, por figurat janë plot jetë, energji dhe shprehje lëvizjeje. Fytyrat janë të idealizuara, me një buzëqeshje të butë, të ngjashme me skulpturën arkaike greke.

Një nga skulpturat më mbresëlënëse prej bronzi të periudhës etruske është: Ujku i Kapitolit, që ushqen binjakët Romul dhe Rem. Ajo përfaqëson një lidhje simbolike midis kulturës etruske dhe asaj romake. Skulptura është plot ekspresivitet dhe energji, me forma të modeluara me kujdes dhe vija të mprehta. Edhe pse fëmijët janë shtuar më vonë, ujku konsiderohet një vepër autentike etruske.



Sarkofagu i bashkëshortëve, Cerveteri, rreth vitit 520 p.e.s.

A E DINI SE

Skulpturat etruske shpesh ishin të lyer me ngjyra, për t'u bërë më tërheqëse dhe më afër realitetit jetësor.



Ujku i Kapitolit me Romulin dhe Remin, Kapitoli, Romë, shek. V p.e.s.

AKTIVITET

Realizo një figurinë të vogël prej argjile, të frymëzuar nga sarkofagët etruskë. Mendo si do të duket personazhi dhe në çfarë pozicioni do të paraqitet.

Arkitektura

Arkitektura etruske është bazë e arkitekturës romake. Edhe pse pak objekte janë ruajtur, arkeologët kanë rindërtuar pamjen e tempujve dhe shtëpive të tyre. Ata përdornin:gur për themelet, terrakotë për zbukurimin e fasadave. Tipare të tempujve etruskë: kishin podium të lartë, shkallë të gjera, frontone të zbukuruara me skulptura. Ndryshe nga grekët, etruskët kishin një hyrje të vetme në tempull dhe simetri gjatësore (jo rrethore si grekët). Ndërtimet ishin funksionale, të përshtatura me terrenin. Çatitë mbështeteshin në trarë druri, të mbuluar me pllaka qeramike. Përveç tempujve, Etruskët ndërtuan edhe varre, të ngjashme me dhoma nëntokësore me kube dhe korridore – „shtëpi të vërteta për të vdekurit".

A E DINI SE

Qytetet etruske kishin rrugë të organizuara, porta qyteti dhe sheshe publike, para themelimit të Romës.

AKTIVITET

Vizato një plan të tempullit etrusk sipas rindërtimeve: hyrja, shkallët, hapësira e brendshme, frontoni



Varri tuman (Tumulus) me kupolë, Cerveteri, shek. VII-VI p.e.s

Art i aplikuar dhe sende të përditshme

Etruskët krijuan shumë objekte për përdorim të përditshëm:enë, stoli, armë, pasqyra, kuti zbukuruese. Materialet më të përdorura ishin: bronzi dhe qeramika. Enët ishin të dekoruara me: motive gjeometrike, skena mitologjike, rituale fetare. Çdo objekt bëhej me kujdes të madh, edhe kur kishte qëllim praktik.



Vazë qeramike e stilit bucchero, Muzeu Metropolitan – New York, shek. VII p.e.s.

PYETJE

1. Ku është zhvilluar qytetërimi etrusk dhe në cilin periudhë?
2. Cilat janë temat karakteristike në pikturën etruske?
3. Çfarë materialesh përdornin më shpesh Etruskët për skulpturë?
4. Si dallohen tempujt etruskë nga ata grekë?
5. Çfarë përfaqëson tumuli në arkitekturën varrore etruske?

AKTIVITET

Hulumto se si dukej stolia etruske. Dizajno një vath apo brosh të frymëzuar nga ai stil.

ARTI ROMAK

Arti si pasqyrë e fuqisë dhe jetës së përditshme

Arti romak u zhvillua nga shekulli VI para erës sonë deri në rënien e Perandorisë Romake Perëndimore, në shekullin V të erës sonë. Ai është pjesë e zhvillimit të gjerë kulturor të Romës së Lashtë, e cila nuk e pushtoi botën vetëm me ushtrinë, por edhe me kulturën, organizimin dhe estetikën e saj. Romakët ishin praktikë, por edhe ambiciozë. Ata e çmonin shumë artin grek, shpesh e kopjonin, por krijuan edhe zgjidhje origjinale, veçanërisht në arkitekturë dhe skulpturë. Arti romak kishte disa funksione: për lavdërimin e shtetit, përzbukurimin privat,por edhe për përdorim të përditshëm.

TERMA KYÇ:

Mozaik,bust,teatër romak,akuadukt

Piktura

Piktura romake ishte e larmishme dhe shpesh realizohej drejtpërdrejt në muret e shtëpive. Pjesa më e madhe e pikturave të ruajtura vjen nga qytetet Pompeji dhe Herkulaneumi, të cilat u shkatërruan nga shpërthimi i vullkanit Vezuvi në vitin 79 të erës sonë. Hiri vullkanik i ruajti pikturat murale pothuajse të paprekura.

Teknika të përdorura në pikturën romake:

- ***Fresko*** – pikturë mbi suva të freskët
- ***Enkaustikë*** – pikturë me ngjyrë të përzier me dyll
- ***Temperë*** – përdorim i ngjyrave të tretura në ujë dhe substanca organike lidhëse

Romakët zhvilluan shfaqjen e hapësirës në pikturë. Me ndihmën e dritës, hijes dhe vijave, ata krijonin iluzionin e thellësisë – një teknikë rrallë e përdorur te grekët. Katër stile të ndryshme të pikturës murale romake u zhvilluan me kalimin e kohës, që tregojnë përzhvillim teknik dhe estetik.

AKTIVITET

Krahaso një skulpturë romake me një skulpturë greke. Shkruaj me disa fjali dallimet midis tyre në stil dhe shprehje.



Pikturë nga Vila e Misterëve, Pompeji, shek. I p.e.s.

Në stilin e dytë dhe të tretë të pikturës murale, shpesh paraqiten **fasada të inskenuara**: muret pikturoheshin në mënyrë që të dukeshin si të kishin dyer, dritare ose pamje nga peizazhi. Kjo krijonte një mashtrim vizual dhe iluzion të hapësirës arkitekturore.

Përveç pikturës murale, romakët zhvilluan edhe artin dekorativ të jashtëzakonshëm. Veçanërisht të rëndësishëm janë **mozaikët** – kompozime të krijuara nga gurë të vegjël shumëngjyrësh, të quajtur **tesserae**.

Mozaiket zbukuronin dyshemetë dhe muret e vilave luksoze, termeve dhe ndërtesave publike. Ata paraqesnin skena mitologjike, beteja, kafshë, peshkatarë, apo edhe skena të jetës së përditshme, si p.sh. nga kuzhina. Realizoheshin me saktësi të madhe dhe zakonisht vendoseshin në hapësirat pritëse, për të shfaqur prestigjin e zotit të shtëpisë.

A E DINI SE

- Një nga mozaikët më të famshëm romakë është Mozaiku i Aleksandrit të Madh, nga Shtëpia e Faunit në Pompeji. Ai paraqet Betejën e Is-it, me Aleksandrin dhe mbretin persian Dari III, dhe shquhet për shprehshmëri të jashtëzakonshme dhe lëvizje dinamike. Ky mozaik konsiderohet si kryevepër e artit antik, ndonëse ka gjasa të jetë kopje romake e një pikture greke.
- Në Pompeji dhe Herkulaneum, janë zbuluar piktura që përdorin efektin trompe-l'œil ("mashtrim i syrit" në frëngjisht), me iluzione vizuale si dritare, elemente arkitekturore ose pamje natyrore.



Mozaiku me Aleksandrin e Madh, Muzeu Arkeologjik, Napoli, shekulli II p.e.s.



Figura e njerëzve të kapur nga shpërthimi, Pompeji, shekulli I e.s.

A E DINI SE

Në Pompeji janë ruajtur figura njerëzore të kapura nga shpërthimi vullkanik? Arkeologët zbuluan zbrazëtira në shtresat e hirit, të cilat i mbushën me gips – duke krijuar forma realiste të trupave, pozat, shprehjet dhe madje edhe veshjet e tyre në momentin e vdekjes.

AKTIVITET

Imagjino se je piktor romak, i ftuar të zbukurosh murin e brendshëm të një vile. Bëj një vizatim të një pjese të murit, duke përfshirë:kolona, perde,ose një dritare me pamje nga kopshti. Mundohu të krijosh iluzion të thellësisë hapësinore. Si detyrë shtesë, dizajno edhe një mozaik të vogël për dysheme, i cili do të vendosej në të njëjtën dhomë.

Skulptura

Skulptura romake ka lidhje të ngushtë me atë greke. Romakët ishin mahnitur nga skulpturat greke dhe krijuan kopje masive të tyre. Shumë nga informacionet që kemi sot për artin grek, vijnë pikërisht nga kopjet romake. Megjithatë, arti skulpturor romak nuk mbeti vetëm imitim – ai u zhvillua në drejtimin e vet.

Skulpturat romake dallohen për realizëm të theksuar, veçanërisht te bustet (pjesa e kokës dhe qafa). Ato paraqesin figura pa idealizim, me karakteristika të mprehta psikologjike dhe shprehje realiste të fytyrës, përfshirë rrudhat, mimikat dhe shenjat e pleqërisë. Bustet vendoseshin në shtëpi, ndërtesa publike dhe varre.



Bust i një romaku të moshuar, Muzeu i Kapitolit, Romë, shek. I p.e.s.

A E DINI SE

Familjet shpesh i ruanin bustet e paraardhësve të tyre dhe i merrnin me vete në festime publike, për të treguar përkatësinë ndaj një fisi të vjetër dhe me ndikim.

Përveç portreteve, u zhvillua edhe skulptura me kalorës – statuja të gjeneralëve dhe perandorëve mbi kuaj, që simbolizonin fuqi dhe lëvizje. Një nga më të famshmet është statuja prej bronzi e perandorit Mark Aureli.

Relievet luajtën gjithashtu një rol të rëndësishëm. Për shembull, shtylla e Trajanit përshkruan skena të fushatave ushtarake të perandorit Trajan, të cilat shtrihen në spirale rreth 38 metra lartësi, me 2,500 figura të punuara deri në detaje të imta. Përmes skulpturës, romakët shprehnin ngjarje historike, ideologji dhe pushtet.

AKTIVITET

Familjet romake shpesh ruanin bustet e paraardhësve të tyre dhe i merrnin në festa publike, për të treguar prejardhjen nga një familje e lashtë dhe e respektuar?



Relief nga shtylla e Trajanit, Romë, shek. II e.s.



Statuja e Mark Aurelit mbi kalë, Muzeu i Kapitolit, Romë (kopje), shek. II e.s.

Arkitektura

Arkitektura romake përfaqëson njërin nga arritjet më të mëdha të artit antik. Romakët përdorën forma tradicionale dhe frontone (timpane të ndërtesave),por sollën edhe zgjidhje të reja konstruktive. Një nga risitë më të rëndësishme ishte përdorimi i **betonit** – një material që u lejoi të ndërtonin më shpejt, më lirë dhe më qëndrueshëm.

Me beton dhe harqe, romakët ndërtuan struktura madhështore si:amfiteatro,akveduktë, banjo publike . Shembulli më i njohur është Koloseu – një arenë gjigante me disa nivele, korridore daljeje dhe vende për mbi 50.000 spektatorë.

AKTIVITET

Bëj një vizatim të një busti të një patrici romak imagjinar apo të një perandori. Mendo për karakterin dhe shprehjen që dëshiron të përçosh.



Amfiteatri Koloseum, Romë, shek. I e.s.

Një tjetër ndërtesë imponuese është Panteoni, një tempull kushtuar të gjithë perëndive. Ai ka një sallë rrethore me një kupolë që në majë ka një hapje të rrumbullakët (okulus) përmes së cilës hyn drita. Kupola, edhe pse e ndërtuar me beton, është kaq e përsosur në konstruksion sa që ka qëndruar pa asnjë mbështetje për më shumë se 2.000 vjet.

Drita që hyn përmes okulusit krijon një efekt dramatik dhe simbolizon lidhjen me qiellin. Panteoni është një shembull i gjenialitetit inxhinierik dhe harmonisë arkitekturore të artit romak.



Akvedukti Pont du Gard, Nimes, Francë, shek. I p.e.s.

Arkitektura e teatrit ishte gjithashtu veçanërisht e rëndësishme. Teatrot romake ndryshonin nga ato greke në disa aspekte:Teatrot greke zakonisht ndërtoheshin në pjerrësi natyrore dhe kishin strukturë të hapur. Romakët, duke përdorur betonin, mund të ndërtonin **teatro tërësisht të mbyllura**, me një scena të bashkangjitur (scaenae frons) dhe një hapësirë për publikun (cavea) që e rrethonte hapësirën në formë gjysmë-rrethi. Teatrot ndodheshin në qendrën e qytetit, si simbol i jetës kulturore.

A E DINI SE

Romakët ndërtuan më shumë se 400.000 kilometra rrugë në të gjithë Perandorinë? Disa prej tyre përdoren edhe sot!

AKTIVITET

Imagjino që je arkitekt në kohën romake. Dizajno pamjen e një teatri romak ose forumi. Mendo për: formën,shpërndarjen e hapësirave,statujat,shatërvanët,dhe simetrinë.



Brendësia e Panteonit, Romë, shek. II e.s.

PYETJE

1. Në çfarë ndryshon skulptura romake nga ajo greke?
2. Cilat teknika janë përdorur në pikturën romake?
3. Çfarë paraqet efekti i "trompe l'œil"?
4. Shpjego pse betoni ishte i rëndësishëm për arkitekturën romake.
5. Si ndryshon teatri romak nga ai grek?
6. Çfarë lloj ndërtesash publike ndërtuan romakët dhe cila ishte funksioni i tyre?
7. Çfarë paraqesin mozaikët dhe ku ishin të vendosur?

ARTI PALEOKRISTIAN

Arti i besimit dhe simbolit

Arti paleokristian zhvillohet gjatë periudhës nga shekulli III deri në shekullin VI, në kohën kur krishterimi po përhapej nëpër Perandorinë Romake – fillimisht në mënyrë të fshehtë, e më pas haptazi, pas njohjes zyrtare të fesë nga perandori Konstantini në vitin 313. Ky art është thellësisht i lidhur me botëkuptimin e ri fetar dhe nuk synon lavdërimin e trupit apo natyrës, si në Greqinë apo Romën antike, por paraqitjen e shpirtërores, përjetësisë dhe hyjnores.

Në shekujt e parë, të krishterët nuk kishin tempujt e tyre. Ata mblidheshin në shtëpi private, varreza ose hapësira nëntokësore. Pikërisht në këto vende të fshehta lind arti i parë paleokristian, me simbolika dhe paraqitje të thjeshta, që ishin të kuptueshme për besimtarët, por të fshehura për të jashtmit.

TERMA KYÇ:

katakombe, bazilikë, mozaik, sarkofag, ikonografi

Katakombet dhe arti nëntokësor

Gjatë periudhës kur krishterimi ishte fe e ndaluar, të krishterët mblidheshin në **katakombe** – rrjete nëntokësore varrezash dhe galeri, kryesisht rreth Romës. Aty zhvilloheshin lutjet, ritet dhe varrimet. Muret e katakombeve zbukuroheshin me freske të thjeshta, si: Krishti si bariu i mirë,mjellma,peshku,ankori,hardhia e rrushit,apo skena nga Dhiata e Vjetër dhe e Re.

Këto simbole kishin kuptime të fshehta: Për shembull, peshku (në greqisht ichtys) përfaqësonte shkronjat e para të shprehjes „Jezus Krisht, Biri i Zotit, Shpëtimtar".

A E DINI SE

Në katakombet e Shën Kalistit në Romë ka kilometra korridore nëntokësore me varre, freske dhe simbole, disa prej të cilave janë më shumë se 1700 vjet të vjetra.




Katakombet e Shën Kalistit, Romë, shek. III

Arkitektura

Kishat e para të krishtera u shfaqën pas Ediktit të Milanos, kur të krishterëve iu lejua të shprehnin hapur besimin e tyre. Për këtë qëllim, në vend që të vazhdonin ndërtimin e tempujve romakë, të krishterët zgjodhën një formë tjetër – **bazilikën**, një ndërtesë që më parë përdorej për gjykime dhe mbledhje publike.

Bazilika ishte ideale për ritet fetare: ishte një ndërtesë e gjatë drejtkëndëshe me hapësirë qendrore (naos) dhe korridore anësore (nave), të ndara me rreshta shtyllash dhe të ndërprera nga transepti, duke krijuar kështu formën e një kryqi latin. Në fund ndodhej një apsidë gjysmërruzhore, ku zhvillohej rituali liturgjik. Kulmi ishte prej druri dhe brendësia zbukurohej pasur me mozaikë dhe afreske.

Shembuj të njohur janë **Bazilika e Vjetër e Shën Pjetrit në Romë dhe Santa Sabina në kodrën Aventin**. Jashtë ishin modeste, por brenda përfaqësonin parajsën – me dritë, ar, figura engjëjsh dhe skena biblike.



Plani i bazilikës, kishë tipike kristiane, shek. IV–VI.

AKTIVITET

Vizato planin bazë (pamje nga lart) të një bazilike. Shëno pjesët:naos (hapsira qendrore),nave (hapsirat anësore),apsidën,hyrjen. Përpiqu ta përfytyrosh simetrinë dhe lëvizjen e besimtarëve nëpër hapësirë.



Bazilika Santa Sabina, Romë, shekulli V.

Piktura dhe mozaiku

Piktura në artin e krishterë të hershëm nuk e paraqet trupin njerëzor me realizëm të theksuar, si në periudhën antike. Në vend të kësaj, figura **është e stilizuar**, simbolike, shpesh pa thellësi apo perspektivë. Personazhet kanë sy të mëdhenj dhe një shikim të qelqtë – ato nuk janë qenie fizike, por shpirtërore.

Skenat nga Dhiata e Re, si Krishti dhe apostujt, bekimet, mrekullitë, apo pamje nga Parajsa, shfaqen shpesh në muret e bazilikave. Rol të rëndësishëm kanë **mozaikët**, sidomos në apsidë. Ato përfaqësojnë lavdinë qiellore: sfondet janë me ngjyrë ari, figurat janë të veshura me të bardha e blu, dhe paraqiten simbolet e krishtera si kryqi, qengji, hardhia, ose Krishti në fron.

A E DINI SE

Një nga shembujt më të njohur të mozaikut gjendet në bazilikën Santa Pudenciana në Romë, ku Krishti paraqitet si mësues midis apostujve, në një formë të ngjashme me perandorët romakë.



Mozaik nga Bazilika Santa Pudenciana, Romë, shekulli IV

AKTIVITET

Vizato një mozaik për apsidën e një bazilike. Zgjidh një simbol: qengji,kryqi,hardhia,ose Krishti në fron. Përdor forma gjeometrike dhe një ngjyrë të fortë për sfondin, për të krijuar efekt të lavdishëm shpirtëror.

A E DINI SE

Arti i krishterë i hershëm fillimisht është zhvilluar në fshehtësi, në katakombe nën tokë, ku besimtarët mblidheshin për lutje dhe varrime.

Skulptura dhe elementet dekorative

Skulptura në këtë periudhë është e rrallë dhe ka funksion dekorativ, jo monumental. Për shkak të frikës nga idhujtaria, të krishterët e hershëm ishin të përmbajtur ndaj figurave tridimensionale. Megjithatë, hasim relieve dekorative në **sarkofagë** – arkë guri për varrime – ku paraqiten skena biblike: Jona dhe balena, pagëzimi, ringjallja e Llazarit, etj.

Sarkofagët paleokristianë janë vepra arti me vlerë të madhe, të punuara me saktësi të lartë dhe me fuqi të fortë tregimtare.



Sarkofagu i Junij Bas, Muzeu i Vatikanit, shek. IV

Simbolika dhe mesazhi

Arti i krishterë është i pasur me **simbole**: peshku, spiranca, qengji, hardhia, palma, feniksi. Secili prej tyre bart një mesazh – për jetën e përjetshme, sakrificën, shpresën apo shpëtimin. Arti nuk shërben vetëm për zbukurim, por edhe për të dhënë mësim. Në një kohë kur shumica nuk dinin të lexonin, muret e kishave ishin si libra vizualë.



Simboli i peshkut (Ichthys), simbol paleokristian, shek. III–IV



Krishti pa mjekër, mozaik ose afresk, shek. IV–V

PYETJE

1. Çfarë përfaqëson bazilika dhe si ndryshon ajo nga tempulli romak?
2. Pse ishin të rëndësishme katakombet për të krishterët e hershëm?
3. Shpjego pse mozaikët janë thelbësorë për artin e krishterë?
4. Cilat janë simbolet më të përdorura në artin paleokristian?
5. Si ndryshon paraqitja e njeriut në këtë art nga tradita antike?
6. Çfarë është sarkofagu dhe cila është roli i tij në skulpturë?

ARTI BIZANTIN

Arti i shpirtërimit dhe dritës

Arti bizantin zhvillohet në Perandorinë Lindore Romake, të njohur si Bizant, gjatë periudhës nga shekulli IV deri në shekullin XV. Qendra e kësaj kulture është qyteti i Konstantinopojës (sot Stambolli), i themeluar nga Perandori Konstandini. Arti bizantin ruan trashëgiminë antike, por e transformon tërësisht në një shprehje kristiane shpirtërore, ku rolin kryesor e luajnë simboli, drita dhe përjetësia.

Në ndryshim nga arti romak dhe grek, që përqendrohet në trupin dhe jetën tokësore, arti bizantin synon të paraqesë mbretërinë hyjnore përmes ndriçimit, sipërfaqeve të arta, simetrisë dhe rregullave të rrepta të përfaqësimit.

TERMA KYÇ:


tessera, ikonë, rreze shenjtërimi (oreol), freskë, ikonostaz (dodekaorton)

Arkitektura

Arkitektura bizantine dallon nga ajo e mëparshme sepse e zëvendëson planin gjatësor të bazilikës me një plan qendror, zakonisht në formë kryqi me kupolë. Karakteristika më mbresëlënëse është kupola e madhe që ngrihet mbi hapësirën qendrore dhe jep përshtypjen sikur "qëndron pezull në ajër". Ajo mbështetet mbi pendativa – elemente të lakuara trekëndore që lidhin bazën katrore me kupolën rrethore. Shembulli më i famshëm është kisha Shën Sofia, e cila i kushtohet urtësisë hyjnore dhe ndodhet në Konstantinopojë, ndërtuar në shekullin VI me urdhër të perandorit Justinian. Kupola, e lartë 55 metra, në formë gjysmë sfere, e mbështetur mbi një seri kupolash më të vogla përreth, ishte një risi që mahniti gjithë botën dhe ndikoi thellësisht në arkitekturën si të Lindjes ashtu edhe të Perëndimit. Kishat janë të thjeshta nga jashtë, por brendia e tyre shkëlqen nga mozaikët, freskat, mermeri dhe ari, që simbolizojnë dritën qiellore të parajsës.



Kisha Shën Sofia, Konstantinopojë, shek. VI



Plan i kishës bizantine me kupolë, shek. VI-X

A E DINI SE

Kupola e Shën Sofisë i mahniti aq shumë vizitorët, sa perandori Justiniani thirri: "E tejkalova edhe Solomonin!"

MOZAIKU

Mozaiku është teknika kryesore e zbukurimit të kishave bizantine. Ai realizohej me tessera – pllaka të vogla prej qelqi të ngjyrosur, guri ose ari, të vendosura mbi suva të freskët. Mozaiku nuk ishte vetëm dekorim, por një teologji vizuale.

Temat më të shpeshta ishin Krishti Pantokrator, Hyjlindësja, engjëjt, shenjtorët dhe skena nga Dhiata e Re. Sfondet ishin të arta, ndërsa figurat – simetrike, me shprehje serioze dhe të paraqitura në pozicion frontal.

A E DINI SE

Në kishën San Vitale në Ravena, ndodhen mozaikët e famshëm të: Perandorit Justinian dhe Perandoreshës Teodora me oborrtarët e tyre

AKTIVITET

Krijo një mozaik simbolik. Përdor pllaka të vogla prej letre me ngjyra dhe krijo një mini-mozaik me:qengj,kryq,hardhi rrushi,ose një ungjill të hapur.



Krishti Pantokrator – mozaik në Aja Sofi (Shën Sofia)



Mozaiku i Perandorit Justinian, San Vitale, Ravena, shek. V



Tesserae për mozaik bizantin



Mozaiku i Perandoreshës Teodora, San Vitale, Ravena, shek. VI

Ikona

Ikona është forma më e shenjtë e pikturës bizantine. Ajo nuk është portret, por një përfaqësim shpirtëror, e krijuar sipas rregullave të rrepta kanonike. Ikonat përdoren për lutje, meditim dhe si ndërmjetësim midis njeriut dhe Zotit.

Procesi i krijimit fillon me një bazë druri, e mbuluar me „levkas" – një përzierje gëlqereje dhe ngjitësi. Figurat vizatohen në mënyrë simetrike. Sfondi realizohet me fletë ari. Çdo figurë e shenjtë ka një rreth të artë (oreol) rreth kokës, që tregon shenjtërinë dhe prejardhjen hyjnore.

A E DINI SE

- Ikona nuk është një portret, por imazh shpirtëror i krijuar sipas rregullave të përcaktuara fetare. Ajo shërben për lutje, vëzhgim dhe ndërmjetësim.
- Ikona më e vjetër e ruajtur e Krishtit daton nga shekulli VI dhe ndodhet në manastirin e Shën Katerinës në Sinai.



Ikonë e Krishtit, Shën Katarina, Sinai, shekulli VI



Ikonë e Hyjlindëses me Krishtin, shekulli XI

Ngjyrat aplikohen me tempera – bojë e përzier me të verdhën e vezës. Piktura fillon me tonalitet të errët, dhe ndriçohet gradualisht. Nuk ka hije – drita vjen nga brenda. Format janë simbolike: Sytë të mëdhenj, goja e vogël, hunda e zgjatur – të gjitha me kuptim shpirtëror.

AKTIVITET

Krijo ikonën tënde personale. Vizatoni një fytyrë të shenjtë me vija simetrike dhe një oreol rreth kokës. Mundohuni të mos përdorni hije dhe të përdorni ngjyra të ndritshme dhe të thjeshta.

Piktura murale (Fresku)

Freskat përdoreshin për zbukurimin e mureve të kishave bizantine. Ato pikturoheshin mbi suvaja të freskëta, me ngjyra natyrore. Hapësira shpërndahej sipas një rendi hierarkik.

Në kupolë paraqitej Krishti Pantokrator. Nën të, në pendentivë, vendoseshin katër ungjillorët. Në absidë – Hyjlindësja me Krishtin. Në muret e sipërme paraqiteshin skena nga jeta e Jezusit, ndërsa në pjesët e poshtme qëndronin shenjtorë në madhësi natyrore.

Freskat kishin edhe një funksion praktik – të përcillnin mësimin e krishterë përmes figurës, veçanërisht te popullsia analfabete. Kështu, kishat bëheshin një "Bibël e ilustruar".

A E DINI SE

Freskot në kishat bizantine shpesh vendosen në mënyrë që të "lexohen" nga lart poshtë – nga qiellorja drejt tokësores.

Dodekaorton – Cikli i Jetës së Krishtit

Në zonën qendrore shpesh vendoset cikli me 12 skena nga jeta e Krishtit, i njohur si Dodekaorton. Ai paraqitet në mënyrë kronologjike dhe ka kuptim liturgjik.

Skenat janë: Lajmërimi, Lindja, Parashitja në Tempull, Arratisja në Egjipt, Pagëzimi, Shndërrimi, Ringjallja e Lazrit, Hyrja në Jerusalem, Darka e Fundit, Kryqëzimi, Vendosja në varr dhe Ringjallja.

Këto skena zakonisht vendosen në muret anësore ose në harqet e kishës, si një rrëfim vizual për jetën e Shpëtimtarit.

Qëllimi i këtij cikli ishte që besimtarët vizualisht të kujtoheshin për momentet kyçe të jetës së Krishtit, ndërsa artistët me kujdes zgjidhnin kompozicionet dhe simbolet për secilën skenë.



Cikël freskash – Dodekaorton, kishë bizantine

AKTIVITET

Vizatoni një mur skematik të kishës dhe vendosni: krishtin në kupolë, hyjlindësen në apsidë, skena biblike nga jeta e krishtit, shenjtë sipas renditjes hierarkike

PYETJE

1. Çfarë është pendentivi dhe cili është roli i tij në arkitekturën bizantine?
2. Si krijohet mozaiku dhe cili është simbolizmi i tij?
3. Shpjegoni procesin e krijimit të ikonës.
4. Çfarë përfaqëson oreoli dhe si paraqitet?
5. Ku vendosen skenat e ndryshme në programin pikturor të kishave bizantine?
6. Çfarë përmban cikli Dodekaorton?
7. Si i ndihmonin freskot besimtarët analfabetë?

ARTI ROMANIK

Guri, simetria dhe heshtja shpirtërore

Arti romanesk u zhvillua në Evropën Perëndimore gjatë periudhës nga shekulli X deri në shekullin XII. Pas periudhës së paqëndrueshme që pasoi rënien e Perandorisë Romake Perëndimore, me krijimin e feudalizmit, shtetet e reja të krishtera filluan rindërtimin e kishave, manastireve dhe qendrave shpirtërore. Emri "romanesk" do të thotë "në stil romak", pasi arkitektura dhe elementet dekorative vazhdonin frymën e traditës romake, por me një karakter të ri të krishterë.

Ky art lidhej ngushtë me kishën, bashkësitë monastike, adhurimin, pelegrinazhin dhe besimin në shpëtim. Qëllimi i tij kryesor nuk ishte të paraqiste botën reale, por të shprehte praninë e Zotit përmes simetrisë së qartë, formave të fuqishme dhe një rreptësie vizuale.

TERMA KYÇ:

qemer (suvod), timpanon, freskë, ikonografi

Arkitektura

Arkitektura romaneske është arti i parë evropian pas periudhës antike që krijon një stil unik në gjithë territorin e Evropës Perëndimore. Forma kryesore është kisha bazilikale, por me elemente të reja që e bëjnë të dallueshme: mure masive, harqe cilindrike, harqe gjysmërrethore dhe kulla.

Hapësira është e ndarë shpesh me **transept** – një anije tërthore që formon kryqin latin. Mbi kryqëzimin e naosit dhe transeptit vendoset një kupolë ose kullë. Në fund gjendet **absida**, një niçë gjysmërrethore që përmban altarin.

Dritaret janë të vogla dhe të vendosura thellë, gjë që krijon hije të brendshme dhe një ndjenjë mistike. Kishat duken masive, të qëndrueshme dhe të mbyllura, me një **qetësi vertikale** që nxit meditimin dhe lutjen.



Kisha San Miniato al Monte, Firence, shek. XI



Brendësia me qemerë dhe shtylla masive, kishë romanike




Kisha Saint-Sernin (Sen Saturnin), Tuluzë, Francë

A E DINI SE

Shumë kisha romanike ndodhen përgjatë shtigjeve të pelegrinazhit mesjetar, veçanërisht përgjatë Rrugës së Shën Jakobit drejt Santiago de Compostela.

AKTIVITET

Vizato një plan të një kishe romanike në formën e kryqit latin. Shëno pjesët: naosi (korabi kryesor), transepti, apsida dhe kryqëzimi (qendra e ndërprerjes).



Plan i një kishe romanike në formë të kryqit latin

Skulptura

Skulptura romanike është ngushtë e lidhur me arkitekturën. Vendi i saj natyral janë: dyert, shtyllat, kapitelet (majat e shtyllave), arkadat, dhe portalet e kishave. Qëllimi i saj nuk është dekorimi, por **rrëfimi përmes simbolikës.**

Temat më të zakonshme janë: Gjykimi i Fundit, Krishti si Vsedrzhitel (Mbajtësi i gjithësisë), skena nga Dhiata e Re dhe e Vjetër, jeta e shenjtorëve, beteja mes së mirës dhe së keqes. Figurat janë: të zgjatura, frontale, me gjeste të ngurta. Ato nuk synojnë realizmin, por qartësinë shpirtërore. Sytë e mëdhenj, trupat të sheshta, duart tepër të mëdha – çdo element mbart një mësim simbolik.



Timpanoni me Gjykimin e Fundit, Kisha Sen Foa (Sainte-Foy), Conques, Francë, shek. XII



Kapitel prej guri me figura kafshësh, shek. XII



Kapitel prej guri me figura kafshësh, shek. XII



Figura prej guri të shenjtorëve në timpanonin e një portali kishe, shek. XII

A E DINI SE

Skulpturat në kapitele shpesh ishin si "tregime të vogla", të cilat murgeshat ose murgjit ua shpjegonin besimtarëve gjatë liturgjisë.

Piktura me freskë (picture murale me fresko)

Meqenëse kishat romaneske kishin mure të trasha dhe pak dritare, brendësia shpesh ishte e errët. Për ta ndriçuar shpirtërisht, muret pikturoheshin tërësisht me **freska**. Këto ishin piktura të mëdha me përmbajtje fetare, që kishin **rol edukativ dhe shpirtëror**.

Pikturimi bëhej mbi suvaja të freskëta, me pigmente natyrore. Figurave u jepej formë e stilizuar, me pozicione frontale, simetrike dhe ngjyra të forta. Nuk ekzistonte thellësi hapësinore, por gjithçka ishte e sheshtë dhe e nënshtruar rendit shpirtëror.

Skenat vendoseshin sipas një shpërndarjeje hierarkike:

- në kupolë ose harqet e larta – Krishti Pantokrator,
- në absidë – Hyjlindësja ose Trinia e Shenjtë,
- në zonën e sipërme të mureve – skena biblike,
- poshtë tyre – shenjtorë dhe martirë.

AKTIVITET

Imagjino që je një skulptor mesjetar. Vizato një timpanon me Krishtin, engjëj dhe besimtarë, ku do të paraqitet Gjykimi i përjetshëm.

A E DINI SE

Freskat romanike shpesh përmbanin tekste të shkruara pranë figurave, që besimtarët të kuptonin më mirë se çfarë po shikonin.

AKTIVITET

Përgatit një skemë të murit të kishës. Vizato brendësinë e një kishe dhe vendos: Krishtin, Shën Mërinë, skena biblike dhe shenjtë, sipas vendit të tyre të zakonshëm.

Simbolika dhe Mesazhi Shpirtëror

Në artin romanes, çdo element ka domethënie. Asgjë nuk paraqitet rastësisht. Duart që bekojnë, sytë që shikojnë përtej botës, kryqi që përsëritet në çdo kënd – të gjitha flasin. Madje edhe përbindëshat në kapitelet kanë një funksion – të kujtojnë njeriun për tundimet dhe nevojën për besim.

Artisti nuk është autor, por shërbëtor i së vërtetës. Ai nuk e paraqet botën ashtu siç e sheh, por ashtu siç e shpall kisha.

PYETJE

1. Nga cilat karakteristika dallohet arkitektura romanike?
2. Çfarë roli kishin skulpturat në portale dhe kapitele?
3. Si janë të shpërndara skenat në freskoslikari?
4. Çfarë është timpani dhe ku ndodhet?
5. Cila është funksioni i simbolikës në artin romanik?
6. Si e shprehën artistët shpirtëroren përmes formës dhe ngjyrës?



Freskë e Krishtit në lavdi, San Klemente de Taul, Spanjë, shekulli XII

A E DINI SE

Shumë skulptura dhe piktura romanike përmbajnë kafshë simbolike, si: Qengji (Krishti),Luani (Marku),Shqiponja (Gjoni),-Demi (Luka).

AKTIVITET

Zgjidh një simbol nga arti romanik (qengj, luan, kryq, hardhi vere) dhe vizatoje brenda një kornize, siç do të paraqitej në kapitel apo freskë.

ARTI GOTIK

Arti gotik u zhvillua në Evropë nga mesi i shekullit XII deri në fund të shekullit XV. Ai filloi në Francën veriore dhe u përhap në të gjithë Evropën Perëndimore. Ky stil doli nga arti romanes, por dallohet për **lartësinë më të madhe, dritën** dhe **dramatikën e theksuar**, të drejtuar nga qielli dhe rendi shpirtëror i lartësuar.

Arti gotik është i lidhur ngushtë me zhvillimin e qyteteve, katedraleve dhe mësimeve të reja kishtare. Format më të rëndësishme të tij janë arkitektura, vitrazhi, skulptura dhe miniatura. Ai bart shpirtin e besimit, por gjithashtu edhe të imagjinatës, dijes dhe emocioneve njerëzore.

TERMA KYÇ:

harqe fluturuese, kontrafor, garguj (garghouilles), vitrazh, miniaturë, rozeta

Arkitektura

Arkitektura gotike është më e njohura për katedralet e mëdha – të larta, me harqe të mprehta dhe dritare gjigante me vitrazh. Në vend që të theksohet horizontalja (masiviteti) si në stilin romanes, këtu theksohet vertikalja, gjithçka synon lart. Hapësira është e hapur, e ndritshme dhe e mbushur me simbolikë.

Risia kryesore teknike që e mundësoi këtë pamje ishte futja e **kupolës me brinjë (shtylla nervature)** dhe **harqeve mbajtëse fluturuese**. Këto harqe e shpërndajnë peshën e çatisë jashtë mureve, mbi shtylla të veçanta të quajtura kontraforë, duke liruar kështu muret dhe duke mundësuar vendosjen e dritareve të mëdha me vitrazh.



Katedralja në Chartres, Francë, shek. XII



Katedralja Notre-Dame, Paris, shek. XII-XIII

AKTIVITET

Përfytyro dhe vizato pamjen e përparme të një katedraleje. Përfshi: kulla të larta, një rozetë (dritare rrethore me vitrazh), tri portale hyrëse me harqe të mprehta

Katedralet kanë në plan formën e kryqit latin, me një anije qendrore të lartë, me 2 deri në 4 anije anësore, kor me organe, absidë me kapela dhe dy ose tri kulla. Mbi hyrjen kryesore zakonisht ndodhet **rozeta** – një dritare e madhe rrethore me vitrazh simetrik. Drita që depërton nëpër dritaret me ngjyra ka kuptim simbolik – **hirin e Zotit që i përfshin besimtarët.**

Skulptura

Skulptura në artin gotik është ngushtë e lidhur me arkitekturën. Ajo vendoset në fasada, portale, shtylla dhe harqe. Ndryshe nga ajo romaneske, skulptura gotike bëhet **më realiste dhe më shprehëse,** me më shumë emocione njerëzore.

Temat kryesore janë skena biblike, shenjtorët, Krishti, Hyjlindësja dhe alegoritë e virtyteve dhe vesëve. Skulpturat shpesh paraqiten në lëvizje, me shprehje në fytyrë, me drapperinë e rrobave dhe me një qëndrim natyral.

A E DINI SE


Katedralja në Chartres, Francë, ka ende vitrazhe nga shekulli XII që lëshojnë dritë me të njëjtin ndriçim si para 800 vjetësh.



Skulptura në fasadë katedraleje, shek. XIII



Garguja (gargol) në katedrale, shek. XIII-XIV



Hark fluturues dhe kontraforë, arkitekturë gotike

Skulpturat kanë qenë mjet për edukim – çdo besimtar, edhe ai që nuk dinte të lexonte, mund ta njihte skenën dhe ta kuptonte mesazhin. Ato nuk kanë qenë thjesht zbukurime, por një **Bibël vizuale** në hyrje të katedrales.

A E DINI SE

Skulptura e Hyjlindëses (Zonjës) në artin gotik bëhet më e butë, më e ndjeshme dhe mëna, në krahasim me ikonografinë e rreptë bizantine.

AKTIVITET

Vizato tre skulptura vertikale që do të vendoseshin mbi hyrjen e një katedraleje: Krishti, Hyjlindësja. Përpiqu të shprehësh lëvizje dhe harmoni në qëndrim dhe gjeste.



Hyjlindësja me Krishtin, skulpturë gotike, shek. XIV

Vitrazhi

Vitrazhi është elementi më mbresëlënës i kishës gotike. Ai realizohet duke bashkuar xhama me ngjyra në një kornizë plumbi. Çdo ngjyrë ka simbolikën e vet: bluja për qielloren, e kuqja përvuajtjen, e arta për hyjnoren.

Dritaret janë shumë të mëdha, ndonjëherë disa metra të larta, dhe paraqesin skena nga Dhiata e Re dhe e Vjetër, jeta e shenjtorëve, tregtia, zanatet ose historia e qytetit. Rozetat mbi hyrjen kryesore janë veçanërisht dekorative dhe simetrike.



Pamje e brendshme e një katedraleje me shtylla të harkuara dhe vitrazh, shek. XIII



Vitrazh me skena nga Dhiata e Re, shek. XIII

Drita që kalon përmes vitrazhit nuk është vetëm vizuale – ajo simbolizon **praninë e Zotit**. Besimtarët ndiheshin sikur ndodheshin në një hapësirë hyjnore, të mbushur me ngjyra dhe dritë.

A E DINI SE

Realizimi i një vitrazhi kërkon një ekip të tërë:piktorë,punues xhami,punues plumbi,dhe dizajnerë –pra një punëtori e vogël artistike.

AKTIVITET

Vizato një rreth apo një dritare të gjatë dhe krijo një skenë simbolike (p.sh.: Krijimi i botës, Lajmërimi i Zonjës, Krishti si gjykatës) duke përdorur ngjyra të forta dhe vija të qarta.



Rozetë me vitrazh nga Chartres, shek. XIII

Piktura dhe miniatura

Në epokën gotike, piktura zhvillohet më së shumti në **miniaturën** – ilustrime në libra të shkruar me dorë. Letërsia dhe teologjia marrin shprehje vizuale përmes: inicialeve të zbukuruara, margjinave të mbushura me lule, kafshë, dhe skena të ndryshme.

Përdoren ngjyra temperë, fletë floriri dhe argjendi, dhe temat janë biblike, por edhe nga jeta e përditshme. Figurat janë më elegante se më parë, me rroba që rrjedhin në draperi të palosura, dhe lëvizje më të lehta.

Përveç miniaturës, ekzistojnë edhe **freska** dhe **ikona** në hapësirat e altarit, që paralajmërojnë zhvillimin e ardhshëm të artit të Rilindjes.



Miniaturë nga dorëshkrim gotik, shek. XIV

A E DINI SE

Në disa miniatura paraqiten edhe njerëz të zakonshëm: bujq, zejtarë, madje edhe kafshë apo skena humoristike.

AKTIVITET

Zgjidh një shkronjë të madhe nga një tekst sipas dëshirës, dhe vizatoje të zbukuruar, si në faqet hyrëse të dorëshkrimeve mesjetare.

Simbolikë dhe shpirtërorësi

Arti gotik është i mbushur me simbolikë. Çdo element ka një kuptim të vetin: harqet e mprehta – dëshirë për t'u ngritur drejt qiellit, drita – praninë e Zotit, forma vertikale – ngjitje shpirtërore.

Në qytetet e mesjetës, katedralet nuk ishin vetëm vende të lutjes, por **qendra të jetës shoqërore**: për mbledhje, tregti, mësim dhe adhurim. Me pamjen dhe bukurinë e tyre, ato duhej të përfaqësonin **Jeruzalemin qiellor** në Tokë.

A E DINI SE

Ndërtimi i një katedraleje gotike zgjaste shpesh me shekuj – gjenerata të tëra mjeshtërish, gdhendësish guri dhe artistësh punonin pa pushim.

PYETJE

1. **Cilat janë dallimet mes arkitekturës gotike dhe asaj romanike?**
2. **Çfarë roli ka vitrazhi në artin gotik?**
3. **Çfarë përfaqësojnë skulpturat në fasadat e katedraleve?**
4. **Shpjego simbolikën e dritës në artin gotik.**
5. **Çfarë është një gargujllë dhe cili është funksioni i saj?**
6. **Çfarë përmbajnë miniaturat dhe ku janë përdorur?**
7. **Si manifestohet shpirtërorësia përmes elementeve arkitekturore?**

ARTI ISLAM

Art pa figuracion – dominim i gjeometrisë, dritës dhe fjalës

Arti islam zhvillohet që nga shekulli i 7-të e deri më sot, në rajonet ku dominon feja islame. Ai përfshin shumë kultura – nga Spanja, përmes Lindjes së Mesme, deri në Indi. Në vend që të fokusohet në figurën njerëzore, arti islam lavdëron: abstraksionin, gjeometrinë, format natyrore, dhe kaligrafinë – artin e të shkruarit.

Feja islame kufizon paraqitjen e qenieve të gjalla në artin fetar. Për këtë arsye, artistët zhvillojnë një gjuhë të re vizuale, të përbërë nga: ornamente simetrike, bimësi të stilizuar, dhe arti i fjalës – kaligrafia.

TERMA KYÇ:

minaret, mihrab, arabeskë, ornamentikë, kaligrafi, shkrimi kufik, glazurë, qilim

Arkitektura

Arkitektura islame njihet për formën karakteristike të xhamisë – vendi qendror për: lutje, bashkësi, dhe jetë shpirtërore. Një xhami zakonisht përmban: një sallë të madhe të lutjes, kupolë, minare, oborr me një burim për pastrim ritual (abdes).


Kupola simbolizon qiellin, ndërsa minareja – thirrjen shpirtërore për në lutje. Drejtimi nga Meka tregohet përmes mihrabit – një thellim në mur, që orienton besimtarët drejt lutjes.



Xhamia e madhe në Kordoba, Spanjë, shek. VIII–X



Kupolë dhe minare e xhamisë në Stamboll, shek. XVI



Mihrabi i xhamisë në Isfahan, Iran, shek. XIV

Drita është shumë e rëndësishme në arkitekturën islame – ajo vjen përmes hapjeve dekorative dhe dritareve me xhama shumëngjyrësh. Hapësira është e hapur, simetrike, dhe shpesh e mbuluar me pllaka qeramike dekorative ose ornamentikë gdhendur në gur.



Dizajn i oborrit me fontanë– Alhambra, Spanjë, shek. XIV

A E DINI SE

Xhamia e Madhe në Kordoba, Spanjë, ka mbi 800 shtylla dhe mbi 1000 harqe, dhe është shembull i përsosur i arkitekturës islame në Evropë.

AKTIVITET

Vizato një plan skematik të një xhamie me: kupolë, minare, oborr, dhe mihrab. Mendo si të vendoset simetria e hapësirës.

Ornamentikë dhe gjeometri

Për shkak të mospërdorimit të figurës njerëzore, artistët islamë zhvilluan sisteme dekorative tepër të ndërlikuara. Përdoren tre tipe kryesore të ornamenteve:

- Ornamente gjeometrike – forma me simetri të përsosur, rrjete të pafundme
- Ornamente bimore (arabeska) – gjethe, degë, lule të stilizuara, që përsëriten në mënyrë ritmik
- Kaligrafi – shkrim i zbukuruar me alfabet arab

Ornamentet nuk janë vetëm zbukurime, por kanë mesazh shpirtëror: pafundësi, përsosmëri, natyra hyjnore e Zotit. Çdo detaj është i përcaktuar me saktësi matematikore dhe proporcion i rreptë.



Ornament gjeometrik me glazurë të kaltër, shek. XIV–XV



Arabeska me forma bimore të stilizuara

A E DINI SE

Artistët islamë përdornin vetëm një kompas dhe një vizore për të krijuar forma gjeometrike shumë të ndërlikuara, pa ndihmën e teknologjisë moderne.

AKTIVITET

Me kompas dhe vizore, krijo: një yll me tetë cepa, ose një rrjetë gjeometrike që përsëritet. Përpiqu të ruash simetrinë dhe saktësinë.

Kaligrafia – arti i fjalës

Kaligrafia është forma më e vlerësuar e artit islam. Shkrimi i ajeteve nga Kurani, thënieve të urta ose emrave të Allahut dhe profetit Muhamed shndërrohet në zbukurim. Shpesh kaligrafia haset në xhami, pallate, pllaka, dyer, madje edhe në pëlhura.

Përdoren stile të ndryshme shkrimi: kufik (këndë, i rreptë) dhe nastalik (i rrjedhshëm, dekorativ). Kaligrafia shkruhet me një penel ose kallam të veçantë, duke iu kushtuar vëmendje vijës, ritmit dhe rrjedhshmërisë.



Kaligrafi me ngjyrë ari mbi sfond të errët

A E DINI SE

Në Islam, fjala e shkruar ka fuqi të veçantë, prandaj shumë artistë i kanë kushtuar tërë jetën kaligrafisë, në vend të pikturës.

Qeramika, metali dhe tekstili

Arti islamik është i pasur edhe në artet e aplikuara (praktike). Qeramika është zbukuruar me glazura shumëngjyrëshe dhe forma gjeometrike ndonjëherë edhe me kaligrafi. Ndër më të njohurat janë pllakat me glazurë të lules, të përdorura për veshje muresh.

Objektet prej metali – si enë, llamba, arkë – janë të gdhendura me kaligrafi dhe motive bimore. Tekstilet, sidomos qilimët, janë punuar me mjeshtëri të lartë, duke përdorur ornamente me kuptim shpirtëror.

AKTIVITET

Zgjidh një fjalë (p.sh. paqe, dritë, dije) dhe shkruaje me një stil dekorativ arab, ose me një font simetrik. Shto rreth saj një kornizë gjeometrike.



Qilim persian me dizajn simetrik, shek. XVI



Pllakë qeramike islame me xham qelqor dhe ornamente

A E DINI SE

Në disa rajone islamike, qilimat thuren me aq saktësi sa që përmbajnë deri në një milion nyje për metër katror.

Simbolika dhe shpirti

Në artin islamik, abstraksioni është rregull i shenjtë. Në vend të figurave njerëzore, përdoren skemave të pafundme, ritmeve dhe formave të përsëritura. Kjo artë është e orientuar drejt përjetimit të brendshëm, meditimit dhe rregullit hyjnor.

Qëllimi nuk është të shfaqet realiteti, por të udhëhiqet shpirti drejt përsiatjes së lartë. Përmes rregullave të sakta, simetrisë dhe harmonisë, artisti krijon hapësirë për paqe të brendshme dhe përqendrim.

AKTIVITET

Krijo një skemë për një pllakatë qeramike ose një pjesë qilimi. Përdor vetëm gjeometri, elemente bimore dhe simetri. Mos vizato figura njerëzore!

A E DINI SE

Shumë vepra të artit islamik janë anonime – jo sepse autorët nuk ishin të njohur, por sepse besonin se lavdia i përket vetëm Zotit.

PYETJE

1. Cilat janë pjesët kryesore të një xhamie?
2. Pse arti islamik shmang figurat njerëzore?
3. Shpjego çfarë është mihrabi dhe ku ndodhet.
4. Çfarë është arabeska dhe çfarë simbolike bart ajo?
5. Pse kaligrafia është më e rëndësishme se piktura në artin islamik?
6. Çfarë është xhami qelqor (glazura) dhe ku përdoret?
7. Çfarë mesazhesh përcjellin qilimat dhe qeramika në artin islamik?

ARTI PARAHISTORIK, ANTIK DHE MESJETAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Arti parahistorik

Parahistoria në hapësirën e Maqedonisë zhvillohet nga paleoliti deri në epokën e bronzit dhe hekurit. Arti paleolitik është pak i pranishëm, por janë zbuluar vegla guri dhe dëshmi për jetën e gjuetarëve dhe mbledhësve. Në neolit, duke filluar nga rreth vitit 6000 p.e.s., arti bëhet më i larmishëm dhe më i shprehur.

Vendet më të rëndësishme neolitike janë: Tumba Maçari, Govrlevo, Tumba Bara, Vrbjanska Çuka, Cocev Kamen afër Kratovës dhe Gradishte në Koçan. Në këto lokalitete janë zbuluar qeramika, idhuj antropomorfikë dhe zoomorfikë, objekte kulti dhe mbetje banesash.

Idhujt neolitikë meritojnë vëmendje të veçantë – janë skulptura të vogla prej balte, me forma të stilizuara të trupit femëror dhe me theksim të vijave të harkuara, simbol i pjellorisë dhe mbrojtjes së vatrës. Ata ishin pjesë e jetës shpirtërore të përditshme dhe përdoroheshin në rituale të lidhura me korrjen, pasardhësit ose si amuleta.

Në Govrlevo janë zbuluar ekzemplarë unikë me poza dhe detaje të pazakonta, ndërsa në Cocev Kamen gropëzime në shkëmb dëshmojnë për rituale të hapura të lidhura me ciklet diellore.

Veçanërisht e rëndësishme është skulptura e quajtur "Nëna e Madhe" – një paraqitje e perëndeshës me forma femërore të theksuara, e cila simbolizon pjellorinë, amësinë dhe fuqinë mbrojtëse. Kjo figurë lidhet me kultet që kremtonin jetën, tokën dhe rigjenerimin e natyrës, dhe konsiderohet si një nga skulpturat parahistorike më të çmuara të zbuluara në territorin tonë, lidhur me rituale, pjellori, mbrojtje dhe besime në fuqinë e natyrës.

TERMA KYÇ:

Idhull neolitik, tessera, Zograf



Figurë neolitike nga Tumba Maçari, mijëvjeçari i 6-të p.e.s

AKTIVITET

Përgatit një krijim artistik të frymëzuar nga një idhull neolitik ose nga një objekt qeramike i ndonjërit prej lokaliteteve

A E DINI SE

Vendbanimi më i vjetër i njohur në tokën e Maqedonisë është Vrbjanska Çuka, i datuar rreth vitit 6000 p.e.s.



Figurë neolitike nga Tumba Maxhari, mijëvjeçari i 6-të p.e.s.

Arti antik

Në antikitet, territorin e Maqedonisë së sotme e banonin Paionët, ndërsa më vonë ishte pjesë e Maqedonisë antike dhe e Perandorisë Romake. Qytete të rëndësishme nga ajo periudhë janë Stobi, Heraklea Lincestis, Bargala dhe Skupi. Ato ishin qendra me traditë të zhvilluar urbane, kulturore dhe artistike.

Në **Stobi** dhe **Heraklea** janë zbuluar bazilika monumentale, teatro, terme dhe mozaikë të jashtëzakonshëm në dysheme. Më i njohuri është **mozaiku me palloin dhe pemën e jetës** në bazilikën e hershme të krishterë në Stobi – simbol i përjetësisë dhe pavdekësisë, i realizuar me tesserae të imta me ngjyra të ndryshme. Në Heraklea mbizotërojnë motivet gjeometrike dhe florale.



Teatër në Herakleja Linkestis, shek. II



Stelë varri me mbishkrim nga Skupi, periudha romake

Arkitektura romake në këto hapësira karakterizohet me përdorimin e harqeve, kupolave dhe qemerëve, ndërtimin me gur dhe tulla, si dhe me përfshirjen e elementeve dekorative si mozaiku dhe fresku. Hapësira urbane ishte e rregulluar me forum, terme dhe teatër.

Skulptura antike në territorin e Maqedonisë së sotme paraqitet në disa forma: monumente varrimi, reliefe, zbukurime arkitektonike dhe statuja nga hapësirat publike ose fetare. Shumica janë realizuar në mermer dhe pasqyrojnë stilin helenistiko-romak me anatomi realiste, simetri dhe qetësi në shprehje. Këto skulptura nuk ishin vetëm zbukurim, por kishin edhe funksion simbolik – si shenjë statusi, kujtim për të vdekurit ose nderim për hyjnitë.


Një nga shembujt më përfaqësues është Menada e Tetovës – një skulpturë prej mermeri nga shekulli VI p.e.s., që paraqet një grua në lëvizje, e veshur me rroba të punuara hollë dhe me një qëndrim dinamik. Kyvepër është një shembull i jashtëzakonshëm i ndikimit të artit klasik grek mbi prodhimin lokal.

Përveç kësaj, në Skupi dhe Heraklea janë zbuluar fragmente të shumta skulpturash të perandorëve, hyjnive dhe figurave mitologjike. Ato vendoseshin në hapësira publike ose në faltore, si shenjë besnikërie ndaj Perandorisë Romake dhe respekt ndaj traditës.

Në skulpturën funerare më së shpeshti gjenden stele me portrete të të ndjerëve dhe skena simbolike, të shoqëruara me mbishkrime në latinisht ose greqisht. Këto na ofrojnë të dhëna të vlefshme për emrat, profesionet dhe pamjen e njerëzve që kanë jetuar në këto hapësira.



Mozaik me pallua nga Stobi, shekulli IV



Plani i një bazilike paleokristiane nga Bargala

AKTIVITET

Krijo një vepër artistike me motiv nga mozaikët antikë të Stobit ose Herakleas.

A E DINI SE

- Në Stobi bashkëjetojnë elementë nga arti helenistik, romak dhe paleokristian në një të vetmin kontekst qytetar.
- Menada e Tetovës, një skulpturë mermeri nga shekulli VI p.e.s., paraqet një figurë gruaje në lëvizje dhe është një nga zbulimet më të vlefshme të artit antik në vendin tonë.

Arti Mesjetar në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Mesjeta fillon me përhapjen e krishterimit dhe vazhdon me ndikimin bizantin dhe sllav. Arti i kësaj periudhe pasqyrohet përmes freskove, ikonave, arkitekturës së kishave dhe pikturimit të dorëshkrimeve.

Bazilikat e hershme të krishtera në Stobi, Ohër dhe Bargala përmbajnë mozaikë me motive si peshku, hardhia dhe kryqi. Arkitektura përdor plan drejtkëndor me absidë – përfundim gjysmërrethor ku vendosej altari.

Në mesjetën e pjekur, arti zhvillohet në kuadër të Kryepeshkopatës së Ohrit. Karakteristike janë freskot me skena biblike, cikle festash dhe figura shenjtorësh. Monumentet më të rëndësishme janë: Shën Sofia dhe Shën Klimenti në Ohër, Shën Gjergji në Staro Nagoriçane, Shën Panteleimoni në Nerezi, si dhe manastiret e Lesnovës dhe Zrze.



Ikonë e Hyjlindëses nga shkolla e Ohrit, shekulli XIV



Freskë nga Shën Gjergji, Staro Nagoriçane, shekulli XIV

Freskot vendosin Krishtin në kupolë (Pantokratorin), Hyjlindësen në absidë dhe shenjtorët përgjatë mureve. Përdorimi i ngjyrave të buta, figurave të zgjatura dhe gjesteve simbolike pasqyron thellësinë shpirtërore.

Teknika e pikturimit me fresko nënkupton aplikimin e ngjyrës mbi suvaja të freskët. Ikonat pikturohen mbi dërrasa druri me temperë veze dhe sfond të artë. Arkitektura varion nga kishat me kupolë kryqi në Ohër deri te kishat njëanijëshe dhe treshe në pjesën lindore.

AKTIVITET

Krijo një model mozaiku me motiv të krishterë duke përdorur forma gjeometrike dhe simbole të frymëzuara nga Stobi ose Ohri.

A E DINI SE

Freskot në kishën Shën Sofia në Ohër datojnë që nga shekulli XI dhe janë ndër shembujt më të rëndësishëm të pikturës murale paleobizantine në Ballkan.

Piktura mesjetare, veçanërisht afreskat dhe ikonografia, ishte vepër e artistëve të quajtur zografë. Zografët ndiqnin kanone të rrepta për kompozimin, simbolikën dhe ngjyrën, por në të njëjtën kohë sillnin stilin e tyre individual përmes fytyrave, gjesteve dhe koloritit. Ata shpesh udhëtonin dhe punonin me porosi në manastire dhe kisha, duke lënë firmën ose emrin e tyre mbi mure. Më të njohurit ndër ta janë zografi Mihailo dhe i biri i tij Euthyhios, të cilët punuan në shekullin XIII në manastirin e Lesnovës dhe në kisha të tjera nëpër Maqedoni. Stili i tyre dallohet për shpirtshmëri të theksuar, ekspresivitet dhe saktësi në detaje.

AKTIVITET

Hulumto dhe vizato një monument ose freskë nga Mesjeta që ndodhet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

A E DINI SE

Shën Sofia në Ohër përmban freska nga shekulli XI, të cilat janë ndër shembujt më të rëndësishëm të artit bizantin në Ballkan.



Kisha e Shën Sofisë, Ohër, shek. XI

PYETJE

1. Cilat janë vendbanimet më të rëndësishme prehistorike në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
2. Cila është funksioni i idhujve neolitikë dhe si duken ata?
3. Cilat janë karakteristikat kryesore të mozaikëve antikë në Herakleja dhe Stobi?
4. Cilat janë monumentet mesjetare më të rëndësishme në territorin e shtetit tonë?
5. Si duket një program i freskopikturës në një kishë mesjetare?
6. Si mund të krijosh një vepër artistike të frymëzuar nga një lokalitet arkeologjik ose mozaik?

RILINDJA E HERSHME

Fillimi i një epoke të re

Rilindja përfaqëson një periudhë historike të ringjalljes kulturore dhe artistike që fillon në Itali në shekullin XIV. Rrënjët e saj gjenden në rikthimin te idealet e antikitetit– harmonia, proporcioni dhe kuptimi racional i botës. Rilindja e hershme shënon braktisjen e artit simbolik mesjetar dhe fillimin e vëzhgimit të natyrës, trupit të njeriut dhe hapësirës. Në art futen risi të reja si perspektiva lineare, drita dhe hija realiste, saktësia anatomike dhe shfaqja e shprehjes individuale të artistit. Qendra e këtij zhvillimi është qyteti i Firences, ku arti, shkenca dhe filozofia lidhen në një vizion të ri sintetik për botën.

TERMA KYÇ:

rilindje, perspektivë lineare, freskë, kontrapost (pozicion natyror i trupit në skulpturë), sfumato (skjaçato) – kalim i butë i dritës dhe hijes për efekt realist



Darka e fundit, Andrea del Castagno, Santa Apostoli, Firence, rreth 1447



Porta e Parajsës (reliev), Lorenzo Ghiberti, Baptisteri i Firences, 1425–1452

Karakteristikat e artit në Rilindjen e Hershme


Në këtë fazë, artistët synojnë ta paraqesin botën reale përmes parimeve racionale dhe vëzhgimit. Hapësira në piktura organizohet përmes **perspektivës** gjeometrike, trupat marrin **vëllim dhe peshë**, ndërsa fytyrat shfaqin **gjendje emocionale**. Figurave u jepet sfond natyror ose kornizë arkitektonike, me një organizim logjik të skenës. Drita përdoret për të modeluar formën, ndërsa ngjyrat zgjidhen me kujdes për të krijuar harmoni.

Giotto di Bondone – pararendës i Rilindjes

Edhe pse formalisht i përket ende mesjetës së vonë, Giotto (1267–1337) konsiderohet si artisti që paralajmëroi shpirtin e Rilindjes. Afresket e tij në **kapelën Scrovegni** në Padova braktisin stilin mesjetar. Ai krijon figura tredimensionale, të vendosura në hapësira arkitektonike dhe të mbushura me emocione. Trupat kanë peshë, lëvizjet janë natyrore dhe figurat komunikojnë mes tyre. Edhe pse teknikisht nuk përdor ende perspektivën, vepra e tij vendos themelet për gjeneratat e ardhshme.

Filippo Brunelleschi – babai i perspektivës

Arkitekt, inxhinier dhe skulptor, Brunelleschi (1377–1446) zhvillon parimin matematik të **perspektivës lineare**, duke bërë revolucion në paraqitjen artistike të hapësirës. Në vitin 1420 fillon ndërtimin e **kupolës së katedrales Santa Maria del Fiore në Firence**, pa mbështetje qendrore. Përveç arkitekturës, Brunelleschi ndikon edhe në pikturë përmes eksperimenteve të tij mbi perspektivën, të cilat ua transmeton artistëve bashkëkohës.



Andrea Mantegna, "Shën Sebastiani", shekulli XV

A E DINI SE

Masaccio ishte një nga piktorët e parë që zbatoi ligjet e perspektivës dhe realizmit në pikturat fetare, gjë që përbënte një revolucion të vërtetë në art.

AKTIVITET

Imagjino se je një artist në Firence në shekullin XV. Bëj një skicë ose një kompozim të vogël në të cilin do të përdorësh të paktën tre karakteristika të dallueshme të Rilindjes së hershme.

Çfarë paraqet perspektiva lineare?

Perspektiva lineare është një mënyrë e vizatimit me anë të së cilës piktorët krijojnë iluzionin e thellësisë mbi një sipërfaqe të sheshtë. Ajo bazohet në parimin se objektet që janë më larg duken më të vogla, ndërsa vijat paralele bashkohen në një pikë të vetme – të quajtur **pika e zhdukjes** – mbi vijën e horizontit.

Filippo Brunelleschi e përdori për herë të parë këtë teknikë rreth vitit 1420, kur bëri një demonstrim duke vizatuar fasadën e katedrales në Firence. Ai vendosi një vijë horizontale (vija e shikimit), zgjodhi një pikë mbi të (pika e zhdukjes) dhe i drejtoi të gjitha vijat paralele drejt asaj pike. Kështu arriti të krijojë një paraqitje tredimensionale të saktë të arkitekturës.

Kjo teknikë u mundësoi piktorëve të organizojnë skena komplekse me logjikë të saktë hapësinore. Për shembull, dyshemetë duken sikur "hyjnë" në pikturë, rrugët ngushtohen drejt sfondit, ndërsa ndërtesat paraqiten me thellësi reale.

Donatello – ringjallja e skulpturës

Skulptori Donatello (1386–1466) e ringjalli skulpturën antike përmes interesit të tij për anatominë dhe shprehjen. Skulptura e tij prej bronzi **"Davidi"** është figura e parë e zhveshur në këmbë pas antikitetit. Donatello gjithashtu përdori perspektivën në reliefe përmes teknikës **schiacciato** (reliev shumë i cekët) dhe u mor me psikologjinë e figurës.

Masaccio – piktori i kohës së re

Masaccio (1401–1428), në një periudhë të shkurtër, krijoi vepra që vendosën themelet e pikturës së Rilindjes. Në **afresket e kapelës Brancacci në Firence** ai përdori perspektivë lineare, drejtim të qartë të dritës dhe anatomi të saktë. Skenat kanë përbërje dramatike, ndërsa figurat paraqiten me shprehje të brendshme. Afresku i tij **"Dëbimi nga Parajsa"** e paraqet figurën e zhveshur njerëzore me vuajtje dhe dinjitet – diçka e panjohur në ikonografinë mesjetare.



Davidi, Donatello, Muzeu Kombëtar Bargello, Firence, rreth vitit 1440.

A E DINI SE

Davidi i Donatellos ishte i destinuar të qëndronte në kopshtin privat të familjes së fuqishme Medici dhe ishte skulptura e parë e këtij lloji në hapësirë publike pas më shumë se një mijë vjetësh.

AKTIVITET

Skulptura „Davidi" e Donatellos ndryshon nga paraqitjet mesjetare sepse paraqet figurën plotësisht të zhveshur, me trup të lirë, volum dhe anatomi realiste. Ai qëndron në një pozë natyrale me kontrapost, duke shfaqur lëvizje dhe gjallëri, ndërsa shprehja e fytyrës është e qetë dhe njerëzore. Këto elemente – realizmi, individualiteti dhe rikthimi te modeli antik – e bëjnë atë një vepër tipike të Rilindjes.

Fra Anxheliko dhe Piero della Francesca – Shpirtërorja dhe shkenca

Fra Anxheliko (1400–1455), një murg dominikan, krijoi freska të mbushura me paqe shpirtërore dhe pastërti drite. Skenat e tij janë të thjeshta, por plot simbolikë. Në anën tjetër, **Piero della Francesca (1415–1492)** përdori rregullat matematikore të perspektivës dhe proporcionit. Në veprën **"Pagëzimi i Krishtit"**, Piero bashkon shpirtëroren dhe shkencën përmes simetrisë precize dhe një atmosfere të qetë.



Portreti i Dukës dhe Dukeshës së Urbinës, Piero della Francesca, Galeria Uffizi, Firence, rreth vitit 1472

Sandro Botiçeli – Poeti i vijës

Sandro Botiçeli (1445–1510) krijoi piktura poetike, të idealizuara dhe të mbushura me simbolikë mitologjike. Në veprën e tij të njohur **"Lindja e Venerës"**, ai paraqet perëndeshën që del nga një guaskë deti – skenë e mbushur me hijeshi, lëvizje dhe vijë ritmike. Edhe pse ndonjëherë stili i tij largohet nga realizmi i rreptë, Botiçeli fut në veprat e tij elegancën dhe estetikën dekorative që mbeten të dallueshme deri më sot.

AKTIVITET

Krahasoni veprat e Fra Anxhelikos dhe Piero della Francescas. Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet në mënyrën e përdorimit të dritës dhe të kompozicionit?



Pagëzimi i Shenjtë, Piero della Francesca, Galeria Kombëtare, Londër, rreth vitit 1450

PYETJE

1. Cilat janë karakteristikat kryesore pamore të Rilindjes së Hershme?
2. Si e zhvilloi Brunelleschi perspektivën lineare?
3. Pse është e rëndësishme skulptura "Davidi" e Donatellos?
4. Çfarë risi solli Masaccio në pikturën me fresko?
5. Si ndryshojnë stilistikisht Fra Anxheliko dhe Piero della Francesca?

A E DINI SE

Piktura "Lindja e Venerës" është figura e parë femërore nudo në madhësi natyrale e pikturuar pas periudhës antike?

RILINDJA E LARTË

Arti i harmonisë së përsosu

Në fillim të shekullit XVI, arti i Rilindjes italiane hyn në fazën e saj më të ndritur – periudhën e Rilindjes së Lartë. Ky është një kohë kur arrihet sinteza më e përsosur ndërmjet formës artistike dhe përmbajtjes, ku saktësia anatomike, proporcioni ideal dhe balanca kompozicionale përmblidhen në mënyrë të përsosur. Qendra e skenës artistike zhvendoset nga Firenca në Romë, falë mbështetjes së papëve, të cilët bëhen mbrojtësit kryesorë të artit.

Në këtë periudhë dominojnë tre gjeni të mëdhenj: Leonardo da Vinçi, Mikelanxhelo Buonarroti dhe Rafael Sancio Santi. Ata jo vetëm që i kapërcejnë paraardhësit e tyre, por vendosin standarde të reja të bukurisë, thellësisë dhe përmbajtjes intelektuale në art.

TERMA KYÇ:

Rilindja e Lartë, sfumato, anatomi, Kapela Sistine, kontrapost

Leonardo da Vinçi – Gjeniu universal

Leonardo da Vinçi (1452–1519) ishte artist, shkencëtar, inxhinier, anatomist dhe vizionar. Vepra e tij nuk mund të kufizohet vetëm në pikturë – ai e studioi botën me kuriozitet të madh dhe mendje racionale. Ai është i pari që përdor teknikën **"sfumato"** – një mënyrë kalimi të butë mes hijes dhe dritës – për të krijuar efekt real të thellësisë.

Vepra e tij më e njohur, **"Darka e Fundit"**, paraqet një skenë intensive dhe të mbushur me psikologji, ku Jezusi dhe 12 apostujt ndodhen në momentin dramatik kur ai njofton se një prej tyre do ta tradhtojë. Figurat janë të paraqitura me shprehje të thella emocionale, me gjeste të qarta dhe të vendosura në perspektivë precize që drejton shikimin te Krishti.

Leonardo ishte i fiksuar pas idesë që arti duhet të pasqyrojë natyrën, jo vetëm përmes syve, por edhe përmes arsyes. Ai studionte me përpikëri çdo detaj – nga mënyra si reflektohej drita mbi lëkurë, deri te lëvizja e ujit apo anatomi e trupit. Vazhdimisht vizatonte, eksperimentonte dhe regjistronte vëzhgimet e tij.



"Mona Liza", Leonardo da Vinci, Muzeu i Luvrit – Paris, shek. XVI

Shënimet e tij përmbajnë skica mekanizmash, urash, trupash në lëvizje, madje edhe makina fluturuese. Sipas tij, artisti duhet të jetë edhe vëzhgues, edhe mendimtar, edhe shpikës.

"Mona Lisa" (e njohur edhe si La Gioconda) është më shumë se një portret – ajo është një enigmë që ka ngjallur admirim për shekuj. Qëndrimi i saj është i thjeshtë, por kompozicioni është i ekuilibruar në mënyrë të përsosur.

Sfondi është pikturuar me teknikën sfumato, gjë që krijon një atmosferë mjegullore. Drita është shpërndarë aq me kujdes sa fytyra duket e gjallë, ndërsa kalimet e buta mes dritës dhe hijes i japin thellësi. Në vend të një bukurie stereotipe, Leonardo na paraqet një grua me jetë të brendshme, inteligjencë dhe emocion – diçka krejtësisht e re për kohën.



Njeriu i Vitruvit, Leonardo da Vinçi, Galeria dell'Accademia – Venecia, fundi i shek. XV

Rafael Sanzio Santi – mjeshtër i harmonisë

Rafael (1483–1520) ishte një artist i ri dhe i talentuar, i cili në krijimtarinë e tij të shkurtër, por shumë të frytshme, realizoi disa nga kompozicionet më të përsosura të artit. Piktura e tij **"Shkolla e Athinës"** është simbol i mendimit të Rilindjes. Ajo paraqet një takim të imagjinuar të filozofëve më të mëdhenj antikë – Platoni, Aristoteli, Sokrati, Diogjeni – në një hapësirë arkitektonike të frymëzuar nga veprat e Bramantes.

Çdo figurë është e individualizuar, e vendosur në një tërësi komplekse, por harmonike. Vepra i lavdëron arsyen dhe dialogun, ndërsa Rafael e përdor pikturën si mjet për ndriçim shpirtëror dhe intelektual.



Shkolla e Athinës, Rafaelo, Muzeu i Vatikanit – fillimi i shek. XVI

Mikelanxhelo Buonaroti – drama e trupit njerëzor

Mikelanxhelo (1475–1564) ishte skulptor, piktor, arkitekt dhe poet. Për të, trupi njerëzor ishte mjeti më i lartë i shprehjes artistike. Skulptura "Davidi" paraqet hirin anatomik të përsosur në një moment përqendrimi para betejës. Ndryshe nga versionet e mëparshme, Mikelanxhelo e paraqet Davidin para veprimit, me muskuj të tendosur dhe një vështrim të mprehtë. Ai është hero biblik, simbol i rinisë dhe i forcës së pasionuar të luftëtarit kundër tiranisë.

Pozicioni (kontraposti) është i frymëzuar nga ideali antik, por i pasuruar me dramatizëm dhe thellësi psikologjike. Skulptura bëhet simbol i dinjitetit, guximit dhe vetëdijes njerëzore – një manifest i humanizmit.



Skulptura "Davidi", Mikelanxhelo, Galeria dell'Accademia – Firence, fillimi i shek. XVI

Kapela Sistine – pikturë që flet.

Vepra më madhështore e Mikelanxhelos është **tavani i Kapelës Sistine**, i pikturuar mes viteve 1508–1512. Ky cikël afreskesh paraqet skena nga Dhiata e Vjetër, përfshirë edhe **"Krijimin e Adamit"**, ku Zoti e prek njeriun, duke i dhënë simbolikisht jetën. Trupat janë monumentalë, të mbushur me forcë dhe lëvizje, ndërsa kompozimet janë menduar me kujdes. Mikelanxhelo, edhe pse ishte skulptor nga natyra, në këtë vepër dëshmoi një talent gjigant në pikturë, anatomi dhe kompozicion.



Kapela Sistine – kupola, Mikelanxhelo, Vatikani, fillimi i shek. XVI

Arkitektura në Rilindjen e Lartë

Arkitektura dallohet për simetrinë, format e qarta gjeometrike dhe proporcionet e frymëzuara nga Roma antike. Donato Bramante, me planin e tij për **bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan**, përcaktoi vizionin e tempullit ideal. Plani qendror, kupola dhe shpërndarja harmonike e hapësirës pasqyrojnë idenë e rendit hyjnor.

Hapësira merr një vlerë simbolike – bëhet pasqyrë e universit, të krijuar sipas masës njerëzore.



Kupola e Bazilikës së Shën Pjetrit, Mikelanxhelo (arkitekt), Vatikani, shek. XVI

Karakteristikat figurative të Rilindjes së Lartë

- Anatomia e saktë dhe realiste
- Kompozime të balancuara me logjikë të brendshme
- Modelim i butë përmes dritës dhe hijes
- Harmoni mes njeriut dhe hapësirës
- Thellësi shpirtërore dhe intelektuale

A E DINI SE

Mikelanxhelo punoi vetëm për katër vite, në kushte të vështira, për të realizuar kupolën e Kapelës Sistine. Leonardo la pas mijëra faqe me vizatime, ide dhe vëzhgime, shumë përpara kohës së tij. "Mona Liza" ishte në pronësi të Napoleonit, para se të përfundonte në Luvër.

AKTIVITET

Analizo "Shkollën e Athinës" nga Rafaelo. Vëzhgo: arkitekturën, rreshtimin e figurave, mënyrën e paraqitjes së dialogut ndërmjet filozofëve

PYETJE

1. Kush janë tre artistët më të rëndësishëm të Rilindjes së Lartë?
2. Çfarë përfaqëson "Mona Liza" dhe pse është aq e rëndësishme?
3. Çfarë simbolike ka skulptura "Davidi"?
4. Cilat janë karakteristikat kryesore të arkitekturës në Rilindjen e Lartë?
5. Pse është e rëndësishme Kapela Sistine për historinë e artit?

MANIERIZMI

Arti i bukurisë së shtrembëruar

Pas harmonisë dhe ekuilibrit të përsosur të rilindjes, arti në Evropë hyn në një periudhë të re të njohur si **manierizëm**. Ky stil zhvillohet në Itali në gjysmën e parë të shekullit XVI, por shpejt përhapet edhe në pjesë të tjera të kontinentit. Në vend që të qëndrojnë besnikë ndaj natyralitetit dhe proporcioneve të Rilindjes së Lartë, manieristët krijojnë art të **qëllimshëm të shtrembëruar, me forma të zgjatura, poza artificiale, perspektiva të pazakonta dhe kompozime dramatike.**

TERMA KYÇ:

manierizëm, serpentinata, alegori, Giambologna, Giulio Romano

Konteksti historik

Manierizmi shfaqet në një kohë të **trazirave të mëdha shoqërore, politike dhe fetare,** siç janë shpërbërja e idealeve të Rilindjes, Reforma dhe kundërreagimet e Kishës Katolike. Artistët ndiheshin të dekurajuar dhe të pasigurt për vlerat e vjetra. Në vend që ta paraqesin realitetin, ata fillojnë të shprehin **gjendjen e tyre të brendshme, ndonjëherë edhe ankthin,** përmes figurave që duken sikur nuk i përkasin tokës.

Karakteristikat figurative

Arti manierist është lehtësisht i dallueshëm nga:

- **Proporcionet e zgjatura** – figura me gjymtyrë, qafa dhe trupa tepër të gjatë.
- **Pozat dhe lëvizjet spirale** – trupat vendosen në pozicionin e ashtuquajtur serpentinata, që duket si një spiral e përdredhur.
- **Ngjyra intensive dhe efekte të pazakonshme drite** – për krijimin e ndikimit emocional.
- **Kompozim i ndërlikuar** – shpesh pa perspektivë qendrore ose pa pikë të qartë fokale.
- **Dekorativitet dhe finesë** – theksi vendoset te kompleksiteti estetik dhe jo te natyrshmëria.

Artistë dhe vepra të rëndësishme

Një nga artistët më të njohur të manierizmit është **Jacopo da Pontormo,** i cili me pikturën e tij **"Zbritja nga kryqi"** krijon një skenë dinamike me figura që duken pa kohë dhe sikur po levitojnë.



"Zbritja nga Kryqi", Jacopo da Pontormo, Santa Felicita – Firence, shek. XVI

Agnolo Bronzino ishte mjeshtër i portretit dhe alegorisë. Vepra e tij **"Alegoria e dashurisë dhe kohës"** është e mbushur me simbolikë, erotizëm dhe rrëfime të paqarta, çka është karakteristikë e shpirtit manierist.



Portreti i Eleonorës së Toledos me të birin, Agnolo Bronzino, Galeria Uffizi, Firence, shek. XVI



Alegoria e dashurisë dhe kohës, Agnolo Bronzino, Galeria Kombëtare, Londër, shek. XVI

Në Spanjë, **El Greco (Domenikos Theotokopulos)** krijon vepra që konsiderohen kulm i manierizmit shpirtëror. Në pikturat e tij, si p.sh. "Varrimi i Kontit Orgaz", figurat janë të zgjatura, fytyrat rrezatojnë me një dritë të brendshme, dhe kompozicionet janë të mbushura me kontrast dramatik midis botës tokësore dhe asaj qiellore.



Varrimi i Kontit Orgaz, El Greco, Kisha Santo Tomé, Toledo, shek. XVI



Shën Martini dhe lypësi, El Greco, Galeria Kombëtare e Artit, Washington, shek. XVI

Manierizmi në arkitekturë

Arkitektët e manierizmit braktisin logjikën e qartë të arkitekturës klasike. Në vend të harmonisë, ata përdorin **ironi, lojë dhe të paparashikueshme**. Shembull i tillë është **Pallati del Te** në Mantova, vepër e Giulio Romano-s, i cili përfshin shaka arkitektonike – si p.sh. shtylla të rreme ose dritare që luajnë me perceptimin vizual të shikuesit.



Pallati del Te, Giulio Romano, Mantova – Itali, shekulli XVI (pamje të brendshme)

A E DINI SE

Shumë artistë manieristë, si Parmigianino, qëllimisht i zgjatnin format dhe shkelnin perspektivën natyrore për të krijuar:Elegancë, Misticizëm, Tension të brendshëm, në vend të realizmit. Vepra e tij "Madona me qafë të gjatë" është e njohur për figurën e zgjatur të Shën Mërisë dhe proporcionet e panatyrshme, të cilat në atë kohë janë konsideruar si shenjë e bukurisë më të lartë dhe shpirtërisë.



Pallati del Te, Giulio Romano, Mantova – Itali, shekulli XVI(pamje të jashtme)

Manierizmi në skulpturë

Skulptorët gjithashtu përdorin zgjatjen dhe përdredhjen e formave. Në skulpturat e **Giambologna-s**, si "Rrëmbimi i sabinaseve", trupat rrotullohen dhe bashkohen me njëri-tjetrin në një mënyrë që nuk do të ishte e mundur në natyrë, por që vizualisht është shumë e fuqishme dhe mbresëlënëse.



"Rrëmbimi i Sabinaseve", Giambologna, Loggia dei Lanzi, Firence, shek. XVI

A E DINI SE

- Fjala "manierizëm" vjen nga fjala italiane maniera, që do të thotë "mënyrë" ose "stil". Fillimisht, ky term përdorej për të përshkruar stilin e rafinuar dhe artificial të pikturës që ishte "në mënyrën e" mjeshtërve të mëdhenj si Rafaelo dhe Mikelanxhelo, por pa origjinalitetin e tyre.
- El Greco, megjithëse i lindur në Kretë, e zhvilloi stilin e tij në Spanjë, ku konsiderohet paralajmërues i barokut.

PYETJE

1. Cilat janë ndryshimet kryesore mes manierizmit dhe renesancës së lartë?
2. Si i përdorën kompozimin dhe proporcionet artistët e manierizmit për të krijuar ndjesinë e bukurisë artificiale?
3. Çfarë mendoni, pse figura në manierizëm shpesh duket jo e natyrshme ose shumë dramatike?
4. Cilat janë tiparet kryesore të arkitekturës së renesancës së lartë?
5. Cilat janë emrat e artistëve të lidhur me manierizmin në Itali, dhe cilët janë jashtë saj?

AKTIVITET

Shikoni veprat e Bronzino-s dhe El Greco-s. Mundohuni të bëni një skicë të një figure me proporcione të zgjatura dhe pozë dramatike. Mendoni: Pse manneristët dëshironin ta përfaqësonin realitetin në këtë mënyrë të çuditshme? Çfarë ndjesie donin të zgjonin te shikuesi?

BAROKU

Art që flet përmes dritës, lëvizjes dhe emocioneve

Pas stilit ekspresiv dhe artificial të manierizmit, në art shfaqet një drejtim i ri, që rikthen përfaqësimin realist, por me dramaticitet të theksuar, **lëvizje dhe forcë emocionale**. Ky stil, i njohur si **baroku**, zhvillohet në shekullin XVII në Itali, dhe më pas përhapet në të gjithë Evropën dhe pjesë të Amerikës Latine. Baroku nuk e shmang realizmin – përkundrazi, e përdor atë për të ndikuar te ndjenjat e shikuesit dhe për ta përfshirë emocionalisht në veprën artistike.

TERMA KYÇ:

barok, kiaroskuro, tenebrizi, Bernini, Karavaxho, Rembrandt, Velaskez

Konteksti historik dhe shoqëror

Arti barok zhvillohet nën ndikimin e fortë të **kontrareformës** – përpjekjes së Kishës Katolike për të rikthyer dominimin pas Reformës Protestante. Kisha bëhet sponsori kryesor i artit, duke porositur vepra që duhet të përçojnë **vizualisht besimin, të inspirojnë dhe të edukojnë**. Papët, kardinalët dhe sundimtarët ndërtojnë katedrale, bazilika dhe rezidenca, ku arti bëhet **mjet i fuqishëm bindjeje dhe ndikimi.**

Në të njëjtën kohë, **absolutizmi** përhapet në Evropë. Mbreti Luigji XIV i Francës e përdor barokun për të treguar fuqinë e tij mbretërore. Arti bëhet edhe mjet i propagandës shtetërore, duke përshkruar portrete mbretërore, fitore ushtarake dhe alegori mitologjike.

A E DINI SE

- Shumë piktura baroke përdorin dritë dhe hije dramatike (kiaroskuro) për të shkaktuar ndjenjë të thellë emocionale dhe ndjeshmëri fetare. Ky efekt rrit dramaticitetin dhe e udhëheq shikuesin drejt qendrës së skenës.
- Skulptori Gian Lorenzo Bernini krijonte vepra që duket sikur lëvizin në hapësirë. Në "Ekstaza e Shën Terezës", ai bashkon shprehje emocionale, dritë dhe strukturë teatrale, duke arritur një fuqi shpirtërore mahnitëse.

Karakteristikat pamore të Barokut

Arti barok dallohet për disa veçori stilistike kryesore:

- **Emocion i theksuar dhe lëvizje** – gjithçka duket si e kapur në një çast veprimi.
- **Kiaroskuro (chiaroscuro)** – teknikë që përdor kontrast të fortë mes dritës dhe hijes.
- **Tenebrizi (tenebrism)** – skena mbështillet me errësirë të thellë, ndërsa dritë intensive ndriçon figurat kryesore.
- **Iluzionizëm** – veçanërisht në afreske, me elemente arkitektonike të rreme dhe skena qiellore që duken sikur dalin nga tavani.
- **Teatralitet dhe shkëlqim** – kompozimi është si një skenë teatrale, me ngjyra të pasura dhe intensive.
- **Kompozime me shumë figura** – vepra plot me lëvizje, trupa, simbolikë, kompleksitet dhe rrëfim të pasur vizual.

Baroku në arkitekturë

Arkitektura baroke braktis simetrinë e rreptë të Rilindjes dhe hyn në një lojë dinamike formash, drite dhe hapësire. Kishat ndërtohen me **kupola eliptike, fasada dramatike, dhe një interier të pasur** me skulptura, afreske dhe ar.



Nicola Salvi, Fontana di Trevi, Romë – e përfunduar më 1762

Gian Lorenzo Bernini projektoi **kolonadat e Sheshit të Shën Pjetrit në Vatikan**, duke krijuar një hapësirë arkitektonike që "përqafon" besimtarët. Nuk është vetëm një arritje teknike, por edhe një mesazh simbolik.

Francesco Borromini, në **kishën e tij San Carlo alle Quattro Fontane**, demonstron inovacionin e arkitekturës baroke – fasada dridhet, muret janë të lakuara, hapësira rrjedh, dhe ndërtesa tërësisht duket si një qenie e gjallë.



San Carlo alle Quattro Fontane, Francesco Borromini, Romë – shekulli XVII

AKTIVITET

Vizato një kompozim në të cilin do të përdorësh kontrast të theksuar mes dritës dhe errësirës për të krijuar efekt barok. Mendo ku do ta përqendrosh vëmendjen e shikuesit.

Në Francë, **Pallati i Versajës** bëhet kulmi i barokut obortrar. Me sallat e tij madhështore, kopshtet gjigante dhe renditjen simetrike, ai lavdëron absolutizmin e Mbretit-Diell.



Pallati i Versajës, Louis Le Vau dhe Jules Hardouin-Mansart,



Versajë, Francë, shek. XVII-XVIII

Arkitektura baroke nuk shprehet vetëm përmes ndërtesave, por edhe përmes rregullimit urban të hapësirës. Një rol veçanërisht të rëndësishëm luajnë **fontanat**, të cilat shpesh vendoseshin në qendrat e shesheve apo në kopshtet mbretërore. Ato nuk janë vetëm funksionale, por edhe elemente dekorative dhe simbolike. Shembujt më të njohur janë: **Fontana di Trevi në Romë, Fontana e Katër Lumenjve e Berninit në Sheshin Navona**. Me skulpturat e tyre dramatike, lëvizjen dinamike të ujit dhe integrimin në hapësirë, fontanat bëhen pjesë e përjetimit teatral të arkitekturës baroke.

Në Evropën Qendrore dhe Amerikën Latine, arkitektura baroke zhvillohet në formën e **barokut sakral**, shpesh me ndikime lokale dhe dekor të pasur.

AKTIVITET

Imagjino sikur hyn në një kishë baroke ose pallat. Përshkruaj me disa fjali se çfarë ndjenje do të përjetosh - a duket hapësira madhështore, dinamike, dramatike?



Fontana e Katër Lumenjve, Gian Lorenzo Bernini, Sheshi Navona, Romë, 1651

Baroku në skulpturë

Skulptura bëhet më shumë se një zbukurim – ajo shndërrohet në **pjesë të hapësirës**, me figura që duken sikur dalin nga muri ose lëvizin mes njerëzve.

Gian Lorenzo Bernini, si skulptori më i madh barok, krijon vepra të mbushura me lëvizje, teksturë dhe dramë teatrale. Në veprën e tij **„Ekstaza e Shën Terezës“**, shikuesi bëhet dëshmitar i një përjetimi mistik të shenjtores, të paraqitur me ndjeshmëri të jashtëzakonshme dhe dritë qiellore që bie nga një dritare e fshehur



"Apoloni dhe Dafne", Gian Lorenzo Bernini, Galeria Borghese, Romë, shek. XVII

Skulptura e tij **„Apoloni dhe Dafne“** përshkruan momentin e transformimit kur Dafne shndërrohet në një dru dafine. Gjethet, trupi dhe shprehja e fytyrës janë punuar me aq saktësi dhe hollësi, sa vepra duket e gjallë.

A E DINI SE

Arti barok shpesh është përdorur si mjet për propagandë fetare dhe politike, veçanërisht nga Kisha Katolike dhe mbretërit absolutistë.



"Ekstaza e Shën Terezës", Gian Lorenzo Bernini, kisha Santa Maria della Vittoria, Romë, shek. XVII

AKTIVITET

Hulumto një skulpturë baroke dhe vizato një figurë në lëvizje, me ekspresion të theksuar dhe rroba të valëzuara. Fokusohu në mënyrën se si lëvizja dhe ndjenja pasqyrohen përmes formës.

Baroku në pikturë

Piktura në periudhën baroke është fusha më e larmishme, me qasje të ndryshme në Itali, Spanjë, Holandë dhe Francë.

Karavaxho (Caravaggio, Itali) përdor modele të **zakonshme nga rruga, të vendosur në ambiente të errëta** ku drita bie në mënyrë dramatike mbi trupat. Vepra e tij **"Thirrja e Shën Mateut"** paraqet momentin e papritur të thirrjes hyjnore, me njerëz të zakonshëm në veshje moderne.

AKTIVITET

Zgjidh një pikturë baroke (p.sh. një vepër nga Karavaxho ose Rubens) dhe përshkruaj se si kompozicioni, drita dhe lëvizja krijojnë emocion të fortë dhe dramë vizuale.



"Thirrja e Shën Mateut", Karavaxho – Kisha San Luigi dei Francesi, Romë, shek. XVII

Në Spanjë, **Diego Velaskez** krijon piktura me thellësi intelektuale dhe strukturë të ndërlikuar. Në veprën **"Las Meninas" ("Zonjushet fisnike")**, shikuesi bëhet pjesë e ngjarjes – historia nuk është e qartë, rolet janë të përziera, hapësira zgjerohet përmes pasqyrave, pikturave brenda pikturës dhe perspektivave të ndryshme.

Rembrandt van Rijn (Holandë) fut në portret thellësi psikologjike. Vepra e tij **"Roja e natës"** nuk është një portret statik në grup, por një narrativ i gjallë, plot lëvizje, dritë dhe kuptime të fshehura. Në autoportretet e tij, Rembrandti paraqet plakjen, trishtimin, urtësinë dhe dinjitetin e tij personal.



"Las Meninas" ("Zonjushet fisnike"), Diego Velaskez – Muzeu Prado, Madrid, shek. XVII



"Roja e Natës", Rembrandt van Rijn – Rijksmuseum, Amsterdam, shek. XVII

Në barokun verior, artistë si **Johannes Vermeer** krijojnë vepra të mbushura me **heshtje, intimitet dhe realizëm** – vajza me vathin prej perle, një dhomë me dritë natyrale që hyn nga dritarja, një moment pa kohë.

Në Flandër, **Peter Paul Rubens** bashkon bukurinë klasike me **shprehje të fuqishme emocionale**. Kompozimet e tij të mëdha janë të mbushura me perëndi, heronj, lëvizje dramatike dhe trupa të stërholluar dhe të gjallë.



"Vajza me vath prej perle", Johannes Vermeer – Mauritshuis, Hagë, shek. XVII



"Rrëmbimi i vajzave të Leukipit", Peter Paul Rubens – Alte Pinakothek, Mynih, shek. XVII

A E DINI SE

Në disa kisha të Amerikës Latine, baroku ndërthuret me elementë vendas – engjëj me kapela me pendë, skena me kafshë të Amazonës dhe detaje nga kultura indigjene. Rembrandt ka realizuar mbi 80 autoportrete – më shumë se çdo piktor tjetër në histori.

PYETJE

1. Pse arti barok ka një efekt kaq të fuqishëm vizual dhe emocional?
2. Si është përdorur drita për të shprehur një mesazh shpirtëror?
3. Cilat janë dallimet kryesore mes barokut italian dhe atij verior?
4. Çfarë roli luan arkitektura në përçimin e ideologjisë baroke?
5. Pse "Las Meninas" konsiderohet një nga veprat më të rëndësishme të artit?

AKTIVITET

Zgjidh një vepër nga periudha baroke dhe përpiqu të bësh analizë të ndriçimit:Nga vjen drita? Çfarë ndriçon ajo? Çfarë mbetet në hije?

ROKOKO

Elegancë lozonjare dhe intimitet luksoz

Pas madhështisë dhe dramacitetit të barokut, në shekullin XVIII shfaqet një stil i ri artistik – rokokoja, e cila karakterizohet nga eleganca lozonjare, butësia dekorative dhe intimiteti i rafinuar. Në kundërshtim me seriozitetin dhe thellësinë fetare të barokut, rokokoja favorizon lehtësinë, kënaqësitë e jetës, skena intime dhe ornamentikë të zbukuruar. Ky stil zhvillohet në Francë dhe përhapet në mbarë Evropën, veçanërisht në rrethet aristokratike, duke pasqyruar shijet e një klase të re që kultivon kënaqësinë, jetën e pallateve dhe privilegjet shoqërore.

TERMA KYÇ:

rokoko, skena galante, Fragonard, pocelani, ornament

Konteksti historik dhe origjina

Termi **"rokoko"** vjen nga fjala frënge rocaille, që nënkupton guaska, gurë të vegjël dhe ornamente dekorative të përdorura në enterier dhe në kopshte. Stili u shfaq rreth vitit 1715, menjëherë pas vdekjes së mbretit Luigji XIV, kur jeta e oborrit u zhvendos nga Versaja në Paris. Me këtë fillon një periudhë e re kulture më private dhe intime, larg shkëlqimit të monarkisë absolute.

Rokoko nuk është vetëm një stil artistik, por një atmosferë e tërë kulturore që përfshin veshjen, muzikën, enterierin dhe mënyrën e jetesës. Është koha e salloneve, festave galante, aluzioneve mitologjike dhe kultit ndaj bukurisë dhe sensualitetit.

Karakteristikat figurative të rokoko-së

Rokoko dallohet për ngjyrat e çelëta pastel, modelimin e butë, kompozimet asimetrike dhe dekorativitetin e pasur. Në vend të narrativave të mëdha fetare ose historike, paraqiten skena të lehta dhe intime – flirtime në kopshte, tregime dashurie mitologjike, portrete dhe peizazhe idilike.

Vija është e hollë dhe lozonjare, format janë të buta dhe organike. Në vend të kontrastit dramatik, piktorët përdorin hije të lehta dhe kalime të buta që krijojnë një atmosferë të ngrohtë dhe të këndshme. Arti bëhet më shumë zbukurim sesa një mjet për shprehje dramatike.

A E DINI SE

- Stili rokoko shfaqet si një reagim ndaj barokut serioz dhe të rëndë. Në vend të dramës, ai ofron lehtësi, ngjyra të çelëta, forma lozonjare dhe skena intime nga jeta e përditshme e fisnikërisë.
- Veprat e Jean-Honoré Fragonard, si "Lëkundja", e paraqesin aristokracinë në momente argëtimi dhe dashurie. Në kompozim përdoren tonet e ndritshme, ndriçimi i butë dhe detajet lozonjare.

Piktura

Në pikturë, rokokoja arrin kulmin e saj me artistë si **Antoine Watteau, François Boucher** dhe **Jean-Honoré Fragonard.**

Antoine Watteau zhvillon të ashtuquajturat **"skena galante"** – paraqitje të fantazuar të fisnikëve në peizazhe idilike, të frymëzuara nga teatri dhe komedia. Vepra e tij **"Zbritja në ishullin Kithera"** përfaqëson simbolin e rokoko-së – kufijtë e paqartë midis realitetit dhe fantazisë, dashurisë dhe lojës.

François Boucher, piktori i Markezeshës de Pompadour (e dashura e Luigjit XV), krijon vepra sensuale dhe të erotizuara me tema mitologjike dhe pastorale, të pasura me tekstura dhe ornamente.

Jean-Honoré Fragonard, ndoshta piktori më karakteristik i rokoko-së, me veprën **"Lëkundja"** krijon një simbol të lozonjarisë, kënaqësisë dhe joshjes. Kompozimet e tij janë plot jetë, lëvizje dhe dritë të brendshme.



Antoine Watteau, "Zbritja në ishullin Kithera", Muzeu i Luvrit, shek. XVIII



François Boucher, "Pushimi i Dianës", Luvër, shek. XVIII



Jean-Honoré Fragonard, "Lëkundja", Koleksioni Wallace, shek. XVIII

AKTIVITET

Krijo një vizatim ose kolazh duke përdorur: ngjyra të ndritshme, forma të rrumbullakëta, elemente nga natyra luksoze, ...me qëllim të paraqitjes së një atmosfere të lehtë dhe të gëzueshme, në frymën e rokokosë.

Skulptura

Skulptura në rokoko është më pak e pranishme, por megjithatë ekzistojnë shembuj të jashtëzakonshëm të figurave dekorative dhe të vogla, shpesh të punuara në porcelan ose mermer. Preferohen lëvizjet e buta e elegante, paraqitjet e çifteve të dashuruar, engjëjve dhe qenieve mitologjike. Skulptura shërben si pjesë e dekorit të brendshëm ose si zbukurim për mobilje dhe kopshte.

AKTIVITET

Krahaso një vepër arti nga baroku dhe një nga rokokoja. Përshkruaj dallimet në temë, ngjyra, lëvizje dhe emocionin që ato përcjellin.

Arkitektura dhe enterieri i rokokosë

Arkitektura e rokoko-së nuk synon monumentalitetin, por elegancën, intimitetin dhe zbukurimin e pasur të brendshëm. Enterierët janë të rafinuar, me tavane të shkëlqyeshme dhe mure të zbukuruara me ar, ornamente gipsi, pasqyra dhe efekte drite.



Tavan dekorativ në stil rokoko, Austri ose Gjermani, shekulli XVIII



Rezidenca e Würzburgut, brendësia e shkallëve, shekulli XVIII

Shembuj të njohur të enterierëve rokoko mund t'i gjejmë në **Rezidencën e Würzburgut** në Gjermani dhe në **Hotel de Soubise** në Paris. Në këto hapësira, çdo element – nga tavani deri te mobiliet – duket si pjesë e një vepre të vetme artistike.



Sallon në Hotel de Soubise, Paris, rreth vitit 1735.

Arti i aplikativ: Mobilje, porcelan dhe zbukurime

Rokokoja solli një revolucion edhe në dizajnin e mobiljeve. Pjesët e mobiljeve realizoheshin me forma të harkuara, të zbukuruara pasur me gdhendje dhe ar të aplikuar. Karakteri intim i enterierëve rokoko kërkonte mobilje që të ishin të rehatshme, por edhe vizualisht të pasura – karrige, tavolina të vogla, komoda dhe pasqyra bëheshin vepra të vërteta mjeshtërore të zanatçinjve.

Porcelani në periudhën e rokokosë veçohet veçanërisht – kryesisht falë prodhimit në **Meissen** (Gjermani) dhe **Sèvres** (Francë). Figurina, enë dhe objekte zbukurimi paraqesin skena dashurie, krijesa mitologjike dhe motive të gjalla me lule.



Mobilje në stilin rokoko, Francë, shek. XVIII



Figurina prej porcelani nga Meissen, Gjermani, shek. XVIII



Çajnik prej porcelani nga Sèvres, Francë, shek. XVIII

AKTIVITET

Imagjinoni se po dekoroni një dhomë në stilin rokoko. Përshkruani çfarë ngjyrash, formash, objektesh dhe zbukurimesh do të përdorni. Krijoni një skicë ose kolazh duke përdorur imazhe të mobiljeve, perdeve, llambadarëve dhe veprave artistike në frymën e rokokosë.

PYETJE

1. Cilat janë dallimet kryesore mes stilit barok dhe atij rokoko?
2. Çfarë do të thotë termi "skenë galante"?
3. Kush janë tre artistët më të njohur të pikturës rokoko?
4. Cili është roli i artit dekorativ në enterierët rokoko?
5. Pse rokokoja konsiderohet si stil intim dhe sensual?

NEOKLASICIZMI

Rikthim drejt idealeve të antikitetit

Neoklasicizmi është një lëvizje artistike që u zhvillua në gjysmën e dytë të shekullit XVIII si reagim ndaj zbukurimeve dhe lehtësisë së rokokosë. Ai përfaqëson një rikthim te vlerat e artit antik grek dhe romak – rreptësi, rregull, qartësi dhe madhështi morale. Në kohë të trazirave politike dhe intelektuale, veçanërisht nën ndikimin e Iluminizmit dhe Revolucionit Francez, arti shndërrohet në një mjet për të shprehur ideale si ndershmëria, heroizmi dhe arsyeja.

TERMA KYÇ:

Portik, neoklasicizëm, Jacques-Louis David, Antonio Canova, Panteoni (Paris), simetri klasike

Konteksti historik

Neoklasicizmi u zhvillua në gjysmën e dytë të shek. XVIII nën ndikimin e zbulimeve arkeologjike në Pompei dhe Herkulanum. Gjetjet e reja nga bota e lashtë shkaktuan një entuziazëm kulturor dhe rixitën një kthim drejt estetikës së bazuar në racionalitet, harmoni dhe simetri. Kthimi drejt antikitetit shfaqet si një qëndrim ideologjik– një shprehje e besimit në arsyen, disiplinën dhe moralin.

Në planin politik, kjo lëvizje mbështet frymën republikane në rritje, veçanërisht në Francë dhe Amerikë. Revolucioni Francez dhe epoka e Napoleonit janë periudha kur neoklasicizmi bëhet arti zyrtar, simbol i patriotizmit, vetësakrificës dhe virtyteve qytetare.

A E DINI SE

Neoklasicizmi u shfaq në shek. XVIII si reagim ndaj stilit të lehtë dhe lozonjar të rokokosë. Ai rikthehet te idealet antike për rregull, qartësi, moral dhe simetri, sidomos në arkitekturë dhe pikturë.

Karakteristikat figurative

Neoklasicizmi dallohet për konture të qarta, paletë ngjyrash të ftohta, kompozime të balancuara dhe fokus te figurat njerëzore me anatomi të përsosur. Në vend të dekorativitetit dhe emocioneve, kultivohen disiplina dhe racionaliteti. Hapësira është e pastër, shpesh bosh, ndërsa kompozimi ndërtohet mbi baza gjeometrike dhe simetrike.

Temat merren nga historia, mitologjia dhe vlerat morale, me theks të veçantë mbi heroizmat, virtytet dhe sakrificën. Figurave shpesh u jepet paraqitje në momente zgjedhjeje dramatike ose dileme morale. Ato janë të modeluara me kujdes, me anatomi të theksuar dhe fortësi skulpturore. Kontrastet e dritës janë të moderuara, ndërsa skenat shpesh kujtojnë relievet ose frizat antike, me një qetësi dhe dinjitet statik.

AKTIVITET

Vizato një skenë të frymëzuar nga mitologjia apo historia antike. Kujdesu që kompozimi të jetë simetrik, me vija të qarta dhe disiplinë të theksuar trupore.

Piktura

Përfaqësuesi më i rëndësishëm i pikturës neoklasike është **Jacques-Louis David**, vepra e të cilit i shërben idealeve revolucionare dhe napoleoneane. Në pikturat e tij, çdo gjest dhe çdo element është simbol i virtytit dhe racionalitetit.

Në veprën e tij "Betimi i Horacëve", ai paraqet tre vëllezër që i japin betim babait të tyre se do ta mbrojnë atdheun – një simbol i vetëflijimit dhe patriotizmit.

Në veprën "Vdekja e Sokratit", David paraqet filozofin e madh teksa me qetësi e pranon dënimin me vdekje, i rrethuar nga nxënësit e tij – personifikim i arsyes dhe virtytit.



Jacques-Louis David, "Betimi i Horacëve", Luvër, 1784



Jacques-Louis David, "Vdekja e Sokratit", Muzeu Metropolitan i Artit, 1787

Një tjetër artist i rëndësishëm është **Jean-Auguste-Dominique Ingres**, i cili, megjithëse ndonjëherë konsiderohet si figurë kalimtare drejt romantizmit, krijon: portrete dhe skena historike të realizuara në mënyrë teknike të përsosur, me vizatim të theksuar dhe rreptësi klasike.

A E DINI SE

Jacques-Louis David përdorte tema nga Roma e lashtë për të përcjellë mesazhe për: virtytin, patriotizmin, heroizmin. Kompozimet e tij janë të qarta, dhe figurat duken si skulptura klasike.

Skulptura

Në skulpturën neoklasike ndihet qartë ndikimi i drejtpërdrejtë nga origjinalet greko-romake. Format janë të idealizuara, trupi është i modeluar me anatomi të saktë, dhe lëvizja është e përmbajtur.

Skulptori më i njohur neoklasik është **Antonio Canova**, një italian, veprat e të cilit rrezatojnë: qetësi, ekuilibër, dhe sipërfaqe të lëmuara deri në përsosmëri. Skulptura e tij **"Psika e gjallëruar nga puthja e Amorit"** është një nga shembujt më poetikë të tematikës dashurore neoklasike – idealizim i trupit dhe i ndjenjës.



Antonio Canova, "Psika e gjallëruar nga puthja e Amorit", Luvër, 1793



Antonio Canova, "Napoleoni si Zoti Mars", 1806

Veprat e Canovës pasqyrojnë parimet e: bukurisë klasike dhe qetësisë shpirtërore – pa dramatizëm, por të mbushura me ndjeshmëri të thellë.

A E DINI SE

Neoklasicizmi lindi si reagim ndaj stilit dramatik të barokut dhe atij zbukurues të rokokosë, duke u rikthyer te vlerat e botës antike?

AKTIVITET

Analizo një vepër arti neoklasike (p.sh. "Betimi i Horacëve") dhe shpjego: si e përdor artisti formën, ngjyrat, dhe qëndrimin e trupave për të përcjellë vlerat dhe idealet e kohës.

Arkitektura neoklasike

Në arkitekturë, neoklasicizmi shprehet përmes synimit drejt thjeshtësisë, rreptësisë dhe madhështisë, të frymëzuara nga format dhe parimet e arkitekturës antike greke dhe romake. Ai paraqitet si një reagim kundër zbukurimeve të tepruara të barokut dhe rokoko-së dhe synon bukurinë racionale, simetrinë dhe funksionalitetin.

Ndërtesat shpesh kanë hyrje të vendosur në qendër me portik, të mbështetur nga **kolona dorke, jonike ose korintike**, ndërsa fasadat **janë të organizuara në mënyrë gjeometrike** dhe të balancuar, pa teprime dekorative. Masiviteti, struktura e qartë dhe pamja monumentale përcjellin ndjenjën e stabilitetit dhe seriozitetit.



Kapitoli, Uashington – ndërtimi filloi më 1793



Galeria Kombëtare, Londër – fasada nga viti 1838



Pantheoni, Paris – ndërtimi filloi më 1758, përfundoi më 1790



Galeria Kombëtare, Londër – fasada nga viti 1838



Porta e Brandenburgut, Berlin – përfunduar më 1791

Elemente karakteristike:

- **Frontone** me relieve të thjeshta ose simbolike
- **Kupa** që dominojnë mbi hapësirën qendrore
- **Mure të lëmuara** me dekor minimal
- **Plan simetrik** me kompozim të theksuar boshtor
- **Podrume dhe platforma të larta që** krijojnë ndjesi madhështie

Neoklasicizmi ishte stili dominues për ndërtesa publike: muze, biblioteka, gjykata, universitete, godina qeveritare, por gjithashtu edhe për monumente madhështore dhe mauzole. Arkitektët shpesh frymëzoheshin nga **Panteoni romak** ose **Partenoni grek**.

Shembuj të njohur:

- **Panteoni në Paris** – i frymëzuar nga arkitektura romake, me kupolë masive dhe fasadë rreptësisht simetrike
- **Ndërtesa e Kapitolit në Uashington** – sinonim i arkitekturës demokratike amerikane
- **Muzeu Albrechtsburg** në Berlin, **Galeria Kombëtare** në Londër, **Porta Triumfale** në Paris

Arkitektura neoklasike shpesh lidhet me vlera si **rendi, virtyti qytetar dhe stabiliteti**, çka e bënte zgjedhje të preferuar për institucionet përfaqësuese dhe objektet shtetërore.



Enterier neoklasik me shpërndarje simetrike dhe kolona klasike

A E DINI SE

Jacques-Louis David jo vetëm që pikturoi momentet më të mëdha politike të kohës së tij, por ishte edhe piktori zyrtar i Napoleonit.
Ai realizoi veprën e njohur "Kurorëzimi i Napoleonit", ku perandori e kurorëzon vetveten – një mesazh i fortë politik dhe simbol i pushtetit absolut.

PYETJE

1. Cilat janë dallimet më të rëndësishme midis rokokosë dhe neoklasicizmit?
2. Çfarë simbolizon vepra "Betimi i Horacëve"?
3. Cilat janë karakteristikat e skulpturës neoklasike?
4. Si shprehet neoklasicizmi në arkitekturë?
5. Pse neoklasicizmi lidhet me moralin dhe arsyen?

AKTIVITET

Hulumtoni një ndërtesë në qytetin apo shtetin tuaj që përmban elemente neoklasike (shtylla, simetri, frontone etj.). Bëni një vizatim ose fotografi, dhe shkruani një analizë të shkurtër:Cilat elemente ju kujtojnë arkitekturën e lashtë greke apo romake?

ROMANTIZMI

Arti i ndjenjës, lirisë dhe natyrës

Romantizmi është një lëvizje artistike dhe kulturore që shfaqet në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, si një reagim ndaj racionalizmit dhe rregullave të rrepta të neoklasicizmit. Në vend të arsyes dhe rendit, romantizmi madhëron ndjenjën, intuitën, lirinë dhe përjetimin individual. Ky është art që rebelohet, eksploron, fantazon dhe drejtohet kah natyra, historia dhe bota e brendshme e njeriut.

TERMA KYÇ:

romantizëm, Delacroix, Friedrich, neogotike, romantizëm kombëtar

Konteksti historik dhe kulturor

Romantizmi zhvillohet në një kohë trazirash politike dhe shoqërore: Revolucioni Francez, luftërat napoleonike, revolucioni industrial dhe nacionalizmi në rritje. Këto janë dekada kur bota ndryshon me shpejtësi, ndërsa njerëzit ndiejnë pasiguri, shqetësim dhe nevojë për t'u arratisur drejt diçkaje më të thellë, më të fuqishme dhe më natyrore.

Në këtë atmosferë, artistët i hedhin poshtë normat dhe rregullat akademike, duke kërkuar frymëzim në fantazi, ëndrra, të shkuarën, ekzotikën, por edhe në natyrën madhështore e të egër. Romantizmi shfaqet gjithashtu si një mall për liri – kombëtare, personale dhe shpirtërore.

A E DINI SE

Romantizmi fokusohet te ndjenjat dhe përjetimi personal. Në vend të arsyes dhe rendit, trajton tema si: natyra, liria, rebelimi, trishtimi, madhështia dhe mistikja.

Karakteristikat figurative

Arti në romantizëm është emocional, dramatik dhe shpesh kontrastues. Nuk ekziston një stil unik, por shumë shprehje individuale. Mund të vërejmë:

- ekspresivitet të theksuar në ngjyra dhe forma
- kompozime dinamike
- kontraste të forta drite dhe hije
- skena të mbushura me tension, melankoli ose heroizëm
- preokupim me natyrën, historinë, ekzotikën ose nostalgjinë

Artisti nuk është më një zejtar, por një poet i ndjeshëm që përmes pikturës shpreh trazimet e veta të brendshme.

AKTIVITET

Vizato një peizazh që zgjon një ndjenjë të fortë – si trishtim, frikë, liri apo vetmi. Përdor dritë, linja dhe hapësirë për ta forcuar atmosferën.

Piktura

Në pikturë, romantizmi merr forma të ndryshme në vende të ndryshme.

Në **Francë**, përfaqësuesi më i rëndësishëm është **Eugène Delacroix**, i cili krijon piktura të mbushura me ngjyra, lëvizje dhe pasion. Vepra e tij **"Liria e udhëheq popullin"** ose **"Liria mbi barrikada"** (1830) është simbol i kryengritjes dhe i lirisë kombëtare – një alegori ku liria paraqitet si një grua me flamur që udhëheq popullin në betejë.

Një tjetër artist i rëndësishëm është **Théodore Géricault**, i cili në veprën **"Rrënojat e Meduzës"** (1818–1819) paraqet një skenë nga një tragjedi e vërtetë: të mbijetuar në një anije të braktisur, të dëshpëruar dhe të uritur. Kompozimi është dramatik, dinamik dhe i mbushur me dhimbje njerëzore.

Në Gjermani, romantizmi është më poetik dhe shpirtëror. **Caspar David Friedrich** krijon peizazhe me figura të kthyera drejt pafundësisë – njerëzit duken të vegjël përballë madhështisë së natyrës. Vepra e tij "Udhëtari mbi detin e mjegullës" është emblemë e kësaj qasjeje: vetmi, introspeksion, përjetësi.

Në Angli, William Turner krijon peizazhe që kufizohen me abstraksion. Në veprën Temeraire-i Luftëtar, ai përdor dritën dhe ngjyrën për të shprehur nostalgjinë dhe ndryshimin.



Eugène Delacroix, "Liria e udhëheq popullin" ose "Liria mbi barrikada", 1830, Louvre



Théodore Géricault, Trarët e Meduzës, 1819, Louvre



Caspar David Friedrich, Udhëtari mbi detin me mjegull, ca. 1818



William Turner, Temeraire-i Luftëtar, 1839

Skulptura

Në skulpturë, romantizmi shprehet përmes shprehshmërisë, lëvizjeve dramatike dhe temave që përqendrohen te emocioni njerëzor. Figurat shpesh paraqiten në gjendje vuajtjeje, heroizmi ose ekstaze. Skulptori francez **François Rude** krijon vepra që paraqesin heronjtë e Revolucionit Francez, me një shprehje të fuqishme patosi.



François Rude, "Marseljeza" në Portën Triumfale në Paris, Francë, shek. XIX



Lorenzo Bartolini, E vërteta e zbuluar nga koha, rreth vitit 1830

Lorenzo Bartolini, skulptor italian, krijon figura me formë të butë, por të mbushura me përmbajtje të thellë psikologjike. Vepra e tij "E vërteta e zbuluar nga koha" është një shembull simbolik për karakterin idealist dhe poetik të skulpturës romantike.

Në disa raste, skulptorët frymëzohen nga letërsia – personazhe nga poema, tragjedi ose mitologji ringjallen në mermer ose bronx me një shprehje dramatike.

AKTIVITET

Zgjidh një pikturë romantike dhe shkruaj një reflektim të shkurtër: Çfarë ndjen kur e shikon? Si arrin artisti të krijojë këtë ndikim përmes elementeve vizuale?

Arkitektura

Romantizmi në arkitekturë shprehet më së shpeshti përmes **neogotikës**, si ringjallje e stilit mesjetar, dhe përmes interesimit për stile **ekzotike dhe historike**. Kjo është një periudhë ndërtimi kështjellash, monumentesh dhe ndërtesash të frymëzuara nga e kaluara – por me një fantazi romantike.

Neogotika karakterizohet nga: harqe të mprehta, vitraze, kulla dhe vija vertikale. Edhe pse e frymëzuar nga gotika, neogotika nuk është kopjim, por interpretim, i përshtatur për nevojat moderne dhe shpirtin romantik.

Shembuj të njohur:

- **Kështjella Neuschwanstein në Bavari** – *një vizion përrallor i mbretit Ludwig II*
- **Ndërtesa e Parlamentit Britanik në Londër** – neogotikë e rinovuar nga shekulli XIX
- **Kisha, manastire dhe ura të ndërtuara** me inspirim romantik nga historia kombëtare

A E DINI SE

Caspar David Friedrich shpesh paraqiste figura të vogla njerëzore në peizazhe të mëdha. Kështu ai theksonte madhështinë e natyrës dhe misterin e ekzistencës, që janë ide kryesore në romantizëm.



Kështjella Neuschwanstein, Bavari, ndërtuar nga viti 1869



Romantizëm nacionalist – Monumenti në Niederwald, Gjermani, shek. XIX



Parlamenti Britanik, Londër – neogotik, shek. XIX

Romantizmi Kombëtar

Në disa vende, romantizmi lidhet ngushtë me historinë dhe kulturën kombëtare. Artistët eksplorojnë: folklorin popullor, të kaluarën mesjetare, dhe heronjtë kombëtarë. Në **Skandinavi, Evropën Lindore** dhe **Ballkan** shfaqen vepra që lavdërojnë historinë kombëtare përmes pikturës, arkitekturës dhe letërsisë.

Ky lloj romantizmi përmban edhe një komponentë patriotike, madje nganjëherë edhe politike – arti bëhet shprehje e identitetit kolektiv, jo vetëm e ndjesisë personale.

A E DINI SE

Kështjella Neuschwanstein, ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, ka shërbyer si frymëzim për kështjellën e Bukuroshes së Fjetur në logon e Disney-t. Edhe pse duket mesjetare, ajo është produkt i imagjinatës romantike, jo i një historie të vërtetë.



Hans Gude, "Përshkimi i dasmës në Hardangerfjord", viti 1848.

PYETJE

1. Cilat janë dallimet kryesore mes neoklasicizmit dhe romantizmit?
2. Çfarë përfaqëson gruaja në veprën "Liria udhëheq popullin"?
3. Si paraqitet natyra në pikturat e Caspar David Friedrich?
4. Çfarë është neogotika dhe ku e hasim?
5. Cili është roli i romantizmit kombëtar?

AKTIVITET

Imagjinoni një skenë që shpreh një ndjenjë të fortë: liri, frikë, mall, trishtim ose shpresë. Bëni një skicë ose përshkrim të asaj skene. Çfarë ngjyrash do të përdorni? Çfarë hapësire? A do të ketë figurë njerëzore apo peizazh?

REALIZMI

Arti që paraqet të vërtetën

Në mesin e shekullit XIX, pas viteve të gjata të dominimit të romantizmit dhe prirjes së tij drejt emocioneve, fantazisë dhe miteve heroike, shfaqet një drejtim i ri që ndryshon rrjedhën e artit – **realizmi**. Ky është lëvizja e parë e madhe që e vendos **realitetin e përditshëm** si temë qendrore të shprehjes artistike. Realistët nuk duan më të ëndërrojnë, por të shohin, të vëzhgojnë dhe të paraqesin saktësisht se si jeton njeriu i zakonshëm.

TERMA KYÇ:

realizëm, Courbet, Millet, Daumier, fotografi

Konteksti historik dhe shoqëror

Realizmi shfaqet në Francë gjatë viteve 1840, në një kohë të ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe politike: revolucioni industrial, zhvillimi i kapitalizmit, urbanizimi dhe rritja e pabarazisë klasore. Revolucioni francez i vitit 1848 ndikoi më tej mbi artistët, të cilët ndien nevojën të dëshmonin të vërtetën e kohës së tyre.

Paralelisht, zhvillohen edhe qasje të reja shkencore – pozitivizmi dhe empirizmi – të cilat bazohen në vëzhgim të drejtpërdrejtë dhe analizë. Në këtë mjedis, arti kthehet drejt botës reale, drejt asaj që është konkrete, e dukshme dhe me rëndësi shoqërore.

A E DINI SE

Realizmi shfaqet si një reagim ndaj romantizmit dhe idealizimit. Artistët filluan të paraqesin njerëzit e përditshëm dhe skena nga jeta reale, pa zbukurime dhe pa mitologji.

Karakteristikat kryesore të realizmit

Realizmi synon **paraqitjen objektive** të realitetit, pa idealizim, pa mitologji dhe pa dramatizim. Në vend të heronjve antikë, skenave fetare ose fantazive, realistët pikturojnë:

- Fshatarë, punëtorë, zejtarë, shitës rruge
- Skena të zakonshme nga jeta e përditshme
- Padrejtësi shoqërore dhe konflikte shoqërore
- Hapësira reale dhe peizazhe, pa dekorativitet

Teknika: përdoren konture të sakta, ngjyra të moderuara dhe kompozim i qartë. Vëmendja nuk është te bukuria, por te e vërteta. Realizmi, përveçse fokusohet te realiteti i dukshëm, hap edhe temën e kritikës sociale. Artistët shpesh paraqesin kushtet e jetës së klasës punëtore dhe të varfërve, me synim të nxisin vetëdijen publike dhe të shkaktojnë ndryshime. Ata shmangin paraqitjet e idealizuara dhe përpiqen të shfaqin figurat dhe situatat në të vërtetën e tyre të ashpër, shpesh të pakëndshme. Ky qasje e transformon rolin e artit nga një mjet thjesht për kënaqësi estetike në një mjet për dialog dhe reflektim shoqëror.

AKTIVITET

Pikturo një skenë nga përditshmëria: punëtorë, treg, rrugë ose atmosferë familjare. Ki kujdes për përpjesëtimet reale, ngjyrat natyrore dhe gjestet e zakonshme, jetësore.

Teknika dhe qasja artistike

Realistët përdorin **skicën e detajuar nga vëzhgimi si** bazë të pikturës. Në vend të përpjesëtimeve të idealizuara ose kompozimeve klasike, ata shfrytëzojnë pozat natyrore, shpërndarje asimetrike dhe ndriçim real.

Gustave Courbet, për shembull, shpesh përdor **shtresa të trasha boje (*impasto*)** për ta përcjellë botën materiale – peshën e rrobave, sipërfaqen e ashpër të tokës apo teksturën e lëkurës. Paleta e ngjyrave është zakonisht e zbehtë: tonet e tokës, qielli gri, muret e ndotura – gjithçka për të ruajtur autenticitetin.

Jean-François Millet, nga ana tjetër, **punon me dritë të butë dhe linja harmonike** për t'i dhënë ngrohtësi jetës fshatare. Edhe kur tema është e rëndë, si varfëria e korrësve, ai përdor një poezi të hollë që e pasuron realizmin me humanitet.

Honoré Daumier, si vizatues i shkëlqyer, shpesh përdor **penelata të shpejta dhe lëvizje spontane**, me qëllim të kapë gjallërinë e qytetit, ngathësinë e trupave ose monotoninë e jetës së përditshme.

Piktura

Përfaqësuesi më i madh dhe më me ndikim i realizmit është **Gustave Courbet**. Ai me vetëdije i kundërvihet artit akademik dhe romantizmit, duke kërkuar një art që të jetë në shërbim të së vërtetës. Në pikturën e tij **"Varrimi në Ornans" (1849)**, Courbet paraqet një varrim fshati në qytetin e tij të lindjes – pa idealizim, pa simbole, por me figura të njerëzve të vërtetë, në hapësirë të vërtetë. Vepra shkaktoi tronditje tek publiku i salloneve pasi nuk paraqiste asgjë "të lartësuar", por një skenë të zakonshme në përmasa monumentale.

A E DINI SE

Gustave Courbet, një nga realistët më të rëndësishëm, ka deklaruar: "Nuk mund të pikturoj një engjëll, sepse kurrë nuk kam parë një të tillë". Ai kërkëngulte të paraqiste vetëm atë që ishte i prekshëm dhe real.

AKTIVITET

Zgjidh një pikturë realiste dhe përshkruaj: cilët elementë e bëjnë autentike? Si kompozimi, ngjyrat dhe tema dallojnë nga veprat romantike?



Gustave Courbet, "Varrimi në Ornans", 1849 (Muzeu Orsay, Paris)

Në pikturën **"Thyesit e gurëve" (1849)**, Gustave Courbet paraqet dy fshatarë teksa kryejnë një punë të rëndë fizike – duke thyer gurë – si metaforë e mundit dhe mjerimit të shtresave të ulëta. Courbet ka deklaruar: "Nuk mund të pikturoj engjëj, sepse kurrë s'kam parë ndonjë".

Një tjetër artist i rëndësishëm është **Jean-François Millet**, i cili përqendrohet në **jetën e fshatarëve**. Vepra e tij "Mbjellësi" (1850) paraqet një burrë në lëvizje, në aktin e mbjelljes – simbol i ciklit natyror dhe i dinjitetit të punës. Në **"Korrësët"** (1857), Millet paraqet tri gra në fushë, në një moment pushimi, por që mbetet një skenë e fuqishme për realitetin punues të gruas.



Gustave Courbet, "Thyesit e gurëve" (1849) – u shkatërrua më 1945



Jean-François Millet, "Mbjellësi" (1850), Musée d'Orsay



Jean-François Millet, "Korrësët" (1857), Louvre

Ndërkohë, **Honoré Daumier** është i njohur për **kritikën sociale** dhe për vizatimet apo pikturat me humor dhe satirë. Ai pikturon gjykata, trena, tregje, njerëz që flenë në transport publik. Në veprën e tij "Vagoni i klasit të tretë" (1862), shfaqen pasagjerë të lodhur në një hapësirë të ngushtë – dëshmi e jetës së vështirë të njerëzve të zakonshëm.



Honoré Daumier, "Vagoni i klasit të tretë" (rreth 1862), Galeria Kombëtare, Kanada

Skulptura

Edhe pse realizmi shprehet më fuqishëm në pikturë, ekzistojnë edhe shembuj të rëndësishëm në skulpturë. **Jean-Baptiste Carpeaux** dhe **Jules Dalou** krijojnë figura që paraqesin trupin dhe emocionin njerëzor pa idealizim. Trupi nuk është i përsosur, por real – me rrudha, lodhje dhe gravitet. Veprat e tyre shpesh paraqesin punëtorë, gra, fëmijë dhe skena nga përditshmëria.

Skulptura realiste dallohet për lëvizje, shprehshmëri dhe njerëzillëk të prekshëm. Ajo e afron veprën artistike me shikuesin përmes njohjes dhe empatisë.

Arkitektura dhe urbanizmi

Edhe pse arkitektura nuk është forma qendrore e artit në realizëm, është e rëndësishme të përmendet ndikimi i revolucionit industrial. Në shekullin XIX fillon **ndërtimi masiv i banesave për klasën punëtore, fabrikave, stacioneve të trenit dhe zonave të reja urbane**. Artistët shpesh pikturojnë pikërisht ato hapësira – pa zbukurime, me vëmendje ndaj papastërtisë, ngushtësisë dhe atmosferës industriale.

Peizazhi i ri urban – me hekurudha, tym dhe rrëmujë – bëhet një nga motivet kyçe të artit realist.

AKTIVITET

Vëzhgo dhe vizato një skenë nga jeta jote e përditshme ose nga rrethina jote, duke u përpjekur të paraqesësh detaje realiste dhe emocione të vërteta.

Realizmi dhe fotografia

Shfaqja e **fotografisë në vitin 1839** pati ndikim të madh në realizëm. Artistët filluan të mendojnë si mund të jetë një pikturë e saktë, por edhe e shprehur në mënyrë artistike. Disa piktorë madje përdornin fotografi si model, ndërsa fotografitë e njerëzve të zakonshëm, rrugëve të qytetit dhe ngjarjeve shoqërore mbështesnin të njëjtin frymë objektiviteti dhe dëshmie.

Fotografë si **Nadar** apo **Caroline Vuillard** dokumentojnë fytyrat dhe hapësirat e kohës së tyre me të njëjtën ide si piktorët: të shfaqin realitetin, pa idealizim. Kjo hap rrugën për artin dokumentar dhe gjuhën moderne të gazetarisë vizuale.

A E DINI SE

Realizmi u zhvillua si reagim ndaj romantizmit, me qëllim që të shfaqte jetën e vërtetë dhe problemet shoqërore, në vend të skenave të idealizuara dhe fantastike?



Nadar – Portret i një shkrimtari apo artisti, fotografi e hershme nga shekulli XIX

Reagime dhe kuptim

Realizmi nuk u pranua menjëherë. Veprat e Courbet dhe të të tjerëve shpesh u refuzuan nga salonet zyrtare dhe shkaktuan neveri tek publiku borgjez. Pikturat me fshatarë dhe punëtorë në kanavacë të mëdha konsideroheshin si "të papërshtatshme". Megjithatë, me kalimin e kohës, realizmi u bë themel për zhvillimin e lëvizjeve të mëvonshme – **nga natyralizmi**, tek **impresionizmi**, e deri te realizmi social i shekullit XX.

Artisti, pra, nuk është më shërbëtor i të pasurve apo i kishës, por **vëzhgues i kohës së vet, zëdhënës i së vërtetës dhe ndërgjegje e shoqërisë**



Alekséi Savrasov – "Kthimi i sorrave", 1871

A E DINI SE

Gustave Courbet, duke refuzuar të idealizonte botën, krijoi "pavijonin e tij të pavarur" jashtë salonit zyrtar në Paris dhe e quajti "Pavijoni i Realizmit". Ai ishte ndër artistët e parë që haptazi refuzoi sistemin akademik të artit dhe mbrojti të drejtën për shprehje të lirë.

AKTIVITET

Bëni një skicë ose një kompozim të shkurtër në frymën e realizmit: paraqitni një skenë nga përditshmëria – për shembull: treg, rrugë, vend pune, pasagjerë në autobus, arë fshati ose një moment nga jeta familjare. Përdorni ngjyra të zbehta dhe theksoni vërtetësinë e asaj që paraqitni.

PYETJE

1. Cili është qëllimi i artit realist?
2. Cilat tema trajton realizmi?
3. Cilët janë tre artistët më të rëndësishëm të realizmit dhe për çfarë janë të njohur?
4. Cila është dallimi ndërmjet realizmit dhe romantizmit?
5. Si ndikoi revolucioni industrial në pikturat realiste?
6. Çfarë roli luajti fotografia në mbështetjen e realizmit?

Arti në periudhën postbizantine në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Konteksti historik dhe rëndësia

Periudha post-bizantine fillon pas rënies së Konstandinopojës në vitin 1453 dhe zgjat deri në fund të shekullit XIX, kur në territorin e Maqedonisë fillojnë proceset e zgjimit kombëtar. Edhe pse Perandoria Bizantine kishte pushuar së ekzistuari politikisht, trashëgimia e saj artistike dhe shpirtërore vazhdoi të jetojë. Në territorin e Republikës së sotme të Maqedonisë së Veriut, kjo traditë u ruajt përmes: arkitekturës kishtare, ikonografisë, pikturës së afreskeve, gdhendjes në dru dhe krijimtarisë popullore, e cila zuri gjithnjë e më shumë vend në jetën e përditshme të njerëzve.

Pavarësisht kushteve të vështira shoqërore nën sundimin osman, krijimtaria artistike nuk ndaloi. Përkundrazi, arti u bë një formë e heshtur rezistence, një stabilitet shpirtëror dhe dëshmi vizuale e qëndrueshmërisë së identitetit kombëtar. Në këtë periudhë janë krijuar disa nga ikonostaset, afresket, kostumet popullore dhe qëndisjet më të rëndësishme, që përfaqësojnë kulmin e traditës pamore maqedonase nga perspektiva e popullit.

Veshja popullore dhe qëndisja – gjuha e simboleve

Një nga shprehjet më përfaqësuese dhe më të pasura të artit post-bizantin është veshja popullore maqedonase. Ajo përfaqëson një bashkim mes funksionit praktik dhe mesazhit simbolik. Çdo veshje përmban elemente të identitetit lokal, funksion ritual dhe krijimtari artistike. Përmes saj, gratë – zakonisht krijuese anonime – ruanin dhe përcillnin kujtesën kolektive të komunitetit.

A E DINI SE

Pas rënies së Bizantit, arti në Maqedoni vazhdoi të jetonte përmes traditave të pikturës së afreskeve, ikonografisë, gdhendjes në dru dhe qëndisjes, veçanërisht në manastire dhe kisha fshatare.

TERMA KYÇ:

post-bizantin, qëndisje, veshje popullore, ikonë, zograf, afresk, ikonostas, gdhendje në dru, arabeskë

AKTIVITET

Vizato një motiv gjeometrik të frymëzuar nga qëndisjet popullore maqedonase. Kushto vëmendje simetrisë dhe përsëritjes së formave, duke përdorur ngjyra tradicionale si: e kuqe, e zezë dhe e bardhë.



Gratë e Sllimevës në veshje popullore, viti 1913

Në përpunimin e veshjes popullore, qëndisja zë vend të veçantë. Ajo aplikohet në pjesë të ndryshme të veshjes: në kraharor, mëngë, brez, madje edhe në të brendshme – jo vetëm si zbukurim, por edhe si mbrojtje kundër "syrit të keq". Kompozimet janë zakonisht simetrike dhe ritmike, me motive gjeometrike dhe bimore, dhe ngjyrat dominuese janë: e kuqe, e zezë, e artë

Simbolet e qëndisura me dorë shpesh përfaqësojnë: pjellorinë (romb), mbrojtje (kryqi), diellin si burim jete, ose pema e jetës si simbol i ciklit të përjetshëm.

Veshjet popullore nga rajone të ndryshme tregojnë një shumëllojshmëri të jashtëzakonshme: Veshja e Galicës dallohet për zbukurimet metalike, dekorimin e pasur dhe simbolikën e brezave të nusërisë. Veshja e Mariovës shquhet për thjeshtësi dhe qartësi grafike të fuqishme. Në rajonin e Manastirit (Bitola), gjenden motive florale me kompozim të orientuar. Në rajonin e Gjevgjelisë, dominojnë ornamente me stil të zhvilluar dhe ndikim oriental.

Qëndisja nuk përdoret vetëm në veshje, por edhe në objekte shtëpiake si çarçafë, jastëkë dhe peshqirë. Ajo përfaqëson përpjekjen e përditshme për të ruajtur bukurinë dhe vazhdimësinë kulturore, edhe në sendet më të thjeshta.



Qendisje nga Rajoni i Tetovës

AKTIVITET

Hulumto një ornament nga një qëndisje popullore maqedonase ose nga një ikonë, dhe krijo një vizatim ose skemë me elemente të ngjashme. Shpjego çfarë simbolizon.

Arti i ikonografisë

Ikonografia postbizantine e vazhdon traditën e krijimit të figurave të shenjtorëve sipas kanoneve të përcaktuara, por njëkohësisht shfaq variacione stilistike që pasqyrojnë ndikime lokale. Ikona mbetet një urë shpirtërore midis njeriut dhe hyjnores, ndërsa mjeshtëria e saj përcillet nga brezi në brez në familje zografësh.

Në shekullin XIX, figurë qendrore e ikonografisë maqedonase është Diço Zografi, i lindur në fshatin Tresonçë. Vepra e tij përfshin më shumë se 2 000 ikona, të përhapura në mbarë Ballkanin. Ikonat e Diços dallohen për kompozim të qartë, shprehje të butë të fytyrave, paletë të pasur ngjyrash dhe sfond të artë që simbolizon dritën qiellore. Veçanërisht të rëndësishme janë ikonat e kishave në Lazaropole, në rajonin e Kërçovës dhe Krivopallankës, ku mund të dallohet stili i tij personal – vijë e saktë, simetri racionale dhe ngrohtësi emocionale.

Ikonat nuk krijohen vetëm për përdorim kishtar. Në këtë periudhë lind edhe tradita e ikonostaseve shtëpiake – kënde të vogla lutjeje nëpër shtëpi, ku ikonat vendosen në një vend të veçantë dhe trajtohen si pjesë e spiritualitetit familjar.



Uspenia e Hyjlindëses – Diço Zografi – 1866

Afresket si dëshmi e shpirtërores

Afresket vazhdojnë të zhvillohen si një element i rëndësishëm në hapësirat e brendshme të kishave dhe manastireve. Piktorët mbulojnë muret me skena nga Shkrimi i Shenjtë, jeta e shenjtorëve dhe ikona festive. Edhe pse kushtet për punë shpesh ishin të kufizuara, afresket vazhdojnë të dëshmojnë mjeshtëri teknike dhe imagjinatë artistike.

Afresket e kishës "Shën Gjergji" në Kurbinovë paraqesin figura të holla me proporcione të zgjatura, të veshura me tonalitet blu dhe të artë. Në manastirin Treskavec afër Prilepit, muret janë të mbuluara me skena të fuqishme rrëfimtare, që e udhëheqin besimtarin nëpër dramën e vuajtjes dhe shpëtimit. Matka, Nerezia dhe Manastiri janë qendra të tjera ku afresket marrin formë dhe forcë që tejkalon kohën.

A E DINI SE

Veshi tradicional dhe qëndisjet popullore maqedonase nuk janë vetëm zbukurim, por mbajnë simbolikë, shenja mbrojtëse dhe rrëfejnë për përkatësi, familje, dashuri dhe besim.



Ikoostasi i kishës "Shën Gjergji" – Kurbinovë, 1191

Në ikonografinë e këtij periudhi shfaqen edhe skena nga jeta popullore, përfshirë motive të bujqësisë dhe blegtorisë, çka përfaqëson afrim të së shenjtës me përditshmërinë e njeriut.

Arkitektura

Arkitektura krishtere

Ndërtimi i krishterë në këtë periudhë shprehet kryesisht përmes kishave të vogla dhe kapelave, të cilat shpesh ngrihen me mjete modeste, por me simbolikë dhe shpirtërim të fortë. Planet janë të thjeshta – zakonisht kisha njënefëshe me bazë drejtkëndore dhe harqe gjysmërrethore. Ndërtesat ngrihen prej guri, me çati druri ose tjegullash, ndërsa fasadat nuk kanë dekorime të pasura.

Në brendësi, afresket vazhdojnë të krijohen në frymën e traditës bizantine, por me forma të thjeshtuara dhe më rrallë si programe të plota. Ikonostasi bëhet element më i rëndësishëm i hapësirës, shpesh i punuar në dru të gdhendur me elemente dekorative të rafinuara.

Shembull për këtë lloj arkitekture janë kisha **"Shën Athanasi"** në fshatin Leshok, ose **"Shën Shpëtimtari"** në Shkup, të cilat dëshmojnë për vazhdimësinë e jetës shpirtërore dhe arkitekturore edhe pas periudhës bizantine



Kisha "Shën Shpëtimtari" – Shkup – shek. XVI

Arkitektura Islame

Me sundimin osman, në qytete fillojnë të shfaqen lloje të reja objektesh: xhamitë, hamamet (banjat publike), bezistenët (pazaret e mbyllura), kullat, konakët dhe karvan-sarajet. Xhamitë, si ndërtesat më të shpeshta, kanë çati me kupola dhe minare të larta. Përdoren tulla, gurë dhe llaç, ndërsa dekorimet kufizohen në qeramikë, kaligrafi dhe forma gjeometrike.

Një nga objektet më të njohura është Xhamia e Sulltan Muratit në Shkup, nga shekulli XV, e cila ka plan qendror dhe kupolë, me simetri të theksuar dhe dekorim të thjeshtë, por elegant. Hamamet, si Hamami i Daut Pashës ose Çifte Hamami, që sot shfrytëzohen si galeri, dëshmojnë për nivelin e lartë të ndërtimit dhe kujdesin ndaj shëndetit publik dhe kulturës në qendrat osmane të asaj kohe.



Interieri i xhamisë së Isa Beut – Shkup – 1475

Arkitektura Popullore

Arkitektura popullore në Maqedoni është zhvilluar kryesisht në fshatra dhe në qytetet më të vogla, ku shtëpia u bë simbol i identitetit dhe i mjeshtërisë artizanale. Tipike është shtëpia maqedonase me dy kate – kati i poshtëm prej guri, ndërsa i sipërmi prej druri dhe tulle. Karakteristike janë: çardakët e gjerë (ballkonet), tavanet e gdhendura prej druri, fasadat e bardha, oxhakët. Çatitë mbulohen me pllaka guri ose tjegulla.

Këto shtëpi mund të shihen në Krushevë, Kratovë, Ohër dhe Veles, dhe pamja e tyre përshtatet si me terrenin, ashtu edhe me kushtet klimatike. Ato njëkohësisht shfaqin një estetikë të zhvilluar dhe prakticitet.

AKTIVITET

Zgjidh një afresk, ikonë ose ornament nga një tempull maqedonas të periudhës postbizantine dhe përshkruaj cilët elemente janë tradicionale, e cilët tregojnë veçori lokale.

Gdhendje në dru dhe ikonostase

Ikonostasi bëhet vepra qendrore artistike në brendësinë e kishave. Ai jo vetëm që e ndan altarin nga naosi, por gjithashtu e rrëfen historinë e shenjtë përmes një kompozimi ikonash dhe ornamenteve të gdhendura. Gdhendja e drurit përjeton lulëzim dhe konsiderohet kulm i mjeshtërisë dhe realizimit artistik.

Në „Shën Shpëtimtar" në Shkup gjendet ikonostasi që renditet ndër gdhendjet më të ndërlikuara në dru në Ballkan. Gdhendja e thellë, skemat dinamike me motive floreale, figurat e kafshëve dhe skenat nga Dhjata e Vjetër dhe e Re janë të ndërthurura në një gjuhë vizuale të besimit, bukurisë dhe mjeshtërisë.



Ikonostasi në „Shën Shpëtimtar" – Shkup



Gdhendje druri në „Shën Shpëtimtar" – Shkup

Arabeska dhe estetika urbane

Në mjediset urbane nën sundimin osman, arti pasurohet me ndikime orientale. Arabeska – një sistem dekorativ me vija të ndërthurura, forma gjeometrike dhe motive bimore – shfaqet në arkitekturë, qera-

mikë, tekstile dhe gdhendje. Kjo estetikë, ndonëse e ndryshme nga ajo e krishterë, sjell një përvojë të re vizuale dhe ndikon mbi fjalorin ornamental të zejtarëve vendas. Në çarshitë e Shkupit, Manastirit dhe Tetovës, zbukurimet në dyqane, burime uji, minare dhe shtëpi mbartin ndikim të qartë arabesk, shpesh të kombinuar me forma lokale.

Krijimtaria popullore dhe arti i përditshëm

Arti nuk përfundon në tempuj. Në jetën e përditshme, njerëzit vazhdojnë të krijojnë dhe të zbatojnë artin dekorativ në objektet e përdorimit të përditshëm. Enët qeramike zbukurohen me gdhendje dhe motive të gdhendura. Stolitë metalike marrin forma simbolike. Instrumentet muzikore gdhenden me ornamente. Mobiliet shtëpiake kanë gdhendje dhe qëndisma që kanë rol estetik dhe frymëzim shpirtëror.

A E DINI SE

Veshjet e nuseve nga Mariova ndonjëherë peshonin deri në dhjetë kilogramë, për shkak të zbukurimeve të shumta, qëndismave dhe elementeve metalike.

AKTIVITET

Zgjidh një veshje popullore maqedonase nga një rajon dhe studio qëndismat e saj. Përshkruaj kuptimin e motiveve më të përdorura dhe krijo një skicë me simbolin që të pëlqen më shumë. Hulumto nëse ky simbol ka funksion mbrojtës, ritual apo zbukurues.

PYETJE

1. Cilat janë karakteristikat kryesore të artit në periudhën postbizantine?
2. Cilat janë ciklet më të rëndësishme të afreskeve në territorin tonë nga kjo periudhë?
3. Çfarë roli kishin zografët në art pas rënies së Bizantit?
4. Çfarë përfaqëson ikonografia dhe si u zhvillua ajo në periudhën postbizantine?
5. Cilët janë disa nga mjeshtrit më të njohur dhe veprat e tyre nga kjo periudhë?
6. Si ndryshojnë arkitektura dhe dekorimi i kishave pas shekullit XV?



Ikona e Hyjlindëses Pantokratora, e vitit 1844, është një vepër e piktorit të njohur maqedonas Dico Zografi

Tema 2

Elementët pamorë

Ashtu siç për t'u shprehur me fjalë duhet të njohësh shkronjat dhe fjalët, dhe për të krijuar muzikë duhet të kuptosh tingujt – për t'u shprehur përmes artit pamor, së pari duhet të njohësh elementët pamorë. Këto janë pjesët themelore ndërtuese nga të cilat krijohet çdo vepër artistike.

Linja, ngjyra, tonaliteti, forma, tekstura, drejtimi, madhësia, vëllimi dhe hapësira janë elementë pamorë që çdo artist i përdor – vetëdijshëm ose pavetëdijshëm – për të përcjellë një ndjenjë, ide apo tregim të caktuar. Ata janë pjesë e botës së përditshme që na rrethon, por përmes artit fitojnë një kuptim të veçantë. Mënyra se si i sheh, i kombinon dhe i përdor këta elementë përbën gjuhën tënde personale vizuale.

Në këtë temë do të mësosh se çfarë përfaqëson secili prej elementëve pamorë dhe si funksionon në një vepër arti. Do të shohësh se si linja mund të jetë e butë apo e mprehtë, si ngjyra krijon atmosferë, si tonaliteti sjell dritë dhe hije, dhe si tekstura i jep ndjeshmëri veprës. Do të eksplorosh gjithashtu edhe drejtimin që udhëheq shikimin nëpër vepër, madhësinë që krijon perspektivë, format që ndërtojnë objektet dhe hapësirën që sjell thellësi.

Me ushtrime dhe eksplorime të këtyre elementeve, do të fillosh t'i njohësh jo vetëm në veprat e artit, por edhe në gjithçka që të rrethon. Do të mësosh si t'i përdorësh ato për të shprehur idetë e tua dhe për të krijuar tregime vizuale personale. Përmes tyre, krijimtaria jote do të bëhet më e qartë, më bindëse dhe më e pasur.

Qëllimet e temës:


- Të kuptosh se çfarë janë elementët pamorë dhe pse ata janë baza e çdo vepre artistike.
- Të jesh në gjendje të njohësh dhe të dallosh elementët e ndryshëm në shprehjet vizuale artistike dhe ato të përditshme.
- Të mësosh si t'i përdorësh me vetëdije elementët pamorë në krijimtarinë tënde.
- Të zhvillosh gjuhën tënde pamore, përmes kombinimit dhe eksperimentimit me elementë të ndryshëm.

VIJA

Vija është një element themelor pamor dhe hapi i parë në komunikimin vizual. Ajo përfaqëson gjurmën e një lëvizjeje – nga një pikë që fillon të lëvizë në një sipërfaqe: në letër, mur, gur apo ekran dixhital. Edhe pse duket e thjeshtë, linja ka një rol të madh në art: ajo mund të përcaktojë formën, të drejtojë syrin përmes kompozimit, të shprehë energji, ritëm, emocione apo edhe të tregojë një histori.

TERMA KYÇ:


linjë, linjë e lakuar, linjë e drejtë, fuqi vizuale, linjë konture, linjë teksturore



Vija të vizatuara me shkumës, qymyr, laps dhe penel

A E DINI SE

Linja më e vjetër e njohur në art është më shumë se 70.000 vjet e vjetër dhe është gdhendur në një shkëmb në Afrikën e Jugut.




Vijat i ndajmë në të lakuara dhe të drejta, dhe ato mund të jenë të trasha ose të holla, të shkurtra ose të gjata. Çdo lloj vije ka fuqinë e vet vizuale. Vijat e mprehta dhe të drejta mund të duken të rrepta dhe të forta, ndërsa vijat e lakuara japin përshtypje të butësisë dhe natyrshmërisë.


AKTIVITET

Vizato dy figura, një duke përdorur vetëm linja të lakuara, tjetrën vetëm me linja të drejta. Përshkruaj ndryshimin në përshtypje – si ndryshon ndjenja që të japin?
Krijo një vizatim abstrakt me një linjë të vetme, që tregon një histori – për shembull: trishtim, gëzim, lëvizje, apo qetësi.

Në kultura të ndryshme dhe periudha historike, linja ka pasur përdorime dhe kuptime të ndryshme. Në kaligrafinë lindore, një linjë e vetme mund të përçojë shpirtin, karakterin dhe emocionin e autorit. Në artin modern, artistë si Pablo Picasso, Jackson Pollock dhe Paul Klee e përdorin linjën si mjet kryesor për eksperimentim dhe shprehje personale.



Pablo Picasso – Le Chameneau: ilustrim me linja të skicuara në një stil të thjeshtë por emocional



Leonardo da Vinci – Njeriu i Vitruvit (1492): studim me linja për proporcionet dhe simetrinë e trupit të njeriut

AKTIVITET


Hulumto tre vepra nga: Pablo Picasso, Jackson Pollock, Paul Klee, dhe shpjego se si e përdorin linjën si element qendror pamor.

A E DINI SE

Në arkitekturën moderne, linja ka rol thelbësor për të krijuar ritëm, strukturë dhe dinamikë në formën e ndërtesave.

Linja si element themelor vizual

Linja është baza e gjuhës pamore. Ajo është element ndërtues që krijon: forma, konture, struktura, dhe kompozime. Në çdo vizatim, dizajn apo sipërfaqe pikture, linja është forma e parë që shfaqet. Ajo mund të jetë: konstruktive (për ndërtim formash), dekorative, funksionale ose thjesht estetike.



Shkallë moderne spirale – një gardh i bardhë dhe shkallë prej druri me ton të ngrohtë, të fotografuara nga lart, krijojnë ritëm arkitektonik dinamik dhe elegancë vizuale.

AKTIVITET

Bëj një skicë të një ambienti të brendshëm (dhomë) duke përdorur vetëm linja – pa hije apo ton. Fokusohu në ndërtimin e formës përmes konturave dhe drejtimit të linjave.

A E DINI SE

Në arkitekturën moderne, linja luan një rol kyç në krijimin e ritmit dhe dinamikës brenda ndërtimit. Mjafton një vijë për të përcaktuar strukturën dhe ndjesinë e hapësirës.

Llojet e linjës: Konturale dhe Teksturore

Në shprehjen figurative dallojmë disa lloje vijash sipas funksionit dhe karakterit të tyre vizual. Më të përhapurat janë vija konturore dhe vija teksturore.

Vija konturore mund të jetë e mbyllur ose e hapur dhe shërben për të treguar kufirin e jashtëm të një forme ose objekti. Ajo e përcakton formën dhe e dallon nga format e tjera ose nga hapësira në të cilën është vendosur. Është e pranishme në skica, vizatime teknike dhe paraqitje realiste.

Vija teksturore paraqet karakterin e sipërfaqes së një materiali – teksturën e tij. Përmes saj krijohet përshtypja nëse sipërfaqja është e lëmuar apo e ashpër, e butë apo e mprehtë.

Ajo mund të paraqesë lëvoren e drurit, strukturën e gurit, pëlhurën etj. Në varësi të materialit që paraqitet, vija teksturore mund të jetë e trashë, e hollë, e shkurtër, e gjatë, e drejtë, e lakuar dhe e aplikuar me dendësi të ndryshme



Pablo Picasso – "Gruaja në kolltuk" (Femme dans un fauteuil, 1949): një portret abstrakt, ndërtuar me linja ekspresive dhe forma gjeometrike, ku linja bart gjithë shprehjen dhe karakterin

AKTIVITET

Vizato një frut (p.sh. ananasi) vetëm me vijë konture. Pastaj vizatoje të njëjtin me vija teksturore që shprehin lëvoren e tij.

Karakteri dhe shprehshmëria e vijës

Karakteri i vijës tregon edhe cilësinë themelore figurative të vetë vijës në shprehjen artistike. Përmes karakterit të vijës, artisti shpreh ndjeshmërinë e tij, perceptimin dhe ekspresionin që bart brenda vetes si shkrim i veçantë dhe gjendje shpirtërore.

Vija, sipas karakterit të saj, mund të jetë: **e gjatë, e shkurtër, e hollë, e trashë, e lakuar dhe e drejtë.**

Se çfarë karakteri do të ketë vija, përveç ndjeshmërisë së autorit, varet edhe nga: **tema dhe subjekti** që përpunohen, **materiali dhe vegla** që përdoren (qymyr, laps, bojë, pendë, pastel, furçë, dru), si dhe nga **sipërfaqja** mbi të cilën punohet (e lëmuar, e ashpër, gjysmë e lëmuar).

Secili prej këtyre faktorëve ndikon në pamjen dhe energjinë që vija bart. Për shembull, një vijë e bërë me furçë mbi letër të ashpër do të duket krejt ndryshe nga një vijë e bërë me laps teknik mbi sipërfaqe të lëmuar.



Kaligrafi kineze – urim për Vitin e Ri të gjarprit (2025), e realizuar në stil tradicional kaligrafik

A E DINI SE

Në vizatimin teknik, vija konture është baza për të gjitha skicat inxhinierike.
Në kaligrafinë kineze, çdo vijë ka kuptim simbolik dhe konsiderohet si vazhdim i shpirtit të artistit.



Vincent van Gogh – "Nata me Yje" (1889): peizazh me vija të lakuara dhe qiell dinamik



Arti në shpella – petroglife paleolitike me skena gjuetie, kafshë të egra dhe njerëz, të gdhendura në gur si pjesë e mënyrës së lashtë të jetesës dhe komunikimit

AKTIVITET

Bëj një skicë të një ambienti të brendshëm (dhomë) duke përdorur vetëm vija – pa hije ose ton.



Hokusai – "Vali i Madh pranë Kanagavasë" (1831): gravurë japoneze nga periudha Edo, me kompozim dinamik dhe vija të theksuara që paraqesin një valë gjigante përpara malit Fuji – peizazh me vija të lakuara dhe qiell dinamik

Vija është një nga format më të vjetra dhe më universale të shprehjes vizuale. Që nga vizatimet prehistorike në shpella e deri te ilustrimet digjitale bashkëkohore, vija mbetet një gjuhë e përhershme përmes së cilës njeriu komunikon ide, ndjenja dhe lëvizje. Ajo mund të jetë e qartë dhe e përcaktuar, ose e lirë dhe ekspresive. Me përdorimin e duhur të vijës, artisti mund të paraqesë hapësirë tredimensionale, të sjellë dramatikë ose të sugjerojë ritëm.

A E DINI SE

Xhekson Pollock nuk i përdorte penelat në mënyrë tradicionale – ai hidhte bojë dhe krijonte vija përmes lëvizjes së gjithë trupit!

PYETJE

1. Çfarë paraqet linja në artin pamor?
2. Çfarë lloje vijash njeh?
3. Çfarë ndjenjash mund të përcjellë secili lloj?
4. Shpjego dallimin mes vijës konturore dhe vijës teksturore.
5. Si e përdorin artistët vijën për të paraqitur lëvizjen apo teksturën?
6. Si mund ti të përdorësh lloje të ndryshme vijash për të shprehur ndjenja të kundërta?

NGJYRA DHE BAZAT E NGJYRËS

Ngjyra është një nga elementet më të fuqishme pamore që artistët i përdorin për të shkaktuar emocione, për të krijuar atmosferë ose për të theksuar formën. Ajo nuk është zgjedhje e rastësishme – përkundrazi, mbart domethënie, ndikon në kompozim dhe ka aftësinë të komunikojë me shikuesin. Që nga prehistoria e deri më sot, ngjyra ka pasur një rol qendror në artin vizual. Mjafton të shikojmë vizatimet nëpër shpella parahistorike apo freskot në katedralet e Rilindjes, për të kuptuar sa shumë njeriu i është përkushtuar ngjyrës.

TERMA KYÇ:

Ngjyrë, spektri, rrethi i ngjyrave, ngjyrat primare, ngjyrat sekondare, ngjyrat terciare, nuance, ngopje (intensitet i ngjyrës)



Vizatim në shpellë, rreth vitit 15 000 p.e.s.

AKTIVITET

Hulumto vepra artistike nga periudha të ndryshme historike dhe krahaso mënyrën se si është përdorur ngjyra.

A E DINI SE

Ngjyra, përveç aspektit estetik, shpesh ka pasur funksion simbolik, shpirtëror ose shoqëror në shumë kultura?



Paletë abstrakte

Bota materiale e shohim të ngjyrosur vetëm falë pranisë së dritës – natyrore ose artificiale. Pa dritë nuk ka ngjyrë. Kur drita e bardhë thyhet përmes një prizme, ajo shpërbëhet në ngjyrat e spektrit: të kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbër, blu dhe vjollcë. Këtë dukuri e quajmë **spektri i ngjyrave**, të cilin e shohim çdo ditë në ylber.

Në art dhe dizajn përdoret një mjet që quhet **rrethi i ngjyrave** – paraqitje skematike e marrëdhënieve mes ngjyrave. Zakonisht përbëhet nga 12 ngjyra: **tre primare** (e kuqe, e verdhë dhe blu), **tre sekondare** (portokalli, e gjelbër dhe vjollcë) dhe gjashtë **ndërngjyra** që dalin nga përzierja e një ngjyre primare me një sekondare (p.sh. e kuqe–portokalli, e verdhë–jeshile, blu–vjollcë etj.), si dhe **ngjyra terciare** që krijohen nga përzierja mes ngjyrave sekondare (portokalli+vjollcë, vjollcë+jeshile, jeshile+portokalli). Rrethi i ngjyrave u ndihmon artistëve të krijojnë kombinime të balancuara dhe estetikisht të këndshme. Përmes tij mësohet se cilat ngjyra janë komplementare (të kundërta) dhe cilat janë të afërta dhe harmonike.

A E DINI SE

Isak Njutoni ishte i pari që e zbuloi spektrin e ngjyrave gjatë eksperimenteve me prizmin.



Rrethi modern digjital i ngjyrave

AKTIVITET

Krijo një vijë kohore personale për përdorimin e ngjyrës në art.

Ngjyrat primare janë baza e të gjitha të tjerave. Ato nuk mund të përftohen duke përzier ngjyra të tjera, por me to mund të krijojmë një numër të madh nuancash. Përzierja e dy ngjyrave primare jep ngjyra sekondare, dhe përzierja e mëtejshme jep ngjyra terciare. Për shembull: E kuqja (karmin) + e kaltra (ultramarin) = vjollcë, e verdha + e kaltra = jeshile, e kuqja + e verdha = portokalli. Nëse shtojmë më shumë se një ngjyrë, marrim tona të zbehta ose të errëta, që përdoren për hijezim dhe krijimin e hapësirës në një vepër arti.

AKTIVITET

Përziej kombinime të ndryshme të ngjyrave primare dhe dokumentoje cilat nuanca i përfiton.



Rembrandt – "Arratisja në Egjipt", 1647

A E DINI SE

Përzierja e më shumë ngjyrave primare jep një ngjyrë të zbehtë kafe.

Ngjyrat kromatike dhe akromatike

Përveç këtyre klasifikimeve, ngjyrat mund t'i ndajmë edhe në **kromatike** dhe **akromatike**. Kromatike janë të gjitha ato që kanë pigment ngjyrues, si e kuqja, e gjelbra, vjollca. Ato janë pjesë e spektrit dhe krijojnë efekte të qarta vizuale. Ngjyrat akromatike janë **e zeza, e bardha dhe gri** – ato nuk kanë ngjyrim dhe për këtë arsye shpesh quhen edhe "neutrale". Ngjyra e zezë i përthith të gjitha rrezet e dritës, e bardha i pasqyron, ndërsa gri është një ekuilibër mes të dyjave. Edhe pse duken të thjeshta, ngjyrat akromatike janë shumë të rëndësishme – përdoren për kontrast, efekte drite dhe janë bazë e fotografisë, dizajnit grafik dhe shumë formave të artit bashkëkohor.



Rrethi i ngjyrave

A E DINI SE

Artistët shpesh përdorin përmasa të ndryshme gjatë përzierjes së ngjyrave për të arritur një nuancë ose një gjendje të caktuar shpirtërore.

AKTIVITET

1. Eksperimentoni me ngjyra për të shprehur emocione.

2. Bëj një ditar ngjyrash – shëno cilat nuanca i përdor më shpesh dhe çfarë simbolizojnë për ty.

Nëpërmjet punës praktike, nxënësit mund ta kuptojnë më së miri logjikën e ngjyrës. **Krijimi i rrethit të ngjyrave** është një ushtrim bazë në çdo arsim artistik. Përzierja e ngjyrave primare me penel dhe bojë, vëzhgimi i rezultateve të arritura, zbulon jo vetëm vetitë teknike, por edhe ato emocionale të ngjyrës. Nxënësit mund të eksperimentojnë dhe të mbajnë mend se edhe një ndryshim i vogël në raportin mes dy ngjyrave mund të krijojë një përshtypje krejtësisht të ndryshme.

Ngjyrat mund të jenë **të pastra të ngopura**, ose **të zbehta neutrale**. Ngjyrat e ngopura duken të forta, energjike dhe rinore, ndërsa ato të zbehta janë të qeta, të ngrohta dhe shpesh përdoren për sfond. Kjo dallim është veçanërisht i rëndësishëm kur krijohet balanca në kompozim – jo çdo skenë ka nevojë për ngjyra të forta. Në realizëm, për shembull, shpesh përdoret një paletë e kufizuar me nuanca delikate për të arritur besueshmëri.

A E DINI SE

Ngopja e ngjyrës (intensiteti i saj) mund ta ndryshojë tërësisht ndjesinë që të jep një skenë – nga dramatike në të qetë.



James Whistler – "Portreti i nënës së artistit", 1871: përdor ton të zbehtë, të përmbajtur.

AKTIVITET

1. Pikturo një skenë duke përdorur vetëm 3 ngjyra (paletë e kufizuar).

2. Shndërro një imazh shumëngjyrësh në një variant neutral (me ngjyra të zbehta).

Në art, shumë artistë e kanë ndërtuar stilin e tyre pikërisht përmes ngjyrës. Për shembull, **Henri Matisse** përdor ngjyra të pastra dhe të ngopura në sipërfaqe të mëdha. **Picasso**, nga ana tjetër, ka pasur periudhat blu dhe rozë ku përdorte kryesisht vetëm një ton dominues, me të cilin shprehte një gjendje të caktuar emocionale. Në **impresionizëm**, si tek **Claude Monet**, ngjyra përdoret për të paraqitur dritën, hijet dhe ndryshimet në natyrë – pa përdorur ngjyrën e zezë. Pikturat janë të ndritshme, të gjalla dhe shpesh të krijuara me goditje të shpejta të penelit.



Pablo Picasso – "Akrobati dhe Arlequini i ri", 1905: nga periudha blu e tij – vetëm një ngjyrë dominuese për të shprehur ndjenjat.

PYETJE

1. Cilat janë ngjyrat primare dhe cilat sekondare?
2. Çfarë janë ngjyrat terciare dhe si krijohen?
3. Çfarë është rrethi i ngjyrave dhe si përdoret në art?
4. Çfarë janë ngjyrat kromatike dhe akromatike?
5. Pse është e rëndësishme drita për të parë ngjyrën?


NGJYRA II
KONTRASTET DHE KOLORITI

Pasi i mësuam bazat e ngjyrës – format e saj primare, sekondare dhe terciare – tani është koha të shqyrtojmë mënyrën se **si bashkëveprojnë ngjyrat me njëra-tjetrën**. Koloriti nuk ka të bëjë vetëm me cilat ngjyra përdoren, por me si kombinohen ato, çfarë marrëdhënie krijojnë mes tyre dhe çfarë efekti vizual dhe emocional shkaktojnë.

Artistët nuk i zgjedhin ngjyrat rastësisht – ata përdorin **ngjyra të ngrohta dhe të ftohta**, kontraste ose harmoni, në varësi të mesazhit që duan të përcjellin dhe gjendjes emocionale që duan të krijojnë. Të kuptuarit e **kontrasteve** dhe **koloritit** është thelbësore për çdo artist të ri që dëshiron të krijojë me vetëdije.

TERMA KYÇ:

kolorit, ngjyra të ngrohta, ngjyra të ftohta, kontrast, harmoni, ngjyra komplementare, ndikim emocional, ngjyra në modë



Edvard Munch – "Britma" (1893)

AKTIVITET

Shiko veprën "Britma" nga Munch dhe përpiqu të dallosh koloritin dhe ndikimin emocional që krijon.

Krijo versionin tënd të "Britmës" duke përdorur një koloritet ndryshe (p.sh. ngjyra të ftohta në vend të atyre të ngrohta), dhe krahaso ndryshimin në efektin emocional.

A E DINI SE

Munch përdori koloritet të fuqishëm dhe të ndezur për të shprehur frikën, ankthin dhe gjendjen shpirtërore të njeriut modern.

Ngjyra të ngrohta dhe të ftoht

Ngjyrat ndahen në **të ngrohta** dhe **të ftohta** sipas efektit të tyre psikologjik dhe vizual:

Ngjyrat e ngrohta (e kuqe, portokalli, e verdhë) na kujtojnë diellin, zjarrin, ngrohtësinë dhe afërsinë. Ato shkaktojnë ndjesi energjie, entuziazmi dhe dinamike.

Ngjyrat e ftohta (blu, jeshile, vjollcë) lidhen me ujin, qiellin, hijet dhe largësinë. Ato krijojnë ndjesi qetësie, heshtjeje, serioziteti ose trishtimi.

Në veprën artistike, ngjyrat e ngrohta vizualisht dalin përpara, ndërsa ngjyrat e ftohta tërhiqen në thellësi. Kjo krijon iluzion hapësinor dhe ndikon në fokusin e kompozimit. Kombinimi i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta është një nga metodat më të zakonshme për të arritur kontrast ngjyrash dhe ekuilibër emocional.

AKTIVITET

Krijo dy kompozime të vogla: një me ngjyra të ngrohta dhe një me ngjyra të ftohta. Përshkruaj ndjenjat që të sjell secila.

A E DINI SE

Në pikturën e peizazhit, ngjyrat e ftohta përdoren shpesh për të krijuar thellësi hapësinore dhe për të sugjeruar atmosferën.



Claude Monet – Seria "Zambakët e ujit", fundi i shekullit XIX – fillimi i shekullit XX

Skemë ngjyrash kontrastuese dhe harmonike

Kontrasti krijohet kur dy ngjyra janë të kundërta sipas vetive të tyre – sipas ndriçimit, ngopjes ose pozicionit në rrethin e ngjyrave. Më i forti është **kontrasti komplementar**, kur kombinohen ngjyra që gjenden përballë njëra-tjetrës në rrethin e ngjyrave:

- e kuqe – e gjelbër
- blu – portokalli
- e verdhë – vjollcë

Këto **kombinime e forcojnë njëra-tjetrën**, por gjithashtu krijojnë tension vizual. Artisti i përdor për të drejtuar vëmendjen e shikuesit.

Kombinimet harmonike krijohen me ngjyra të afërta në rrethin e ngjyrave – për shembull: blu, blu e gjelbër dhe e gjelbër. Këto skema janë të qeta, të balancuara dhe përdoren kur synohet krijimi i një atmosfere të butë dhe të përputhur.

Ndonjëherë, artistët përdorin **skema analoge** (3 ngjyra të afërta), **monokromatike** (nuanca të ndryshme të një ngjyre) ose **triadike** (tre ngjyra të vendosura në distancë të barabartë në rrethin e ngjyrave). Secila nga këto kombinime ka efektin e vet vizual.

AKTIVITET

Krijo një skemë triadike personale dhe përdore në një kompozim abstrakt.

A E DINI SE

Skemat triadike të ngjyrave krijojnë ekuilibër dhe gjallëri, edhe nëse vetë ngjyrat janë shumë të forta.



| Henri Matisse, "Dhoma e kuqe", 1908

Ndikimi emocional i kombinimeve të ngjyrave

Kombinimet e ngjyrave mund të krijojnë: **Ankth ose tension** (kontrast i fortë – p.sh. e kuqe dhe e gjelbër), Qetësi (kombinime harmonike të blu dhe jeshile), **Ngrohtësi dhe gjallëri** (portokalli me të verdhë dhe të kuqe) dhe **Elegancë dhe seriozitet** (vjollcë me blu të errët ose gri)

Në disa kultura, ngjyrat kanë simbolika të ndryshme, por efekti i **tyre mbi atmosferën** është universal. Një skemë e mirë ngjyrash jo vetëm që duket bukur, por edhe **përcjell një mesazh.**

AKTIVITET

Zgjidh një kombinim ngjyrash dhe krijo një pikturë që shkakton një ndjenjë të caktuar.

A E DINI SE

Pablo Picasso, "Dhoma blu", 1901 – është një shembull i ndikimit emocional të ngjyrës përmes përdorimit të një gamme të ftohtë blu.



Pablo Pikaso, "Dhoma Blu", 1901

Ngjyra në modë

Ngjyra nuk ka rëndësi vetëm në art – ajo luan rol qendror edhe në modë dhe dizajn veshjesh. Dizajnerët përdorin me vetëdije ngjyra të ngrohta, të ftohta, të ndezura apo të zbutura për të përcjellë stil, identitet apo gjendje shpirtërore.

- **E zeza** – përdoret për elegancë, fuqi dhe formalitet.
- **E bardha** – simbolizon pastërti dhe freski – shpesh përdoret në modën verore.
- **E kuqja** – tërheq vëmendjen dhe lidhet me pasion, fuqi dhe guxim.
- **Ngjyrat pastel** – përdoren për të krijuar një pamje të butë dhe të qetë – shumë të njohura në modën e pranverës.

Kombinimet kontrastuese – përdoren në modën urbane dhe trendet moderne për të tërhequr vëmendje vizuale dhe shprehur individualitet. Industria e modës shpesh udhëhiqet nga "ngjyrat e sezonit", të cilat përcaktohen nga dizajnerët dhe institucionet e trendeve. Prandaj, të kuptuarit e ngjyrës dhe ndikimit të saj është i rëndësishëm jo vetëm për artistët, por për këdo që dëshiron të komunikojë përmes paraqitjes së jashtme.

A E DINI SE

Ngjyra që veshim ndikon në mënyrën se si të tjerët na perceptojnë – p.sh., blu lidhet me besueshmëri dhe profesionalizëm.

AKTIVITET

Dizajno një veshje për një koleksion mode duke përdorur: ngjyra pastel ose ngjyra kontrastuese

A E DINI SE

Ekzistojnë "ngjyra të sezonit" që diktohen nga shtëpitë e modës.



Rongrong Devo, ilustrime mode, 2017

PYETJE:

1. Cilat ngjyra janë të ngrohta, e cilat të ftohta?
2. Çfarë është një skemë kontrastuese dhe çfarë një harmonike e ngjyrave?
3. Kur dhe pse një artist do të përdorte ngjyra komplementare?
4. Çfarë ndjenje shkakton një kombinim i ngjyrave të ngrohta me të ftohta?
5. A mund të ketë një ngjyrë të vetme efekte të ndryshme, varësisht se me cilën ngjyrë tjetër kombinohet?

TONI

Kudo përreth nesh ku ka dritë dhe ngjyrë, ekziston edhe toni. Toni është sasia e dritës në një ngjyrë, pa marrë parasysh nëse ajo është kromatike (e ngjyrosur) apo akromatike (pa ngjyrë). Çdo ngjyrë mund të paraqitet në variant më të çelët apo më të errët. P.sh., kemi blu të çelët dhe blu të errët, të kuqe të çelët apo të errët.




Shkalla tonale me tetë nuanca, nga e çelëta në të errëtën, paraqet një gradacion të tonit.

TERMA KYÇ:

Ton, vlerë tonale, shkallë tonale akromatike, shkallë tonale kromatike, chiaroscuro (kontrast i fortë dritë/hije), gradacion i tonit

Vlera tonale

Në artin pamor, shpesh përdoret termi "vlerë tonale" – që nënkupton sasinë e dritës ose errësirës në një ton, pavarësisht ngjyrës. Përmes saj paraqiten forma, vëllimi dhe thellësia. Sa më i thellë kontrasti midis të çelëtës dhe të errëtës, aq më e fuqishme është ndikimi vizual.



Vizatim me laps, me përdorim të gradacioneve të tonit për të paraqitur vëllim dhe hapësirë

A E DINI SE

Termi "ton" përdoret edhe në muzikë, por në artin pamor nënkupton vlerën e dritës, jo tingullin.

AKTIVITET

Vizato një objekt të zakonshëm (p.sh. një mollë) vetëm me laps të zi, duke përdorur tona të ndryshme për të shprehur dritë dhe hije.

Shkalla tonale akromatike dhe kromatike

Shkalla tonale akromatike fitohet duke përzier ngjyrën e zezë dhe të bardhë, duke krijuar një gradacion të toneve gri. Ndërsa shkalla tonale kromatike fitohet duke përzier një ngjyrë kromatike (si e kuqe, blu, e verdhë, etj.) me të zezë ose të bardhë. Në këtë mënyrë krijohen variante më të çelëta ose më të errëta të së njëjtës ngjyrë.

AKTIVITET

Krijo një shkallë akromatike me të paktën 7 nivele nga e bardha deri në të zezën, duke përdorur laps ose grafit.



Pablo Picasso – "Guernica", 1937

Drita dhe hija në vizatim

Toni na mundëson të krijojmë iluzionin e dritës, hijes dhe tredimensionalitetit në vizatim. Kur drita bie mbi një objekt, një pjesë ndriçohet, ndërsa një tjetër bie në hije. Me përdorimin e duhur të vlerave tonale, objektet duken më realiste dhe fitojnë vëllim.

AKTIVITET

1. Vendos një objekt nën një dritë tavoline dhe përpiqu ta vizatosh duke shfaqur dritën dhe hijen vetëm me laps.

2. Bëj një gradacion nga e errët në të çelët duke përdorur vetëm lapsin dhe përpiqu ta zbatosh në një vizatim të një sfere.



Georges de La Tour – "Shën Jozefi si zdrukthtar", rreth vitit 1642 (Piktor barok francez i njohur për përdorimin dramatik të dritës dhe hijes – teknika chiaroscuro)

Gradacioni është kalimi gradual nga një ton i çelët në një ton të errët. Ai është i rëndësishëm për të krijuar modelim të butë të formave dhe për të paraqitur thellësinë në një figurë. Me një gradacion të saktë shmangen vijat e forta dhe arrihet një kalim i natyrshëm. Artistët nga Evropa Veriore, të ndikuar nga poentilizmi (teknikë që përdor pika), shpesh përdorin gradacione me pika për të ndërtuar kalime tonale.

A E DINI SE

Në fotografi, ashtu si në vizatim, gradacioni përdoret për të modeluar butësisht fytyrën.



Kalimi nga everdha në të kuqe me një gradacion të butë që tregon ndryshimin e tonit dhe intensitetit

PYETJE:

1. A mund të përmendësh disa objekte rreth teje dhe të vëresh sa janë të ndritshme apo të errëta në krahasim me të tjerat?
2. Cila është dallimi midis dy ngjyrave që kanë të njëjtin ton (p.sh. blu e errët dhe jeshile e errët)?
3. A mendon se gri është ngjyrë? Pse?
4. Çfarë ndodh me hijen e një objekti nëse drita vjen nga një kënd tjetër?
5. Si ndihmon gradacioni për ta bërë një figurë të duket me përmasa të treta?


TEKSTURA

Çfarë është tekstura?

Tekstura është sipërfaqja e jashtme e çdo materiali apo objekti që mund të përjetohet vizualisht ose përmes prekjes. Ajo paraqet cilësinë sipërfaqësore të formës, dhe në art është një nga elementët bazë pamorë. Tekstura mund të jetë: **natyrore** – gjendet në natyrë, si lëvorja e drurit ose guri, **artificiale** – e krijuar nga njeriu, si plastika ose metali, imituar – d.m.th. nuk është reale, por është vizatuar ose pikturuar në mënyrë që të duket si teksturë.

TERMA KYÇ:

teksturë, teksturë reale, teksturë vizuale, fakturë, imitimi i teksturës



Tekstura të vizatuara me dorë me vija, pika dhe forma – shembuj për teksturë vizuale

AKTIVITET

Identifiko 3 objekte në mjedisin tënd me tekstura të ndryshme (p.sh. e lëmuar, e ashpër, e butë) dhe përshkruaj si ndihen gjatë prekjes dhe si duken vizualisht.

A E DINI SE

- Grafikët krijojnë teksturë me grebje, gërryerje, vija dhe gdhendje.
- Me letër mund të krijohen tekstura të ndryshme përmes shqyerjes, zhubravitjes ose shpimit.

Faktura dhe imitimi i teksturave

Në pikturë, ekziston nocioni **fakturë** – mënyra e vendosjes së ngjyrës ose materialit mbi sipërfaqe në mënyrë që ajo të marrë karakter tridimensional. Faktura mund të jetë e ashpër, e dendur, e lëmuar ose e vrazhdë. Ajo e pasuron veprën me thellësi emocionale dhe me pasuri vizuale. Shpesh artistët bëjnë **imitimin e teksturave natyrore**, si p.sh. lëvorja e drurit, qimet ose metali.

Faktura nuk është vetëm element vizual, por edhe mënyrë e shprehjes së gjendjes shpirtërore, energjisë apo dinamikës në vepër. Në artin bashkëkohor, ajo shpesh bëhet mjet kryesor i komunikimit midis artistit dhe shikuesit.



Jamie Wyeth – "Kleberg", 1984 – vaj në kanavacë, me sipërfaqe të pasura dhe fakturë ekspresive



Paul Cézanne – "Mali Sainte-Victoire", rreth vitit 1904 – përdor tekstura të trashëta për të ndërtuar formë dhe thellësi

Llojet e teksturave sipas vetive të tyre

Vetitë natyrore të materialeve ose mënyra e përpunimit të tyre krijojnë lloje të ndryshme teksturash që mund të ndihen ose të perceptohen vizualisht:

- **E lëmuar** – xhami, plastika, metali, guri, letra
- **E përafërt** – guri, lëkura e drurit, metali, letra e ashpër (shmirgël)
- **E fortë** – guri, metali, xhami
- **E butë** – lëkura, gëzofi, sfunga, goma
- **E ndritshme** – xhami, qeramika, mermeri
- **E matë** – suvaja, tekstili, lëkura
- **E lagësht** – sfunga, peshku, druri i lagësht
- **E thatë** – letra, guri, pëlhura
- **E ngrohtë** – radiatorët, guri i ngrohur
- **E ftohtë** – akulli, akullorja, metali
- **Me fije** – myku, rrobat, gëzofi i kafshëve
- **Me gjemba** – kreheri, gështenja, iriqi
- **E dendur** – bari, flokët, fijet
- **E rrallë** – rrjeta, pëlhurë me hapësira të mëdha
- **E pakëndshme** – sipërfaqe që krijojnë fërkim (si letra shmirgël)

A E DINI SE

Artistët modernë shpesh e përdorin fakturën për të shprehur lëvizje dhe emocione.

AKTIVITET

Përdor bojë akrilike, shkop druri, furçë dhe sfungjer për të krijuar lloje të ndryshme fakturash në letër.

A E DINI SE

Disa artistë vendosin ngjyrën me mjete të ndryshme: furça, gishta ose direkt nga tubi.

Tekstura është një element i rëndësishëm figurativ që i mundëson artistit të paraqesë sipërfaqe, materialitet, atmosferë dhe ndjesi. Tekstura reale përjetohet me prekje, ndërsa ajo vizuale vetëm me shikim, por të dyja janë të rëndësishme në komunikimin vizual. Në pikturë përdoret edhe **faktura** – përpunimi fizik i ngjyrës që lë gjurmë. Loja me teksturën mundëson krijimin e kontrastit, ritmit dhe kompozicionit, dhe përdorimi i saj haset jo vetëm në art, por edhe në dizajn, arkitekturë dhe jetën e përditshme. Duke zhvilluar ndjeshmëri personale ndaj teksturave, nxënësit mund të bëhen më të ndjeshëm ndaj botës vizuale që i rrethon.



Rubens Korubin – "Kënaqësi pasditeje", 2021



Claude Monet – "Zambakët e ujit dhe ura japoneze" (1899)

PYETJE:

1. Kur shikon një pikturë, a mund ta dallosh nëse tekstura është reale apo vizuale?
2. A mund të kombinohen tekstura të ndryshme në një vepër arti? Çfarë efekti krijon kjo?
3. Çfarë do të dukej më interesante në një pikturë: një sipërfaqe e lëmuar apo e përafërt? Pse?
4. Si do të imitoje teksturën e korës së drurit duke përdorur vetëm laps?

AKTIVITET

Imito një teksturë natyrore, si: Kora e drurit ose rëra, duke përdorur ngjyrë dhe duke shtuar materiale natyrore si degëz, rërë, fara etj.

DREJTIMI

Çfarë është drejtimi në artin pamor?

Çdo vijë, formë, sipërfaqe ose objekt ka aftësinë të udhëheqë shikimin e vëzhguesit në një drejtim të caktuar. Kjo fuqi vizuale që e udhëheq syrin nëpër një vepër artistike quhet **drejtim**. Në natyrë, arkitekturë dhe art, drejtimi është gjithmonë i pranishëm – qoftë në linja natyrore si lumenj, pemë, rrugë, apo në forma dhe linja të krijuara nga njeriu. Edhe kur nuk ka një vijë të shprehur qartë, syri vazhdon të udhëhiqet nga mënyra si janë vendosur format dhe ngjyrat në hapësirë. Drejtimi është një udhëzues i padukshëm, por shumë i fuqishëm në komunikimin vizual, dhe është një mjet i rëndësishëm për organizimin e kompozicionit në një vepër arti.

TERMA KYÇ:

drejtim, drejtim horizontal, drejtim vertical, drejtim diagonal, drejtim i kombinuar, pika fokale (fokus i shikimit)



Dançe Order – (2015)
Akril në kanvas

AKTIVITET

Vëzhgo disa vepra arti dhe përpiqu të përcaktosh në cilin drejtim të çon shikimi.

A E DINI SE

Drejtimi nuk sugjerohet vetëm përmes vijave, por edhe përmes lëvizjes, dritës, hijeve dhe ngjyrës.

AKTIVITET

Vizato nga një kompozicion për secilin prej këtyre drejtimeve: drejtim horizontal, drejtim vertical, drejtim diagonal (i pjerrët)

Llojet e drejtimit dhe ndikimi i tyre

Ekzistojnë tre lloje kryesore të drejtimit: horizontal, vertikal dhe i pjerrët (diagonal). Dhe pa drejtim. **Drejtimi horizontal** krijon ndjenjë qetësie, stabiliteti dhe gjerësie. Shpesh lidhet me peizazhe, horizonte, ujë dhe drejtime të lëvizjes në hapësirë. **Drejtimi vertikal** sjell ndjenjë lartësie, shpirtërorësie dhe force – përdoret shpesh në artin fetar ose monumental. **Drejtimi diagonal** fut energji, lëvizje, dramacitet ose tension – është më dinamik dhe shpesh përdoret për të përcjellë veprim ose emocion. Përveç këtyre, ekzistojnë edhe **kompozime pa drejtim**, ku asnjë forcë vizuale nuk dominon, dhe shikimi i shikuesit qëndron brenda veprës, duke krijuar ndjenjë ekuilibri, pasigurie ose introspeksioni.

Kombinimi i drejtimeve dhe dinamika vizuale

Në shumicën e veprave artistike, kombinohen disa drejtimi. Rrallë ndodh që një vepër të përmbajë vetëm një drejtim – kjo do të dukej monotone dhe statike. Kombinimi i drejtimeve sjell: **lëvizje të brendshme, ritëm dhe tension visual**. Megjithatë, një drejtim shpesh dominon, dhe përcakton përshtypjen e përgjithshme. Drejtimi gjithashtu ndihmon në ndërtimin e kompozicionit – udhëheq mënyrën e organizimit të elementeve dhe mënyrën si "lexohet" vepra.

A E DINI SE

Veprat pa drejtim dominues shpesh përdoren për të përcjellë ndjenjë ekuilibri ose mendim të brendshëm.



Kazimir Maleviç – "Kompozim Suprematist", rreth vitit 1923

A E DINI SE

Shumë artistë modernë eksperimentojnë duke eliminuar drejtimin, për të angazhuar publikun në një shikim të lirë të veprës.

AKTIVITET

1. **Identifiko një vepër arti pa drejtim të theksuar dhe shpjego pse shikimi nuk shkon jashtë saj.**
2. **Analizo një vepër arkitektonike (si urë, ndërtesë, shkallë) dhe identifiko drejtimet që përbëjnë strukturën.**



AKTIVITET

Krijo një kompozim abstrakt duke përdorur drejtime të ndryshme dhe shëno se cili drejtim dominon në të.

A E DINI SE


Në skulpturë dhe arkitekturë, drejtimi diagonal përdoret rrallë, sepse prish statikën e objektit.

Drejtimi dhe kompozimi në jetën e përditshme

Drejtimi si forcë vizuale nuk është i pranishëm vetëm në art – ai luan një rol të rëndësishëm edhe në jetën e përditshme. Dizajnerët e përdorin drejtimin për ta drejtuar vëmendjen kah elementet e caktuara, arkitektët e zbatojnë në shpërndarjen dhe pamjen e hapësirave, ndërsa në modë përdoret për ta theksuar ose ndryshuar përshtypjen vizuale të trupit. Edhe në natyrë, mënyra se si rritet një pemë, si rrjedh një lumë ose si bie shiu ka drejtimin e vet. Aftësia për ta njohur dhe përdorur drejtimin është thelbësore jo vetëm për artistët, por edhe për secilin që komunikon vizualisht – qoftë përmes fotografisë, videos, grafikës apo prezantimit të përditshëm. Drejtimi e rrit qartësinë dhe komunikueshmërinë e mesazhit që përcillet vizualisht.

A E DINI SE

Në fotografi, drejtimi përdoret për të drejtuar shikimin drejt pikës fokale.



"Brezë endarë me shumë degë në një ditë vjeshte"



Antonio Gaudi – "Fasada e Lindjes, Sagrada Familia", filluar në vitin 1894

A E DINI SE

Artistët shpesh e përdorin drejtimin për të drejtuar syrin drejt elementit më të rëndësishëm në vepër – të quajtur pika fokale.

PYETJE:

1. Kur shikon një vepër arti, a mund ta dallosh se cilin drejtim dominon?
2. Pse mendon se artistët shpesh kombinojnë më shumë drejtime?
3. Si ndihesh kur sheh një pikturë pa drejtim të qartë?
4. A mund të ndikojë drejtimi në emocionin që shkakton një vepër?
5. Cilët drejtime i përdor më shumë në krijimet e tua dhe pse?

AKTIVITET

1. Bëj një fotografi të një objekti nga ambienti (si një rrugë, pemë, ndërtesë, urë) ku dominon një drejtim dhe shpjego rolin e tij në imazh.
2. Krijo një poster ose kopertinë libri duke përdorur një drejtim dominues që e udhëzon syrin deri te titulli.

MADHËSIA

Në jetën e përditshme, ashtu si edhe në art, çdo gjë ka një madhësi të caktuar. Ajo nuk ekziston në mënyrë të izoluar, por gjithmonë perceptohet në lidhje me objektet e tjera dhe me hapësirën që zë. Madhësia është një koncept relativ – që do të thotë se nuk mund të përcaktohet një vlerë absolute për të pa krahasim. Për shembull, një objekt i njëjtë mund të duket i vogël nëse vendoset pranë diçkaje shumë më të madhe, por mund të duket i madh nëse ndodhet pranë diçkaje më të vogël. Gjithashtu, përshtypja për madhësinë e tij do të ndryshojë nëse vendoset në një hapësirë të gjerë ose në një hapësirë të ngushtë. Kjo dukuri është themelore për të kuptuar komunikimin vizual – si ndikojnë artistët në perceptimin e shikuesit përmes kombinimit të madhësive të ndryshme. Me një përzgjedhje të kujdesshme të përmasave, artisti mund të theksojë rëndësinë e një elementi të caktuar ose të krijojë iluzionin e thellësisë. Madhësia, së bashku me pozicionin dhe kontrastin, luajnë një rol kyç në ndërtimin e kompozicionit.

TERMA KYÇ:

madhësi, dominim dhe kontrast në madhësi, gradacion i madhësisë, madhësia në dizajn



Forma shumëngjyrëshe në madhësi të ndryshme që tregojnë rëndësinë e madhësisë për theksin vizual.

AKTIVITET


Krahaso dy forma të ngjashme në një fletë letre dhe vendosi në kontekste të ndryshme (njërën në mes të faqes, tjetrën në një cep). Çfarë përshtypjeje krijojnë?

A E DINI SE

Madhësia përdoret jo vetëm për të krijuar iluzionin e hapësirës, por edhe për të përcjellë simbolikë: format e mëdha shpesh lidhen me forcë dhe rëndësi, ndërsa ato të vogla me brishtësinë ose kalueshmërinë.

Madhësia dhe elementët tjerë pamorë

Madhësia nuk paraqitet kurrë e ndarë – ajo është gjithmonë e lidhur me elementët e tjerë si: **vija, toni, ngjyra, sipërfaqja, tekstura** dhe **forma**. Kështu, kur flasim për një vijë të trashë, në të vërtetë flasim për një vijë me gjerësi më të madhe; një vijë e gjatë ka më shumë gjatësi sesa ajo e shkurtër. Madhësia mund të përcaktojë edhe tonin – një sipërfaqe më e madhe me ngjyrë të errët mund të duket më dominuese sesa një formë e vogël dhe e çelur. Tekstura mund të jetë e imët ose e trashë, ndërsa ngjyra mund të duket më e rëndë ose më e lehtë në varësi të shpërndarjes së saj dhe madhësisë së zonës ku aplikohet.



Piet Mondrian – Kompozicion me të kuqe, të verdhë, blu dhe të zezë, 1921

Dinamika, dominimi dhe harmonia përmes madhësisë

Në artin pamor, disa elementë bëhen **vizualisht dominues** falë madhësisë së tyre. Format e mëdha shpesh e tërheqin të parat vëmendjen e shikuesit. Përdorimi i madhësive të ndryshme sjell ritëm, lëvizje dhe interes në kompozicion. Nga ana tjetër, nëse të gjitha format kanë përafërsisht të njëjtën madhësi, kompozicioni mund të duket statik, madje edhe monoton. Madhësitë e ngjashme krijojnë ndjenjën e ekuilibrit dhe harmonisë, ndërsa kontrastet në madhësi sjellin dramaticitet dhe energji.



Henri Matisse – "Vallëzimi" (Dance), 1910

A E DINI SE

Në veprat artistike, objekti që është më i rëndësishëm për tregimin ose kompozicionin shpesh paraqitet me madhësinë më të madhe, edhe nëse në realitet nuk është i tillë.

AKTIVITET

Zgjidh një vepër pamore dhe analizo se cilin element dominon për nga madhësia dhe si ndikon kjo në tërësinë e kompozicionit.

Madhësia dhe gradaimi

Gradaimi i madhësisë paraqet një ndryshim të vazhdueshëm – forma mund të rritet ose të zvogëlohet, vija të bëhet më e trashë ose më e hollë, ngjyra të kalojë nga e errët në të çelët. Gradaimi krijon lëvizje, drejtim dhe kahje. Me anë të tij, artistët krijojnë thellësi, zhvillim dhe vazhdimësi në veprën artistike. Ai nuk përdoret vetëm për efekt vizual, por edhe për të përcjellë një mesazh ose kuptim simbolik, si për shembull zhdukja graduale, zhvillimi, rritja ose kalimi nga një gjendje në tjetrën.



Giorgio de Chirico – "Misteri i rrugicave", 1914

A E DINI SE

Në tipografi, madhësia e shkronjave përcakton lexueshmërinë dhe rëndësinë e mesazhit – ajo që është më e rëndësishme gjithmonë paraqitet me madhësi më të madhe.

AKTIVITET

Vizato një varg formash që rriten gradualisht nga më e vogla te më e madhja, dhe më pas në drejtim të kundërt.

Apliko gradaimin në një poster dizajni, ku teksti ose imazhet rriten ose zvogëlohen gradualisht.

A E DINI SE

Në natyrë, gradaimi është i pranishëm vazhdimisht – nga degët e një peme, te hijet, e deri te vargmalet në horizont.

Madhësia në artin e aplikuar dhe dizajn

Në **arkitekturë, dizajnin tekstil, ambalazhimin, dizajnin grafik dhe dizajnin digjital,** madhësia ka një rol vendimtar. Nga përmasat e motiveve të letrave të murit deri te teksti në një poster apo faqe interneti – përdorimi i duhur i madhësive e përcakton lexueshmërinë, fokusin dhe funksionalitetin e përmbajtjes vizuale. Përsëritja e madhësive të njëjta krijon rregull dhe qetësi, por lehtë mund të kthehet në monotoni. **Madhësitë e ngjashme** japin larushi të butë, ndërsa kontrastet në madhësi sjellin intensitet dhe tërheqje vizuale.

Në formësimin tredimensional (skulpturë, modelim, dizajn), përdorimi i madhësive të ndryshme është me rëndësi themelore për krijimin e ekuilibrit vizual, pikës së gravitetit dhe ritmit në hapësirë. Duke kombinuar forma të mëdha, mesatare dhe të vogla, artisti mund të krijojë përshtypje të lëvizjes, perspektivës apo funksionalitetit. Për shembull, te modelet arkitekturore ose skulpturat, format dominuese zakonisht janë më të mëdha për të tërhequr vëmendje, ndërsa detajet më të vogla shtojnë kompleksitet dhe realizëm. Madhësia në artin 3D nuk është vetëm një zgjedhje vizuale, por edhe një komponent struktural dhe simbolik.



Peizazh urban modern, skicë e ndërtesave me madhësi të ndryshme, me gradaim dhe perspektivë



Forma gjeometrike 3D me madhësi të ndryshme që krijojnë ekuilibër, pikë qendre dhe ritëm vizual në hapësirë.

PYETJE:

1. **Pse madhësia konsiderohet si një nocion relativ?**
2. **Si mund të paraqesim afërsinë ose largësinë në një vepër përmes madhësisë?**
3. **Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të madhësive të njëjta në një krijim artistik?**
4. **Si mund të përcjellë lëvizje ose zhvillim gradaimi i madhësisë në një kompozim?**

AKTIVITET

1. **Krijoni një dizajn për një bluzë ose poster, duke përdorur madhësi të ndryshme të formave apo shkronjave.**
2. **Analizoni një objekt arkitekturor dhe vini re si ndikon madhësia e dritareve, dyerve apo detajeve në pamjen e përgjithshme.**

FORMA

Forma është pamja e jashtme, fizike e një objekti, e cila përkufizohet me ndihmën e vijës, sipërfaqes, vëllimit dhe hapësirës. Ajo mund të paraqitet si: dy-dimensionale, kur shfaqet në një sipërfaqe – për shembull në pikturë, vizatim, mozaik apo vitrazh, tre-dimensionale, kur paraqitet si trup në hapësirë që ka vëllim, thellësi dhe masë, siç ndodh me skulpturat apo arkitekturën. Forma është një element themelor i çdo kompozicioni vizual, sepse na ndihmon të njohim objektin, të ndiejmë strukturën e tij dhe pozicionin e tij në hapësirë.

TERMA KYÇ:

forma, forma natyrore, forma e krijuar nga njeriu, forma e hapur, forma e shpuar (perforuar), forma statike, forma dinamike



"Davidi" – Michelangelo, 1501–1504

AKTIVITET

1. Vizato një objekt me formë të qartë, pastaj përpiqu ta paraqesësh edhe si formë tre-dimensionale, duke përdorur hijezim.
2. Krahasoni dy vepra arti: një që përdor formë të sheshtë (dy-dimensionale) dhe një tjetër që përdor formë hapësinore (tre-dimensionale)

A E DINI SE

Forma nuk ekziston vetëm në art – ajo është e pranishme edhe në natyrë, shkencë, matematikë dhe jetën e përditshme.



Gustav Klimt – „Portreti i Adele Bloch-Bauer I" – 1907

A E DINI SE

Në arkitekturë shpesh kombinohen forma të krijuara nga njeriu dhe forma të frymëzuara nga natyra për të krijuar harmoni me ambientin përreth.

Çdo ditë jemi të rrethuar nga forma nga më të ndryshmet. Ato mund të jenë: natyrore, si për shembull: guri, molla, pema, trupi i një kafshe; të krijuara nga njeriu, si: karrigia, makina, gota me ujë ose ndërtesa. Format natyrore zakonisht kanë konture organike dhe të lira, ndërsa format e krijuara nga njeriu janë më shpesh gjeometrike dhe të rregullta. Të kuptuarit e kësaj dallese na ndihmon që: të analizojmë format që shohim, të njohim veçoritë e tyre dhe t'i kombinojmë ato në krijimet tona artistike.

AKTIVITET

1. **Zgjidh pesë objekte nga natyra dhe pesë objekte të krijuara nga njeriu dhe vizatoji.**
2. **Krijo një kompozim artistik ku do të kombinosh forma natyrore dhe të krijuara.**




Meret Oppenheim – „Objekti" – 1936

A E DINI SE

Perforimet përdoren në art dhe dizajn për të krijuar ndjesi lëvizjeje, lehtësie dhe transparence.

Në lidhje me strukturën e tyre, format mund të jenë të hapura, të mbyllura ose të shpuara. Forma e hapur – lejon hapësirën të depërtojë në të, si tek një gotë, vazo ose çantë. Forma e mbyllur – është e kufizuar nga të gjitha anët, si një top ose gur, dhe nuk lejon hapësira e brendshme të lidhet me të jashtmen. Forma e shpuar – ka vrima që i japin transparencë dhe lehtësi, si një sitë, zinxhir ose rrjetë metalike. Këto lloje formash nuk janë vetëm vizualisht të ndryshme, por edhe funksionalisht – ndikojnë në mënyrën se si drita, ajri ose tingulli kalojnë përmes tyre.



Piet Mondrian, "Kompozicioni II në të kuqe, blu dhe të verdhë" – 1930

AKTIVITET

1. Ndërto një model prej letre që ka formë të hapur dhe strukturë të shpuar (për shembull, një rrjetë ose kuti me hapje).

2. Vizato tre forma: një të hapur (p.sh. gotë ose çantë), një të mbyllur (p.sh. gur ose top), një të shpuar (p.sh. rrjetë ose sitë) dhe analizo ndryshimet midis tyre në pamje dhe funksion.

Në art shpesh përdoren forma të thjeshta gjeometrike – rrethi, katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi – si elemente për krijimin e formave të ndërlikuara. Forma e ndërlikuar lind kur kombinohen disa forma të thjeshta në një tërësi vizuale ose hapësinore. Për shembull, duke kombinuar një kub dhe një trekëndësh mund të fitohet forma e një shtëpie, ndërsa me një rreth dhe cilindra – figura e njeriut. Ky kombinim është baza e shumë lëvizjeve artistike si kubizmi dhe konstruktivizmi, ku objektet reduktohen në struktura gjeometrike.



Paolo Uccello, "Beteja e San Romanos" – rreth vitit 1435

A E DINI SE

- Në kubizëm, artistët "e shpërbënin" objektin në forma të thjeshta për ta paraqitur nga kënde të ndryshme njëkohësisht;
- Format e shpuara (perforuara) krijojnë lojë me dritën dhe hijen, prandaj shpesh përdoren në arkitekturën bashkëkohore për të krijuar interes vizual dhe për ajrosje natyrale.

Forma mund të ketë karakter – ajo mund të duket e qetë ose shqetësuese, e qëndrueshme ose në lëvizje. Format statike janë ato që sugjerojnë qetësi, stabilitet dhe qëndrueshmëri – si katrori ose drejtkëndëshi. Format dinamike, përkundrazi, krijojnë ndjenjë të energjisë, shqetësimit dhe lëvizjes – si valët, spiralet ose vijat rrethore. Artistët me vetëdije i përdorin këto efekte për të përcjellë një mesazh ose ndjenjë. Për shembull, një formë dinamike mund të shkaktojë emocion, ndërsa një formë statike – qetësi.

Forma është elementi themelor vizual në të gjitha disiplinat artistike – pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn. Ajo jo vetëm që e përcakton pamjen e objektit, por edhe funksionin e tij, simbolikën dhe marrëdhënien me hapësirën. Në vizatim dhe grafikë, forma mund të modelohet me dritë dhe hije, shrafurë, vijë dhe kontrast, për të krijuar përshtypjen e volumit. Forma është gjithashtu një medium përmes të cilit komunikohen mesazhe, ndjenja dhe ide.



Rembrandt van Rijn – "Autoportret në qoshe", rreth vitit 1639

AKTIVITET

1. Zgjidh një objekt dhe përpiqu ta paraqesësh me të paktën tre forma gjeometrike.

2. Krijo një kompozim që përcjell lëvizje, duke përdorur forma dinamike dhe vija të harkuara.

A E DINI SE

Në reklama, shpesh përdoren forma dinamike për të tërhequr vëmendjen, ndërsa në logo përdoren forma statike për të shprehur stabilitet dhe besim.

PYETJE

1. Çfarë përfaqëson linja në artin pamor?
2. Çfarë lloje vijash njeh?
3. Çfarë emocionesh mund të përcjellë secili lloj?
4. Shpjego dallimin mes vijës konture dhe vijës që tregon teksturë.
5. Si e përdorin artistët linjën për të treguar lëvizje apo teksturë?
6. Si do t'i përdorje llojet e ndryshme të vijave për të shprehur ndjenja të kundërta?

HAPËSIRA

Hapësira është element themelor figurativ që e formëson mjedisin tonë dhe shprehjen artistike. Gjithçka që na rrethon – dhoma, rruga, ndërtesat, qielli, madje edhe brendësia e një gote – është hapësirë. Në art, hapësira mund të jetë reale (tredimensionale, në të cilën lëvizim) ose iluzion i hapësirës (i paraqitur në një sipërfaqe dy-dimensionale). Hapësira është mediumi nëpër të cilin ne lëvizim, ekzistojmë dhe krijojmë, dhe është një nga aspektet më të rëndësishme të artit pamor. Artistët gjithmonë janë përpjekur ta kuptojnë dhe ta paraqesin hapësirën – nga hapësira simbolike dhe e rrafshuar në ikonat e vjetra, deri te perspektiva lineare e saktë e zhvilluar në Rilindje. Përmes dritës dhe hijes, mbivendosjes, perspektivës dhe shkallëzimit, ata krijuan iluzione të thellësisë dhe largësisë mbi një sipërfaqe të sheshtë. Në artin bashkëkohor, hapësira shpesh eksplorohet si koncept, ku e rëndësishme nuk është vetëm forma, por edhe marrëdhënia me shikuesin dhe mjedisin.

TERMA KYÇ:


hapësirë, iluzion i hapësirës, qasje bashkëkohore

AKTIVITET

Kërko një vepër arti nga secila prej këtyre periudhave (p.sh., ikonat mesjetare, rilindja, arti bashkëkohor) dhe përshkruaj mënyrën si është paraqitur hapësira në të.



James Turrell – "Tuneli Ganzfeld", rreth vitit 2013



Zhang Daqian – „Peizazh malor me ujëvarë", rreth vitit 1965

A E DINI SE

James Turrell krijon art duke përdorur vetëm dritë dhe hapësirë, pa forma fizike.

Hapësira mund të jetë e brendshme (e mbyllur) ose e jashtme (e hapur). Hapësira e brendshme, siç është dhoma, klasa apo teatri, kufizohet me mure, tavan dhe dysheme. Ky tip hapësire ka funksion – përdoret për jetesë, punë, pushim ose edukim. Hapësira e jashtme është e hapur – rruga, qielli, parku – dhe lejon lëvizje të lirë. Përmes artit pamor, hapësira e brendshme shpesh paraqitet si intime, e mbyllur, ndërsa hapësira e jashtme sjell ndjenjë lirie ose, në disa raste, vetmie, nëvarësi të përbërjes dhe ngjyrës.

Hapësira mund të jetë e thjeshtë (një vëllim, si dhoma) ose e ndërlikuar (më shumë hapësira të lidhura, si banesa ose qyteti). Hapësira e ndërlikuar ka organizimin e vet funksional dhe projektohet sipas nevojave njerëzore. Në shprehjen pamore, kuptimi i strukturës së hapësirës është thelbësor për krijimin e një vepre arti që do të jetë bindëse dhe vizualisht interesante. Arkitektura është disiplinë që merret drejtpërdrejt me hapësirën dhe formësimin e saj, ndërsa artistët pamorë shpesh frymëzohen pikërisht nga ndërtesat dhe peizazhet urbane.



Daniel Buren – "Korridore: Vepër për vendndodhje specifike", 2006



Giovanni Battista Piranesi – Nga seria "Burgjet imagjinare", rreth viteve 1745–1761

A E DINI SE

Giovanni Battista Piranesi krijonte gravura me ndërtesa imagjinare dhe hapësira komplekse të mbushura me shkallë dhe ura.

AKTIVITET

Jepni shembuj të hapësirave reale nga mjedisi juaj.

AKTIVITET

Bëni një vizatim me tre shtresa: plan i përparmë, plan i mesëm dhe plan i pasëm.

Iluzioni i hapësirës në art arrihet me mjete të ndryshme vizuale: mbivendosje të formave (njëra pas tjetrës), zvogëlim të madhësisë (më të voglat duken më larg), përdorim të toneve të ndritshme e të errëta (të ndritshmet dalin përpara, të errëtat tërhiqen prapa), si dhe ngjyra të ngrohta e të ftohta. Këto teknika janë zhvilluar me shekuj dhe arrijnë kulmin në Rilindje me futjen e perspektivës. Artistë si Brunelleschi dhe Leonardo da Vinci vendosën themelet e mënyrës se si paraqitet hapësira tridimensionale në një sipërfaqe të sheshtë. Artistët bashkëkohorë përdorin edhe fotografinë, mediat digjitale apo instalacionet për ta shfaqur hapësirën. Disa artistë inskenojnë skena të tëra si në një skenë teatri për të krijuar një vepër fotografike të përsosur me thellësi dhe kompleksitet hapësinor. Të tjerë, përkundrazi, e reduktojnë hapësirën në elemente minimaliste, duke ia lënë shikuesit mundësinë që vetë ta "plotësojë" hapësirën me emocionet dhe mendimet e tij.



René Magritte – "Gjendja njerëzore" Viti 1933



Jeff Wall – Sipas "Njeriut e Padukshëm" nga Ralph Ellison, 1999–2001

A E DINI SE

Zhang Daqian nga Chengdu, në peizazhet kineze krijonte iluzionin e largësisë së pafundme vetëm me nuanca dhe tush.

PYETJE

1. Si dallon hapësira reale nga iluzioni i hapësirës në art?
2. Pse është e rëndësishme të kuptohet hapësira e brendshme dhe e jashtme kur krijon një vepër arti?
3. Cilët elementë të ndihmuan më shumë për të paraqitur hapësirën në vizatimin tënd?
4. A mund të përcjellë hapësira emocione? Si?

AKTIVITET

Përdorni ngjyra të ngrohta dhe të ftohta për të krijuar ndjesinë e thellësisë.

Bëni një fotografi me thellësi të theksuar

(p.sh. objekte të afërta dhe të largëta në të njëjtën pamje).

Organizoni një mini-ekspozitë me veprat tuaja që tregojnë përdorim të hapësirës në klasë.

PERSPEKTIVA I PERSPEKTIVË LINEARE ME NJË PIKË BASHKIMI

Perspektiva është një mjet vizual që artistët e përdorin për të krijuar iluzionin e thellësisë dhe hapësirës mbi një sipërfaqe të sheshtë. Perspektiva lineare, e zhvilluar në periudhën e Rilindjes, bazohet në rregullat e gjeometrisë dhe të vëzhgimit, dhe mundëson paraqitjen precize të objekteve dhe hapësirave në raport me këndvështrimin e shikuesit. Kur të gjitha vijat në një vizatim ose pikturë drejtohen drejt një pike të vetme në vijën e horizontit, atëherë kemi të bëjmë me perspektivë lineare me një pikë bashkimi. Ky metod përdoret më shpesh për të paraqitur hapësira të brendshme, korridore të gjata, rrugë ose shtegje që shikohen drejtpërdrejt nga përpara.

TERMA KYÇ:

perspektivë lineare, pikë bashkimi, vijë horizonti, drejtim vizual



Pietro Perugino – "Dorëzimi i çelësave Shën Pjetrit", 1481–1482

A E DINI SE

Fjala "perspektivë" vjen nga fjala latine perspicere, që do të thotë "të shohësh përmes".

AKTIVITET

Vizato brendësinë e një dhome duke përdorur një pikë bashkimi të vendosur në vijën horizontale.



Leonardo da Vinci – "Darka e fundit", 1495–1498

Me përdorimin e një pike të vetme bashkimi, artisti krijon një ndjesi të fortë të thellësisë. Muret, dyshemeja dhe tavani i një dhome paraqiten sikur shtrihen pas në hapësirë, ndërsa objektet zvogëlohen me rritjen e distancës. Përdorimi i saktë i perspektivës e bën skenën të duket realiste dhe bindëse, edhe kur është vizatuar në mënyrë minimaliste. Ky metodë është bazë për vizatimin dhe dizajnin arkitekturor, por gjithashtu përdoret në komikë, fotografi dhe film.

Në hapësirat e brendshme, një pikë bashkimi zakonisht vendoset në qendër të kompozicionit. Të gjitha vijat – skajet e mobilieve, këndet e dhomës, dyshemeja – drejtohen drejt kësaj pike. Objektet më afër shikuesit duken më të mëdha, ndërsa ato më larg – më të vogla, duke krijuar një efekt të thellësisë reale. Perspektiva me një pikë është e thjeshtë për t'u zbatuar, por shumë e fuqishme në shprehjen vizuale.



Edward Hopper – "Dhoma e hotelit", 1931

AKTIVITET

Gjeni fotografi ose skena filmike që përdorin një pikë bashkimi dhe analizoni kompozicionin e tyre.

A E DINI SE

Filippo Brunelleschi, arkitekt nga Firence, ishte i pari që formuloi shkencërisht perspektivën lineare në shekullin XV.



Pjesë nga loja Rainbow Six: Siege

A E DINI SE

Arti i rrugës (street art) shpesh përdor perspektivën lineare për të krijuar iluzione 3D kur shihen nga një kënd i caktuar.

Perspektiva lineare me një pikë nuk është e kufizuar vetëm në artin tradicional. Sot ajo luan një rol të rëndësishëm edhe në mediat bashkëkohore siç janë videot, modelimi 3D, arkitektura digjitale dhe prodhimi filmik. Krijimi i ambienteve të brendshme dhe peizazheve realiste në kontekst digjital shpesh fillon me vizatimin e strukturës bazë me një pikë grumbullimi. Në këtë mënyrë, artistët dhe dizajnerët mund të kontrollojnë saktësisht se si shikuesi do ta përjetojë hapësirën.



Camille Pissarro – "Bulevardi Montmartre natën", 1897

A E DINI SE

Shumë video-lojëra të njohura (si Minecraft dhe The Sims) përdorin perspektivë me një pikë bashkimi për të krijuar ndjesinë e hapësirës dhe orientimit.

AKTIVITET

Realizo një vizatim të një korridori, linje hekurudhore ose rruge duke përdorur perspektivën me një pikë bashkimi.

Provo të vendosësh objekte (karrige, tavolinë, rafte) në hapësirë dhe paraqiti ato saktë në raport me perspektivën.

PYETJE

1. Pse është e rëndësishme të kuptohet perspektiva lineare në artin pamor?
2. Si e ndryshon perspektiva me një pikë përjetimin e hapësirës së brendshme?
3. Cilat skena të përditshme mund të paraqiten me një pikë bashkimi?
4. Si mund të përdoret kjo perspektivë për të drejtuar vëmendjen e shikuesit?

PERSPEKTIVA II
PERSPEKTIVË LINEARE ME DY PIKA BASHKIMI

Perspektiva lineare me dy pika bashkimi është një metodë më e avancuar për paraqitjen e hapësirës në një sipërfaqe të sheshtë. Në ndryshim nga perspektiva me një pikë, këtu format paraqiten në mënyrë që anët e tyre janë të kthyer në kënd drejt shikuesit, dhe të gjitha vijat që largohen shkojnë drejt dy pikave të ndryshme në horizont – një në të majtë dhe një në të djathtë. Ky mënyrim i paraqitjes mundëson një interpretim më dinamik dhe më realist të objekteve arkitektonike, skenave urbane dhe formave tredimensionale. Kjo qasje u mundëson artistëve të paraqesin objektet nga një kënd, gjë që krijon ndjesinë e masës, stabilitetit dhe hapësirës reale.

TERMA KYÇ:

perspektivë me dy pika, perspektivë këndore, thellësi vizuale, horizont




Gustav Caillebotte – "Rruga pariziane", 1877

Ky lloj perspektive përdoret më së shpeshti kur paraqiten këndet e ndërtesave, rrugëve dhe peizazheve urbane, ku shikuesi nuk është i kthyer drejtpërdrejt drejt një faqeje, por sheh dy anë të objektit. Kështu arrihet ndjesia e vëllimit, masës dhe realitetit hapësinor. Vizat e çative, dritareve dhe bazave të objekteve "bashkohen" drejt pikës së majtë dhe asaj të djathtë, duke krijuar ndjesinë e stabilitetit, por edhe të lëvizjes në hapësirë. Perspektiva me dy pika është bazë për paraqitjen e shumë objekteve në një peizazh kompleks, ku çdo ndërtesë mund të paraqitet nga një kënd tjetër, e megjithatë të ruhet logjika vizuale.

AKTIVITET

1. Gjej një fotografi të një ndërtese në kënd dhe vizatoje duke përdorur dy pika bashkimi.

2. Mundohu të vizatosh një kuti ose një sandak nga një kënd perspektivë.



M. C. Escher – "Relativiteti", 1953

A E DINI SE

- Dy pikat e bashkimit në perspektivë gjithmonë vendosen në vijën e horizontit dhe mund të jenë jashtë vetë imazhit?
- Kjo teknikë është përdorur gjerësisht nga artistët e Rilindjes dhe është ringjallur në artin modern të rrugës dhe dizajnin grafik?

Në artin digjital dhe videolojëra, perspektiva me dy pika është thelbësore për krijimin e mjediseve mbresëlënëse dhe orientuese. Arkitektura në botët virtuale duhet të jetë bindëse, prandaj dizajnerët përdorin këtë teknikë për të paraqitur hapësirën nga kënde të ndryshme. Edhe kur skenat janë të imagjinuara – qytete fantastike apo mjedise futuristike – zbatimi i perspektivës së saktë u jep atyre logjikë dhe besueshmëri. Kështu, lojtari jo vetëm që lëviz nëpër hapësirë, por edhe e ndien vizualisht atë si real dhe të strukturuar logjikisht.

AKTIVITET

1. Vizato një ndërtesë nga kënd, e frymëzuar nga ndonjë skenë videolojërash.

2. Ndërto një maket apo një skicë 3D të një ndërtese këndore me dy pika bashkimi.



Vincent van Gogh – "Dhoma e gjumit në Arles", 1888

A E DINI SE

- Kjo perspektivë është themelore për krijimin e vizatimeve teknike në arkitekturë dhe dizajn industrial?
- Shumica e hartave në lojën "Rainbow Six: Siege" janë projektuar me dy pika bashkimi për të krijuar një simulim realist të hapësirës urbane?



Hans Vredeman de Vries – "Skenë arkitekturore", shek. XVI

AKTIVITET

Përfytyro një skenë në të cilën shikuesi qëndron në një kënd midis dy rrugëve dhe paraqite hapësirën duke përdorur perspektivë me dy pika bashkimi.

PYETJE

1. Në cilat situata është më efikase të përdoret perspektiva me dy pika në vend të asaj me një pikë?
2. Si mund të dallosh një perspektivë me një pikë nga ajo me dy pika në një vizatim?
3. A të ofron perspektiva me dy pika më shumë liri në kompozim? Si?

Tema 3

Parimet e artit pamor

Çdo krijim artistik është një gjuhë vizuale më vete, ndërsa parimet pamore përbëjnë gramatikën e kësaj gjuhe. Ato organizojnë dhe rregullojnë hapësirën, marrëdhëniet dhe ritmin midis formave, ngjyrave, vijave dhe të gjithë elementëve të tjerë që përdor artisti. Edhe pse ekzistojnë rregulla të përcaktuara, kreativiteti nuk ka kufij – çdo artist përdor ndjeshmërinë e vet për të krijuar një shprehje unike vizuale.

Parimet pamore bëjnë të mundur që çdo element në vepër të zërë vendin dhe rolin e vet, duke krijuar një tërësi vizualisht të rregullt, të kuptueshme dhe mbresëlënëse. Përmes tyre ndërtohet ekuilibri, arrihet harmonia, theksohet kontrasti, krijohen lëvizje dhe ritëm, modifikohen proporcionet, ndërtohet kompozicioni dhe – më e rëndësishmja – lind një ndjesi e unitetit midis të gjitha pjesëve të veprës. Këto parime – ndonëse të njohura dhe të studiuara – nuk e kufizojnë lirinë e shprehjes, por i japin asaj strukturë dhe forcë.

Në këtë temë do të njihemi me: harmoninë si përputhshmëri dhe ngjashmëri mes pjesëve të veprës, kontrastin si theksim i kundërtive mes elementeve, gradacionin si ndryshim i ngadalshëm i karakteristikave, ekuilibrin si qëndrueshmëri vizuale, ritmin dhe lëvizjen që sjellin dinamikë, proporcionet që përcaktojnë marrëdhëniet e përmasave, unitetin që siguron lidhjen e tërësishme, dhe kompozicionin si renditje artistike që çon te një fokus i qartë vizual.

Kur fillojmë të mësojmë për artin pamor, më të lehta për t'u kuptuar janë ato parime që kanë efekt më të dukshëm vizual – si kontrasti, ritmi, ekuilibri dhe kompozicioni. Ato na ndihmojnë më shpejt të organizojmë format, ngjyrat dhe elementët e tjerë në krijimet tona. Me kalimin e kohës dhe me përvojë më të madhe, do të njihemi edhe me parimet e tjera – si harmonia, gradacioni, proporcionet dhe uniteti – dhe do të mësojmë si t'i përdorim në mënyrë krijuese dhe personale.

Qëllimet e temës:

- Të kuptosh se çfarë janë parimet pamore dhe pse ato janë të rëndësishme në artin pamor.
- Të njohësh llojet e ndryshme të parimeve në veprat artistike.
- Të mësosh si t'i përdorësh parimet pamore gjatë krijimit të një vepre tëndën artistike.
- Të zhvillosh vetëdije për tërësinë vizuale, ekuilibrin dhe shprehshmërinë në krijimtarinë tënde.

HARMONIA

Harmonia është një parim universal që udhëheq synimin drejt ekuilibrit në natyrë, si dhe në kulturën, mendimin dhe artin njerëzor. Në jetën e përditshme e hasim në simetrinë e formave natyrore, në përputhjen e ngjyrave në një perëndim dielli, në tingujt e rregullt të muzikës ose në marrëdhëniet e mira mes njerëzve. Në artin pamor, harmonia është parim themelor përmes të cilit arrihet lidhja vizuale midis elementeve të një kompozimi. Ajo nuk kërkon uniformitet, por ekzistencën e dallimeve që së bashku krijojnë tërësinë. Elementet si vijat, ngjyra, toni, forma, tekstura ose drejtimi kombinohen në mënyrë që të plotësojnë njëri-tjetrin, pa lejuar që ndonjëri të dominojë ose të prishë përshtypjen e përgjithshme.

TERMA KYÇ:

Harmoni, harmoni sipas analogjisë, harmoni sipas funksionit, harmoni sipas idesë, gradaçion, ekuilibër vizual





Klod Monet, "Pyll me zambakë uji dhe shelg lotues", rreth vitëve, 1916–1919

A E DINI SE

Harmonia si parim estetik e ka prejardhjen nga arti dhe arkitektura e lashtë greke.

AKTIVITET

1. Identifiko objekte ose skena nga përditshmëria që i konsideron harmonike.
2. Realizo një vizatim që përmban të paktën tre elemente vizuale të ngjashëm.

Në artin pamor ekzistojnë disa mënyra për të arritur harmoninë. Më shpesh përmenden tre lloje: harmonia sipas analogjisë, sipas funksionit dhe sipas idesë. Harmonia sipas analogjisë ndërtohet me përdorimin e vlerave të ngjashme pamore – për shembull, vija të ngjashme në trashësi dhe formë, ngjyra të afërta në rrethin e ngjyrave, forma me ngjashmëri në harkim ose tekstura që vizualisht duken të afërta. Në vend të kontrasteve të forta, këtu dominon gradualiteti dhe lidhja. Veprat e krijuara me harmoni sipas analogjisë sjellin ndjenjë qetësie dhe rregullsie te shikuesi, pasi elementet janë në përputhje me njëri-tjetrin.



Paul Klee, "Zë i lashtë, abstraksion mbi sfond të zi", 1925

AKTIVITET

Vizato tri skica duke përdorur lloje të ndryshme harmonie: analogji, funksion dhe ide.

A E DINI SE

Përdorimi i vlerave të afërta pamore ndihmon për të krijuar efekt vizual të qetë.

Harmonia sipas funksionit nuk bazohet në ngjashmëri vizuale, por në lidhjen logjike dhe të kuptimtë të objekteve të paraqitura. Për shembull, paleta, peneli dhe ngjyrat – edhe pse mund të jenë të ndryshme për nga forma dhe ngjyra – krijojnë një motiv vizual me lidhje të përbashkët funksionale. Ky lloj harmonie është veçanërisht i pranishëm në natyrë të qetë dhe artin ilustrativ, ku një grup objektesh paraqiten si pjesë e një konteksti të përbashkët. Përmes kësaj strategjie, vepra merr kuptimin dhe lidhjen e saj, pa qenë e domosdoshme të jetë në përputhje formale.



Vincent van Gogh, "Natyrë e qetë me çelës, qiri dhe qepë", 1889

A E DINI SE

Në dizajnin grafik, harmonia sipas funksionit përdoret për të përmirësuar logjikën vizuale të posterve dhe reklamave.

AKTIVITET

Zgjidh tre objekte që lidhen në mënyrë logjike dhe krijo një kompozim artistik prej tyre.

Lloji i tretë – harmonia sipas idesë – bazohet në lidhjen simbolike të motiveve. Ajo nuk është as logjike, as vizuale, por një lidhje konceptuale mes objekteve. Pëllumbi dhe degëza e ullirit së bashku simbolizojnë paqen, drapëri dhe çekani – punën dhe lëvizjen punëtore, zemra dhe çelësi – dashurinë dhe besimin. Ky tip harmonie është veçanërisht i shpeshtë në postera, pllakate, art me mesazh dhe simbolizëm. Edhe pse elementet mund të jenë të ndryshme në formë dhe ngjyrë, së bashku krijojnë një kuptim unik dhe një harmoni konceptuale.

AKTIVITET

Krijo një kompozim me simbole që përfaqësojnë një ide, si paqja, liria ose puna.



Pablo Picasso, "Pëllumbi i paqes", 1949

Harmonia në një vepër shpesh arrihet edhe përmes **gradacionit** – kalimit të njëpasnjëshëm nga një element vizual tek tjetri. Kjo mund të jetë kalim nga ton i çelët në të errët, nga formë e vogël në të madhe, ose nga një ngjyrë në një ngjyrë të ngjashme. Gradacioni krijon rrjedhë dhe lëvizje, duke forcuar njëkohësisht lidhjen mes elementeve. Në këtë mënyrë, harmonia bëhet dinamike dhe jo statike – ajo nuk qëndron e palëvizshme, por "rrjedh" nëpër kompozicion.

A E DINI SE

Arkitektët dhe dizajnerët gjithashtu përdorin parimet e harmonisë për të krijuar hapësira të këndshme.



Georges Seurat, "Pasdite e së dielës në ishullin Grande Jatte", 1884–1886

AKTIVITET

1. Analizo një vepër arti dhe shëno se si është arritur harmonia.
2. Paraqit të njëjtin motiv një herë me harmoni dhe një herë pa harmoni dhe krahaso efektin vizual.

Në botën bashkëkohore vizuale – që përfshin dizajnin, fotografinë, animacionin dhe artin digjital – harmonia është po aq e rëndësishme sa edhe në artin klasik. Kur dizajnojmë aplikacione, libra, reklama ose postera, qëllimi është që shikuesi të ketë një përvojë vizuale të këndshme. Kjo arrihet me përdorimin e balancuar të elementeve të ngjashme – ngjyrat nuk duhet të "përplasen" mes tyre, format nuk duhet të tërheqin vëmendjen njëra nga tjetra. Prandaj përdoren mjetet vizuale që identifikojnë analogjinë dhe harmoninë në ngjyrë, formë ose shpërndarje.



Marek Rothko – "Portokalli dhe e verdhë" (1956)

AKTIVITET

1. Analizo një faqe interneti, poster ose aplikacion dhe përshkruaj si është përdorur harmonia.
2. Krijo një kompozim digjital ose manual, ku ngjyrat, format dhe vijat janë të ngjashme dhe të harmonizuara.

PYETJE

1. Si ndryshon harmonia sipas analogjisë nga harmonia sipas funksionit?
2. A do të thotë gjithmonë prania e harmonisë në një vepër se nuk ka kontrast? Shpjego.
3. A mund të kujtosh një situatë nga përditshmëria ku objektet lidhen sipas idesë, por jo sipas pamjes ose funksionit?
4. Cila ngjyrë ose formë e lidh më shumë me ndjenjën e harmonisë? Pse?
5. Në cilën vepër nga kjo mësimësi, sipas teje, harmonia është arritur më me sukses? Shpjego zgjedhjen tënde.
6. Si do të dukej një vepër pa asnjë harmoni? Çfarë efekti do të kishte tek shikuesi?

A E DINI SE

Shumë aplikacione për dizajn grafik (si Canva dhe Adobe Color) kanë mjete për krijimin e paletave harmonike sipas ngjyrave analoge. Kjo u mundëson nxënësve dhe dizajnerëve të zgjedhin me lehtësi ngjyra të përshtatshme dhe të krijojnë kompozime vizualisht të balancuara dhe tërheqëse.

KONTRAST

Kontrasti është një nga parimet më të rëndësishme artistike që zbatohet në të gjitha fushat e artit pamor. Ai përfaqëson përballjen e vlerave të ndryshme në një ose më shumë elemente: e ndritshme dhe e errët, e madhe dhe e vogël, e lëmuar dhe e ashpër, e ngrohtë dhe e ftohtë, etj. Kontrasti i ndihmon artistit të theksojë diçka, ta veçojë nga mjedisi, të krijojë dinamikë ose një efekt dramatik.

TERMA KYÇ:

kontrast, lloje kontrasti, kontrast tonal dhe kontrast teksturor, kontrast në formë



Karravaggio – "Marrja e Krishtit" (1602)

A E DINI SE

Kontrasti është një mjet vizual që është përdorur që nga koha e lashtësisë për ta drejtuar vëmendjen e shikuesit drejt më të rëndësishmes në vepër.


AKTIVITET

Bëj një skicë ku do të theksosh një element përmes kontrastit (p.sh.: një formë me ngjyrë ose madhësi të ndryshme nga mjedisi përreth).

Llojet e kontrastit

Kontrasti mund të shfaqet në forma të ndryshme. Çdo kundërshti midis vlerave të një ose më shumë elementëve figurativë krijon tension vizual dhe interes. Kontrasti mund të arrihet përmes:

- **vijës** (drejtë – e lakuar, e hollë – e trashë, e gjatë – e shkurtër),
- **madhësisë** (e madhe – e vogël),
- **drejtimit** (vertikal – horizontal – i pjerrët),
- **ngjyrës** (e ngrohtë – e ftohtë, e çelët – e errët, komplementare),
- **tonit** (pjesë të çelëta – pjesë të errëta),
- **teksturës** (e lëmuar – e ashpër, e butë – e fortë),
- **formës** (këndore – rrethore, e thjeshtë – e ndërlikuar),
- **hapësirës** (plot – bosh, e hapur – e mbyllur).



Vasilij Kandinski – "Kompozicioni VIII" (1923)

A E DINI SE

Kontrasti është një mjet vizual që është përdorur që nga koha antike për ta drejtuar vëmendjen e shikuesit drejt elementit më të rëndësishëm në veprë.

AKTIVITET

Bëj një tabelë me të gjitha llojet e kontrastit dhe vendos një shembull vizual për secilin prej tyre.

Kontrast në teksturë dhe ton

Tekstura është karakteristikë sipërfaqësore e objektit që mund ta shohim ose ta ndiejmë me prekje. Ajo mund të jetë natyrore (p.sh. lëvorja e drurit) ose artificiale (p.sh. një pëlhurë). Kontrasti në teksturë krijohet kur krahasohen sipërfaqe të lëmuara dhe të ashpra, të forta dhe të buta, me shkëlqim dhe mat.

Toni, nga ana tjetër, përfaqëson vlerën e ndriçimit të ngjyrës – nga e bardha deri në të zezën, dhe të gjitha nuancat gri ndërmjet tyre. Kontrasti në ton krijohet përmes përdorimit të sipërfaqeve të ndritshme dhe të errëta. Ai mund të krijojë thellësi, peshë ose efekt dramatik.

A E DINI SE

Shrafurimi është një nga teknikat më të vjetra dhe më të përdorura për krijimin e kontrastit tonal në artet grafike.



Albrecht Dürer – "Lepuri" (1502)

AKTIVITET

Prit copa letre me tekstura të ndryshme (e lëmuar, e ashpër, e zhubrosur) dhe krijo një kompozim të vogël me kontrast të theksuar mes sipërfaqeve të lëmuara dhe të ashpra. Mund të përdorësh letër me ngjyra, gazeta, ambalazhe ose materiale natyrore. Përpiqu të arrish një ekuilibër mes formave dhe teksturave.

Kontrast në formë dhe teksturë

Forma përfaqëson pamjen e jashtme ose konturet e një objekti. Ajo mund të jetë gjeometrike (katror, rreth, trekëndësh) ose organike (forma natyrore, të parregullta). Kontrasti në formë arrihet duke vënë përballë forma këndore dhe të rrumbullakëta, të thjeshta dhe të ndërlikuara, të vogla dhe të mëdha brenda një kompozicioni.



Pablo Picasso – "Natyrë e qetë me karrige të thurur" (1912)

Kolazhi është një teknikë që mundëson kombinimin e materialeve të ndryshme (letër, pëlhurë, gazeta etj.) në një vepër artistike. Përmes kombinimit të materialeve me tekstura, ngjyra dhe forma të ndryshme, artisti mund të arrijë lehtësisht kontrast vizual.



Hannah Höch – "E prerë me thikë kuzhine Dada nëpër epokën e fundit kulturore të barkëve të mëdha të birrës së Gjermanisë së Vajmarit" (1919–1920)

A E DINI SE

Kolazhi për herë të parë u bë një teknikë pop-ullore tek kubistët në fillim të shekullit XX, si një mënyrë e re për të futur materiale reale në veprën artistike.

AKTIVITET

1. Prit forma të ndryshme nga letra me ngjyra dhe krijo një kompozim me kontrast të theksuar në formë (këndore dhe të rrumbullakëta, të mëdha dhe të vogla).
2. Bëj një kolazh me fragmente letre, gazete, tekstili dhe materialesh të tjera që kanë tekstura, ngjyra dhe forma të kundërta.

PYETJE

1. Pse kontrasti konsiderohet si një parim i rëndësishëm në art?
2. A mund të krijojmë një kompozim pa kontrast?
3. Cilat teknika artistike e theksojnë më shumë kontrastin?
4. Çfarë efekti ka kontrasti mbi gjendjen shpirtërore që përcjell një vepër?
5. Në cilat fusha të jetës së përditshme vini re kontrast jashtë artit?

GRADACIONI

Hyrje në gradacion

Gradacioni paraqet ndryshimin gradual të elementeve vizuale – vijës, ngjyrës, tonit, formës, drejtimit, teksturës, madhësisë ose hapësirës – nga një gjendje në tjetrën. Ai është i pranishëm në të gjithë krijimtarinë artistike: në vizatim, pikturë, skulpturë, grafikë, arkitekturë dhe dizajn. Ashtu si në natyrë dita kalon gradualisht në natë, ose si bimët rriten hap pas hapi, po ashtu edhe artisti përdor gradacionin për të paraqitur kalimin gradual, lëvizjen ose zhvillimin. Gradacioni na mundëson të krijojmë kompozime me thellësi, volum dhe dinamikë.

TERMA KYÇ:

gradacion, gradacion akromatik, gradacion i drejtimit, gradacion i formës, gradacion në natyrë, gradacion si parim

A E DINI SE

Në artin pamor gradacioni është përdorur që nga koha e Rilindjes për krijimin e iluzionit të thellësisë dhe dritës reale.

AKTIVITET

1. Bëj një vizatim ku toni kalon gradualisht nga një nuancë e çelët në një të errët.
2. Në një skicë nga natyra shëno pjesët ku ndodh kalimi vizual – p.sh. qielli drejt horizontit.



Leonardo da Vinçi – studim për kokën e Ledës (1504–1506)

Gradacioni i tonit dhe i ngjyrës

Gradacioni i tonit do të thotë kalim gradual nga një ton i çelët në një ton të errët ose anasjelltas. Me këtë krijohet volum dhe tridimensionalitet brenda dy dimensioneve. Te ngjyra, gradacioni mundëson kalimin nga një ngjyrë në një tjetër – p.sh. nga e verdha, në portokalli, deri tek e kuqja. Gradacioni akromatik përdor vetëm të zezë, të bardhë dhe nuanca gri, dhe me të mund të arrihet dramacitet ose qetësi. Gradacioni me tonalitete të ndryshme (dur ose mol) përdoret për të përcjellë emocione të ndryshme.



J. M. W. Turner – "Temeraire luftëtar" (1839)

A E DINI SE

Në spektrin e dritës, ngjyrat shfaqen natyrshëm në gradacion: e kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbër, blu, vjollcë.

AKTIVITET

1. Bëj një gradacion nga e zeza në të bardhë duke përdorur grafit.
2. Realizo një kolazh në të cilin ngjyrat kalojnë gradualisht nga njëra në tjetrën.

Gradacioni në vijë, teksturë dhe drejtim


